



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.381 Akti

Nr. 438 Vendimi  
Tiranë, më 10.9.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs në datën 8.9.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim, në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Ariola Kristo**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi Kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshim në ligjin nr. 8417”, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo, me detyrë gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo, duke krahasuar “Deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar, “*Vetting*” me deklaratat e pasurisë në vite, dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, për subjektin e rivlerësimit Ariola Kristo, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë,*
- *ka mosdeklarim pasurie ndër vite,*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2021, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo.*

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret e vlerësimit, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues komisioner Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 14.4.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

8. Në datën 22.6.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ariola Kristo, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

9. Në datën 25.6.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda datës 7.7.2021

10. Në datën 28.6.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe më 12.7.2021 dërgoi shpjegimet, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

11. Në datën 14.7.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Ariola Kristo, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 21.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në rrugë elektronike me *e-mail* në datën 19.7.2021, Komisioni njoftoi subjektin se për arsye objektive seanca dëgjimore e parashikuar për t'u zhvilluar në datën 21.7.2021, ora 10:00, nuk do të zhvillohej.

13. Në datën 31.8.2021, subjekti po në rrugë elektronike me *e-mail* u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohet në datën 8.9.2021, ora 12:00.

14. Në datën 8.9.2021, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Ariola Kristo, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

16. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

17. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo kërkoi konfirmimin në detyrë.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ariola Kristo. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 8.9.2021, për të rifilluar sërish në të njëjtën datë 8.9.2021, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

19. Znj. Ariola Kristo ka qenë e gatshme për të bashkëpunuar me Komisionin gjatë procesit të rivlerësimit në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve dhe pyetjeve të drejtuara në seancën dëgjimore nga trupi gjykues, si dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**20.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**21.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**19.1** Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**19.2** Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**19.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**19.4** Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**19.5** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

#### **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**22.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**23.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “*Vetting*”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë

qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo

**24.** Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**25.** Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “*Vetting*” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2010 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

**26.** Subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “*Vetting*” (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 27.01.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

## **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si vijon:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) deklaratat vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2010 – 2016;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit, personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nga Komisionit është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2010 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iii) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ, që u identifikuan nga hetimi administrativ.

## **Mbi dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016**

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezulton se subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.1.2017, fakt ky që konfirmohet edhe nga ILDKPKI-ja, nëpërmjet vërtetimit të lëshuar.

Sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi prej vitit 2003 dhe në vijim, pa ndërprerje, se është e martuar dhe ka 2 (dy) fëmijë në moshë të mitur. Konstatohet nga Komisioni se edhe bashkëshorti është subjekt deklarues, pasi z. J.K. ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Sa më sipër, në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka deklaruar subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti J.K. .

Subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo është gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, prej tetorit të vitit 2003 deri më sot.

### **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar nga subjekti rivlerësimit Ariola Kristo në deklaratën e pasurisë *Vetting***

#### **1. Truall + banesë me sip. totale 159 m<sup>2</sup> nga e cila 100 m<sup>2</sup> ndërtesë, tri kate me bodrum, rruga “\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, Korçë**

Kjo pasuri është me nr. pasurie\*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP-në Korçë, në datën 17.7.2008. Trualli është blerë në datën 11.11.2005, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*. Shtëpia ka filluar të ndërtohet në vitin 2007 dhe ka përfunduar në vitin 2008. Mobilimi është bërë në vazhdimësi dhe në kohën e dorëzimit të deklaratës ka vlerën që i referohet. Në të njëjtën banesë banojnë edhe prindërit e bashkëshortit të subjektit, të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e saj, si dhe kanë në përdorim katin e parë dhe bodrumin dhe mobilimi i këtyre ambienteve është bërë tërësisht prej tyre. Vlera totale e deklaruar nga subjekti është 14,900,000 ( trualli ka vlerë 1,900,000 lekë , banesa ka vlerë 10,000,000 lekë, mobilimi ka vlerë 2,500,000 lekë + grila të jashtme 500,000 lekë).

#### **Burimet e krijimit të kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* janë si vijon:**

- hua marrë nga xhaxhai i bashkëshortit S.K., në vlerën 1,500,000 lekë, me kontratë verbale të datës 30.10.2005;
- dy kredi marrë në “Alpha Bank”, e para ka vlerën 30,000 euro dhe e dyta ka vlerën 2,500,000 lekë;
- hua marrë nga z. Th. L., në shumën 2,500,000 lekë, me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2011. Kjo shumë është përdorur kryesisht për të shlyer kredinë e dytë nga “Alpha Bank”, në vlerën 2,500,000 lekë;
- para fillimit të punimeve për ndërtimin e banesës janë mbledhur kursimet para martesës së subjektit të bashkëshortit dhe të prindërve të tij, që së bashku kanë qenë në vlerën 2,197,576 lekë. Këto kursime kanë qenë të grumbulluara në dy llogari bankare: në “Tirana Bank” në një depozitë mujore në vlerën 1,454,295 lekë dhe të mbyllur më 19.12.2005 dhe në një depozitë 60-mujore, në vlerën 743,281 lekë, mbyllur më 2.10.2005, në “ProCredit Bank”;
- kursime të mëparshme në vlerën 400,000 lekë;
- vlera 20,000 euro të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit i është dhuruar subjektit dhe bashkëshortit (pasi jetojnë në të njëjtën banesë). Këto të ardhura janë dërguar nga blerësi nga shteti grek, veprim që dokumentohet me “nxjerrja e llogarisë” nga “ProCredit Bank”.

Subjekti i ka bashkëlidhur<sup>1</sup> deklaratës së pasurisë *Vetting* dokumentacionin e ndërtimit, investimeve dhe burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

<sup>1</sup>Shihni aneksin nr. 4/1, 4/2, 4/13, 4/14, 4/15, 4/18 dhe 4/16 në dosjen e ILDKPKI-së në të cilën gjejmë praktiken e regjistrimit të saj.

## Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

**1.1** Subjekti e deklaroi për herë të parë pasurinë në deklaratën e interesave private periodike<sup>2</sup> të vitit 2005, në të cilën ka deklaruar: *“Truall me sipërfaqe 159 m<sup>2</sup> ndodhur në qytetin e Korçës në lagjen ‘\*\*\*’, regjistruar në ZVRPP-në Korçë në datën 22.11.2005 me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me vlerë 1,900,000 lekë me pjesë takuese 50 %”*.

**1.2** Pasuria është fituar sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.11.2005, me të cilën bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shtetasi N.T. pasurinë e llojit truall me sip. 159 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 96 m<sup>2</sup>. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar vetëm blerjen e truallit dhe të ndërtesës.

**1.3** Me vendim nr. \*\*\*, datë 30.10.2006, të KRRT-së Korçë, është miratuar në emër të bashkëshortit të subjektit leja “Për miratimin e destinacionit e të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”. Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2008, të Bashkisë Korçë “Dërgim dokumentacioni për lejen e shfrytëzimit të objektit - banesë 3 kate me podrum” bashkëlidhet leja e shfrytëzimit dhënë bashkëshortit të subjektit. Me vendim nr. \*\*\*, datë 30.10.2006, të KRRT-së është miratuar leja e ndërtimit për ndërtimin e objektit “Banesë me 3 kate me bodrum”, me subjekt ndërtues shoqërinë “N.” sh.p.k., me afat të përfundimit të punimeve datën 30.10.2008. Bashkëshortit i subjektit në cilësinë e investitorit ka lidhur me shoqërinë “N.” sh.p.k., kontratën e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 17.11.2006, me objekt mbikëqyrje, asistencë teknike, ndjekjen dhe zbatimin e punimeve.

**1.4** Komisioni gjatë hetimit konstatoi se subjekti i rivlerësimit në DIPP-ë të vitit 2006 nuk deklaroi ndërtimin e objektit banesë me 3 kate me bodrum dhe prishjen e banesës së vjetër të blerë nga bashkëshorti, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.11.2005. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të për vitet 2006 dhe 2007 lejen e ndërtimit, kontratën me shoqërinë “N.” sh.p.k, si dhe lejen për prishjen e ndërtimit dhënë kësaj shoqërie.

**1.5** E pyetur nga Komisioni<sup>3</sup> gjatë hetimit mbi mosdeklarimin në DIPP-të për vitet 2006 dhe 2007, të lejes së ndërtimit, lejes për prishjen e ndërtimit dhe kontratës me shoqërinë “N.” sh.p.k., subjekti<sup>4</sup> sqaron se: *“Përderisa kjo pasuri nuk ka qenë e krijuar tërësisht, por ishte në krijim e sipër, pra nuk ishte një shtëpi e përfunduar dhe e regjistruar në ZVRPP-në Korçë, kam menduar dhe e kam interpretuar ligjin se nuk kam pasur detyrimin ta deklaroj .... vlera për prishjen e banesës së vjetër ka qenë rreth 100,000 lekë”*.

---

Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 11.11.2005, ku shtetasi J. K. blen truall me sip. 159 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të ndërtuar 96 m<sup>2</sup>, në Korçë, në vlerën 1,900,000 lekë; leje ndërtimi për shtetasin J. K., lëshuar më 17.11.2006, me vendim nr. \*\*\*, datë 30.10.2006, të KRRT-së për banesë 3 kate me bodrum, rruga “\*\*\*\*”; kontratë ndërtimi nr. \*\*\*, datë 17.11.2006, me investitor J. K. dhe shoqëria “N.” sh.p.k. për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve; aktkolaudimi datë 7.6.2008, për objektin e ndërtuar “banesë me 3 kate me bodrum” në rrugën “\*\*\*\*, Korçë; relacion për kolaudimin e punimeve të kryera në datën 7.6.2008, për objektin “banesë me 3 kate me bodrum”, ku kati përdhe ka ambiente shërbimi të cilat mund të shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit tregtar apo ambient shërbimesh dhe kati i parë e i dytë do të shërbejë për banim me vlerë 9,800,000 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie, datë 15.7.2008, për pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, truall me sipërfaqe 159 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit J.K.; autorizim për pagesën e 1% të vlerës së investimit në shumën 201,264 lekë ndaj Bashkisë Korçë, shoqëruar me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, vërtetim nr\*\*\*, datë 7.11.2016, nga Bashkia Korçë, me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi J. K. banon me prindërit e tij në të njëjtën banesë; nxjerrje llogarie datë 26.1.2007, nga “Tirana Bank” për tërheqjen në datën 19.12.2005, në vlerën 1,454,295 lekë; nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, nga “ProCredit Bank” në emër të shtetasit J. K., ku figuron depozita gjendje prej 721,989 lekësh dhe tërheqja e saj së bashku me interesat, në vlerën 743,281 lekë, në datën 2.10.2005; nxjerrje llogarie, datë 26.1.2017, nga “ProCredit Bank” në emër të shtetasit S. K., ku figuron kreditimi/transfertë ndërkombëtare në vlerën 21,967 euro, në datën 18.1.2008, si dhe tërheqja e shumës deri në datën 2.5.2008; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, e shtetasve J. K. dhe Th.L., për shumën 2,500,000 lekë e marrë hua; vendimi i pushimit të çështjes penale nr. \*\*\*/2015, datë 8.6.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë në ngarkim të shtetasit Th. L.; kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 6.4.2007, me kredimarrës J. dhe Ariola Kristo në “Alpha Bank”, për financimin e projektit prej 30,000 euro; kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. \*\*\*, datë 30.6.2008, me kredimarrës J. dhe Ariola Kristo, për marrjen nga “Alpha Bank” të shumës 2,500,000 lekë.

<sup>2</sup>Në vijim do të shënohet “DIPP”.

<sup>3</sup>Pyetësor nr. 2, përgjigjja nr. 1.1

<sup>4</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigjja 1.8, 1.9, 1.10.

**1.6** Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti deklaron: “Shtuar shtëpi banimi me sip. 100 m<sup>2</sup> ndërtuar mbi truallin e pasurisë me nr\*\*\*, z. k. \*\*\*; të deklaruar në vitin 2007, në vlerën 7,000,000 lekë”.

**1.7** Referuar relacionit të aktit të kolaudimit të banesës, vlera e objektit në përfundim të ndërtimit është 9,800,000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën së pasurisë *Vetting* dhe autorizimin për pagesën e 1% të vlerës së investimit në shumën 201,264 lekë, ndaj Bashkisë Korçë, ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit paguan shumën 209,064 lekë. Gjithashtu, gjatë procesit të rivlerësimit deklaroi edhe vlerën 100,000 lekë për prishjen e ndërtimit.

**1.8** Sa më sipër, rezultoi se subjekti ka mospërputhje të deklaratimeve të vlerës së banesës, ku në DIPP-ë të vitit 2008 ka deklaruar vlerën 7,000,000 lekë, me deklaratën e pasurisë *Vetting* në të cilën ka deklaruar vlerën 10,000,000 lekë.

**1.9** Komisioni i drejtoi pyetje subjektit mbi mospërputhjen e deklaratimeve të vlerës së banesës në DIPP-në e vitit 2008, me deklarimin në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe subjekti i rivlerësimit shpjegon<sup>5</sup> se: “Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, vlera është deklaruar 7,000,000 lekë, pasi është bërë deklarimi për vlerën e përafërt të pjesës që unë e bashkëshorti im kemi në përdorim, ...ndërkohë që nuk është pasqyruar vlera e pjesës në përdorim nga prindërit e bashkëshortit (një kat+bodrum). Në kohën e kryerjes së punimeve të shtëpisë e deri në momentin e regjistrimit, ne dhe prindërit e bashkëshortit tim, nuk kishim konkluduar në lidhje me faktin se në emër të kujt do të regjistrohej shtëpia, nëse do të regjistrohej edhe në emër të prindërve të bashkëshortit, sipas gjendjes faktike, apo vetëm në emër të bashkëshortit tim. .... në deklaratën *Vetting*, vlera e shtëpisë është pasqyruar 10,000,000 lekë, për arsye se 9,800,000 lekë është vlera e shtëpisë sipas aktit të kolaudimit e kësaj i është shtuar dhe taksa që është paguar në Bashkinë Korçë në momentin e pajisjes me leje ndërtimi në vlerën 209,064 lekë. Pagesa e çmimit të truallit i është bërë herë cash shitësit...shtëpia është ndërtuar me firmë ndërtimi dhe pagesat për të janë herë në mënyrë periodike gjatë kohës së ndërtimit (për çdo punim bëhej pagesa përkatëse cash), deri në kolaudimin e shtëpisë që është data 7.6.2008. Kjo pasuri përfshin objektin dhe mobilimin e tij. Vendosija e grillave të jashtme të shtëpisë në vlerën 500,000 lekë dhe pagesa është bërë në muajt qershor-korrik 2013. Burimi i krijimit të këtij shpenzimi është kontrata e kredisë afatmesme nr. \*\*\*, datë 5.6.2013 me ‘Credins Bank’. Pagesa është bërë cash”.

**1.10 ASHK<sup>6</sup>-ja** Drejtoria Vendore Korçë informon se në emër të shtetasit J. K. rezultoi e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, pasuri e llojit truall me sip. 159 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë m e sip. 100 m<sup>2</sup>. Në seksionin “E”<sup>7</sup> të kartelës së pasurisë konstatohet se ndaj kësaj pasurie është vendosur barrë hipotekore për shumat 33,600 euro dhe 2,600,000 lekë në favor të “Alpha Bank”. Bashkëlidhet nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Korçë edhe leja për prishje ndërtimi me datë 23.11.2006, për objektin shtëpi banimi -1 kat me pronar J. K., dhënë subjektit ndërtues “N.” sh.p.k. Afati i prishjes është përcaktuar brenda 6 muajve.

**1.11 OSHEE<sup>8</sup>** informon se me gjeneralitetet J. K., referuar të dhënave të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në Korçë.

**1.12 UK Korçë<sup>9</sup>** informon se me gjeneralitetet J.K., referuar të dhënave të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në Korçë me nr. klienti \*\*\*.

**1.13** Lidhur me kontratat e shërbimit që disponon me OSHEE dhe UK Korçë, objektet dhe abonentët të cilët furnizohen këto kontrata, e pyetur<sup>10</sup> nga Komisioni subjekti i rivlerësimit

<sup>5</sup>Shihni pyetësorin nr. 2 përgjigjja 1.1, 1.2.

<sup>6</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Korçë.

<sup>7</sup>Seksioni i hipotekave, kufizimeve dhe vendimeve të gjykatës.

<sup>8</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2020, e OSHEE-së.

<sup>9</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 18.4.2020, e UKT-së.

<sup>10</sup>Pyetësor nr. 3, përgjigjja 1.4



shpjegon se: “ ... në lidhje me kontratat e furnizimit me ujë të pijshëm, kontrata me Ujësjetllës Kanalizime Korçë... vetëm bashkëshorti im J.K. ka një kontratë të tillë, me nr. \*\*\*, për banesën e ndodhur në Korçë, lagjja. \*\*\*, rr. ‘\*\*\*\*’”. Unë dhe dy prindërit e bashkëshortit tim S. dhe M. K. nuk disponojmë kontrata me UK Korçë. ...në lidhje me kontratat e furnizimit me energji elektrike, kontrata me OSHEE-në sqarohet se vetëm bashkëshorti im J. K. dhe babai i tij S. K., kanë kontrata të tilla, për banesën e ndodhur në Korçë, lagjja \*\*\*, rr. \*\*\*,respektivisht J.K. me kod: \*\*\*,e tipit familjare dhe S. K. me kod: \*\*\*, e tipit familjar, nëna e bashkëshortit tim M. K. nuk disponojmë kontrata me OSHEE-në në të njëjtën kabinë \*\*\*.” Subjekti i bashkëlidhur shpjegimeve kontratat<sup>11</sup> që disponon me UK Korçë dhe OSHEE-në<sup>12</sup>.

**1.14** Komisioni, për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, hetoi lidhur me konfliktin e interesit dhe iu drejtuar Gjykatës<sup>13</sup> së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila përcjellë informacionin se pranë kësaj gjykate nga subjekti i rivlerësimit nuk janë gjykuar çështje civile me palë shoqërinë “N.” sh.p.k. Komisioni nga verifikimi në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore vëren se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk ka asnjë çështje penale apo civile të regjistruar në emër të administratorit të kësaj shoqërie shtetasit Gj. N. .

**1.15** Komisioni, në përfundim të hetimit në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me konstatimet si vijon;

- a) subjekti deklaron vlerë të ndryshme të ndërtimit dhe investimit, për objektin banesë me 3 kate me bodrum në DIPP-në e vitit 2008, ku deklaron vlerën 7,000,000 lekë, me deklarimin e bërë në deklaratën e pasurisë *Vetting*, në të cilën ka deklaruar vlerën 14,900,000 lekë;
- b) subjekti nuk deklaron në DIPP-të për vitet 2006 dhe 2007 ndërtimin e objektit banesë me 3 kate + bodrum.

**1.16** Në parashtrimet e depozituara në Komision, në funksion të barrës së provës, subjekti pretendoi se:

**Lidhur me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2005 të banesës të blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.11.2005**, subjekti shpjegon dhe mban të njëjtin qëndrim<sup>14</sup> me atë gjatë hetimit dhe parashtron se: “... në DIPP-në e vitit 2005, kam deklaruar vetëm truallin me sipërfaqe 159 m<sup>2</sup>, të blerë nga bashkëshorti im J. K. prej shtetasit N. T. me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.11.2005, dhe jo ndërtesën me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>... Shtëpia ekzistuese që ka qenë mbi atë truall, ka qenë një banesë tejet e vjetër dhe tejet e amortizuar, e pabanueshme, gjysma e saj ka qenë e rrënuar e gjysma tjetër në një gjendje shumë të keqe. Edhe çmimi i shitjes që është paguar nga ana jone ka qenë vetëm çmimi i paguar për vlerën e truallit dhe jo të banesës së ndodhur mbi të. Këtë e tregon edhe fakti se para ndërtimit të shtëpisë është marrë nga Bashkia Korçë leje për prishjen ndërtimi, datë 23.11.2006, për objektin ‘shtëpi banimi 1 kat’, çka tregon se shtëpia ekzistuese thjesht ka ekzistuar mbi truallin e blerë dhe pas blerjes, ajo është prishur, pra, nuk ka pasur vlerë si banesë dhe si objekt real i kontratës së shitblerjes ka qenë vetëm trualli. Pra, çmimi i blerjes së pasqyruar në kontratën e shitblerjes prej 1,900,000 lekësh i korrespondon vetëm çmimit të truallit me sip. 159 m<sup>2</sup>. Pavarësisht se kjo ka qenë arsyeja e vërtete e mosdeklarimit të shtëpisë..., ka qenë një pakujdesi nga ana ime që në DIPP-në e vitit 2005, nuk kam deklaruar dhe shtëpinë si pjesë e kontratës së shitjes”.

<sup>11</sup>Tre vërtetime negative nga UKKO (për shtetasit Ariola Kristo, S. K. e M. K., që nuk janë klientë të UKKO sh.a.: një vërtetim nga UKKO sh.a për bashkëshortin J. K. që është klient i UKKO sh.a.; kontratën për shërbime të ujësjetllës-kanalizime nr. \*\*\*, për bashkëshortin J. K. (doc.11); shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2021, e OSHEE-së, Drejtoria Rajonale Korçë, bashkëlidhur dokumentacioni i quajtur “Bill Details, Detaje Faturimi”.

<sup>12</sup>Tre vërtetime negative nga UKKO(për shtetasit Ariola Kristo, S. K. e M.K., që nuk janë klientë të UKKO sh.a.: një vërtetim nga UKKO sh.a për bashkëshortin J.K., që është klient i UKKO sh.a.; kontratën për shërbime të ujësjetllës-kanalizimeve nr. \*\*\*, për bashkëshortin J. K. (doc.11); shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 4.5.2021, të OSHEE-së, Drejtoria Rajonale Korçë, bashkëlidhur dokumentacioni i quajtur “Bill Details, Detaje Faturimi” .

<sup>13</sup>Shkresë e Gjykata së Rrethit Gjyqësor Korçë.

<sup>14</sup>Shihni pyetësorin nr. 2.

**Lidhur me mosdeklarimin në DIPP-të për vitet 2006 dhe 2007 të prishjes së banesës së vjetër në bazë të lejes së prishjes së dhënë nga KKRT-ja Bashkia Korçë, datë 23.11.2006, dhe të ndërtimit të shtëpisë së re, në bazë të lejes së ndërtimit të dhënë nga KKRT-ja Bashkia Korçë nr. \*\*\*, datë 30.10.2006, por të deklarimit të kësaj të fundit vetëm në DIPP-në e vitit 2008, subjekti rivlerësimit, në parashtrime rreth rezultateve të hetimit, deklaroi se: “... në lidhje me sa më sipër, u qëndroj shpjegimeve të dhëna nga ime në përgjigjet e pyetësorit nr. 2... Kam menduar se kisha detyrimin për ta deklaruar shtëpinë, në kohën e përfundimit të saj, pra, të krijimit të pasurisë dhe të marrjes së saj formë ligjore. Po kështu dhe për sa i përket lejes së ndërtimit dhe kontratës me shoqërinë e ndërtimit në emër të bashkëshortit tim, kam kuptuar e interpretuar ligjin se nuk kisha detyrim ta deklaroj, meqenëse ndërtimi nuk ishte finalizuar. I njëjti arsyetim është dhe në lidhje me lejen e prishjes së ndërtesës së vjetër, ku e kam interpretuar ligjin se nuk kam pasur detyrimin ta deklaroj, pasi kam menduar se objekti do deklarohet kur të përfundonte tërësisht. Mbase dhe sa më sipër ka qene një gabim e pasaktësi nga ana ime ...”.**

**Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve të vlerës së banesës në DIPP-në e vitit 2008, në vlerën 7,000,000 lekë dhe në deklaratën Vetting në vlerën 10,000,000 lekë, subjekti rivlerësimit, në parashtrime rreth rezultateve të hetimit, deklaroi se: “Edhe në lidhje me këtë konstatim iu qëndroj shpjegimeve të dhëna nga ime në përgjigjet të pyetësorit nr. 2. Për sa më sipër, sqaroj se shtëpia de facto është e përbashkët e familjes time dhe e prindërve të bashkëshortit tim, pasi në këtë banesë realizohet jetesa si e jona, ashtu dhe e tyre... Në deklaratën Vetting, vlera e shtëpisë është pasqyruar në 10,000,000 lekë, referuar vlerës totale të shtëpisë, sipas aktit të kolaudimit, pra, për të gjithë banesën, e cila figuron e regjistruar në emër të bashkëshortit tim J. K. . Shuma prej 9,800,000 lekësh është vlera e shtëpisë sipas aktit të kolaudimit e kësaj i është shtuar dhe taksa që është paguar në Bashkinë Korçë në momentin e pajisjes me lejë ndërtimi. Sqaroj se pavarësisht kësaj pasaktësie dhe mospërputhjeje, nga ana ime nuk ka pasur qëllim fshehje të vlerës reale të shtëpisë, pasi kjo e fundit ka figuruar dhe ka qenë e dokumentuar në akte zyrtare të lëshuara nga organet shtetërore, sikurse janë: akti i kolaudimit (vlera 9,800,000 lekë) e pagimi i taksës përkatëse në Bashkinë Korçë (vlera 209, 064 lekë). Shuma e këtyre dy vlerave jep vlerën totale prej 10,000,000 lekësh. Në lidhje me vlerën prej 14,900,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën Vetting, rezulton se ajo është vlera totale e pronës, pra, 10,000,000 lekë është vetëm vlera e ndërtesës (së cilën për arsyen e mësipërme e kam deklaruar 7,000,000 lekë në DIPP-në e vitit 2008), ndërkohë që në vlerën totale prej 14,900,000 lekë, përfshihen edhe vlera e truallit (i cili i përket vitit 2005), shpenzimet për mobilimin e banesës, si dhe vendosja e grilave të jashtme të banesës, që i përket vitit 2013”.**

**1.17** Gjatë seancës dëgjimore, subjekti shpjegoi dhe mbajti të njëjtin qëndrim lidhur me konstatimet e Komisionit me atë të mbajtur gjatë hetimit dhe shpjegimeve të dhëna pas dërgimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në konkluzion të sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave të depozituara, trupi gjykues çmoi se subjekti rivlerësimit:

- a) Në DIPP të vitit 2005 ka bërë një deklaram të pasaktë të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* e llojit truall me sip. 159 m<sup>2</sup> dhe banesë/ndërtesë me dy kate me oborr me sipërfaqe të ndërtuar 96 m<sup>2</sup>.
- b) Nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor gjendjen faktike të banesës në vitin 2005, faktin e amortizimit të saj, si dhe nëse përdorej ose jo si banesë nga shitësi.
- c) Në DIPP-ë të vitit 2005 ka bërë një deklaram të pasaktë të deklarimit të vlerës së banesës, në të cilën e ka deklaruar në vlerën 7,000,000 lekë, me deklaratën Vetting në të cilën e deklaroi në vlerën 10,000,000 lekë, me vlerën e investimit 9,800,000 lekë, sipas aktkolaudimit.

- d) Ka bërë një deklaram të pasaktë të të drejtave reale për këtë pasuri sipas nenit 4 germa “a”<sup>15</sup> dhe nenit 7, pika 1,<sup>16</sup> të ligjit nr. 9049/2003, në të cilin përcaktohet se subjektet e këtij ligji kanë detyrimin të deklarojnë në deklaramin periodike vjetor ndryshimet e ndodhura në pasuritë, si dhe në pasuritë paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to.

### **Analiza ligjore/financiare e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaramin e pasurisë *Vetting* se për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer disa burime, për të cilat trupi gjykues çmon si vijon:

#### **1.18 Hua nga xhaxhai i bashkëshortit S. K., në vlerën 1,500,000 lekë, me kontratë verbale, datë 30.10.2005, me qëllim blerjen e truallit më 11.11.2005**

**1.18.1** Subjekti i rivlerësimit në seksionin e detyrimeve në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar: “*Shuma 1,500,000 lekë marrë hua nga z. S. K., për blerjen e truallit të përshkruar në fletën 3, detyrim i lindur në datën 30.10.2005, në bazë të një kontrate të lidhur pa afat në të njëjtën datë*”.

**1.18.2** Lidhur me shlyerjen e huas, subjekti i rivlerësimit në deklaramin e interesave private periodike ka deklaruar:

- a) Në DIPP-në e vitit 2007: “*Shlyerjen e shumës 700,000 lekë, shumë e marrë hua për blerjen e truallit të deklaruar në vitin 2005, sipas kontratës së datës 30.10.2005*”.
- b) Në DIPP-ë të vitit 2008: “*Pakësuar në datën 9.8.2007, shuma 800,000, për shkak të shlyerjes së huas së marrë nga z. S. K.*”.

#### **1.18.3 Nga korrespondenca e Komisionit me institucione publike, lidhur me të dhëna për shtetasin S. K., rezultoi se:**

**ISSH-ja**<sup>17</sup> informon se për periudhën janar 2007 – shkurt 2019 shtetasi S. K. ka përfutuar pension pleqërie, ndërsa shkresa e Arkivit Qendror të ISSH-së informon se shtetasi S. K. ka qenë në marrëdhënie pune, për periudhën 13.7.1963 – 27.11.1991, në profesione të ndryshme, nga të cilat si berber ka punuar në periudhën 9.9.1976 – 21.11.1991. Nga vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, bashkëngjitur pyetësorit standard nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se shtetasi S. K. ka qenë i regjistruar si person fizik në periudhat: 22.7.1992 – 31.12.1993; 1.2.1995 – 31.12.1995; 1.1.1997 – 30.6.1997 dhe 1.1.1998 – 4.11.2001.

**Bashkia Korçë**<sup>18</sup> informon se në emër të shtetasit S. K. rezulton të jetë e regjistruar prona me numër pasurie \*\*\*, e llojit njësi, për të cilën janë likuiduar taksat për ndërtesën për vitin 2020. Gjithashtu, bëjnë me dije se nuk u rezulton asnjë biznes i regjistruar në këtë emër. Nga vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, rezulton se shtetasi S. K. ka qenë i regjistruar me kod fiskal \*\*\*, në datën 6.3.1993, me aktivitet tregtar, berber.

**1.18.4 Referuar në informacionin e përcjellë nga QKB-ja**<sup>19</sup> dhe atij të gjeneruar nga faqja zyrtare nuk rezulton i regjistruar subjekt tregtar me gjeneralitetet S. K., person fizik.

**1.18.5** Subjekti është pyetur<sup>20</sup> përgjatë hetimit nga Komisioni lidhur me huan e dhënë nga shtetasi S. K., për të cilën shpjegoi se: “*S. K., ka qenë xhaxhai i bashkëshortit tim, i cili tashmë*

<sup>15</sup>Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklaramin dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

<sup>16</sup>Neni 7, deklarimi periodik vjetor 1. Në deklaramin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi.

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020, e ISSH-së.

<sup>18</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2020, e Bashkisë Korçë.

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020.

<sup>20</sup>Pyetësor nr. 2, nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, përgjigjja e pyetjes 3.

ka ndërruar jetë. Ai ka punuar si berber gjatë gjithë jetës së tij. ... *xhaxhai*<sup>21</sup> i tij ka pasur burime të ligjshme të ardhurash, pasi ai ka qenë berber dhe ka ushtruar këtë profesion privatisht që nga viti 1993 dhe si punonjës në shtet para kësaj periudhe. ...në<sup>22</sup> institucionet e mësipërme shtetërore, ekzistojnë vetëm këto dokumente. Objekti ku është ushtruar aktiviteti privat i berberit është privatizuar prej tij e prej një tjetër punonjësi, të cilët kanë punuar së bashku në të njëjtin ambient si në kohën para privatizimit, ashtu dhe pas saj. Po paraqes një deklaratë noteriale të këtij personi (shtetasit A.V.), për të vërtetuar se S.K. ka ushtruar këtë aktivitet privat, si e vetmja provë që unë mund të siguroj, pasi huadhënësi tashmë ka ndërruar jetë dhe në institucionet shtetërore ekzistojnë vetëm aktet që unë ua kam venë në dispozicion më parë. Për shkak të faktit se ai tashmë nuk jeton më, nuk kam informacion nëse ai ka patur llogari bankare e unë nuk kam akses për të marrë informacion mbi llogaritë e tij personale. Po paraqes dhe librezën e tij të punës, ku vërtetohen periudhat e punës e lloji i punës së kryer prej tij”. Subjekti i bashkëlidhi shpjegimeve dokumentacionin justifikues ligjor<sup>23</sup> mbi të cilat mbështeti argumentet e saj.

**1.18.6** Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit të Komisionit rezultoi se shtetasi S. K. ka qenë i regjistruar si person fizik prej datës 6.3.1993 dhe në zbatim të ligjit nr. \*\*\*, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” neni 1: “Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë”. Neni 2: “Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse dhe derdhet në buxhetin e shtetit.” Ndërsa për periudhat në vijim ky lloj aktiviteti ekonomik i është nënshtuar rregullimit me ligjin 8313/1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, më pas është rregulluar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000, si dhe ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002 (tatim mbi xhiron), ku si pasojë shtetasi S. K. ka pasur detyrim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe fiskale, bazuar në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

**1.18.7** Në përfundim të hetimit të Komisionit, lidhur me këtë burim krijimit të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, pasi nga hetimi rezultoi se:

- a) subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor dhënien e huas nga shtetasi S.K. dhe shlyerjen prej saj dhe bashkëshortit;
- b) dhënia e huas dhe kthimi i saj janë bërë *cash*, pasi nga hetimi në të dhënat bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit nuk rezultuan vlera të transferuara prej tyre për shtetasin S. K.;
- c) në lidhje me aftësinë huadhënëse të shtetasit S. K., gjatë hetimit u provua me dokumentacion ligjor fakti i marrëdhënie të punësimit të tij deri në datën 4.11.2001, por nuk u arrit të provohej vlera e të ardhurave të fituara prej tij deri në momentin e dhënies së huas më 30.10.2005;
- d) nuk ka dokumentacion ligjor mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore, taksat dhe fitimin *neto* nga ana e tatimpaguesit S.K., si person fizik me aktivitet tregtar, berber.

**1.18.8** Në funksion të barrës së provës, lidhur me provueshmërinë ligjore të krijimit të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të llojit truall dhe ndërtesë me sip. 159 m<sup>2</sup>, subjekti rivlerësimit, pas dërgimit

<sup>21</sup>Pyetësori standard, përgjigjja 19.

<sup>22</sup>Pyetësori nr. 2, përgjigjja 1.3.

<sup>23</sup>Vërtetim për të vetëpunësuarit nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2006, e ISSH-së për shtetasin S. K., në të cilën profesioni i tij është berber dhe për periudhën 22.7.1992 – 31.12.2001 ka derdhur sigurime shoqërore; librezë pune e shtetasit S. K., në të cilën rezulton marrëdhënia e punës si berber prej datës 15.7.1977 deri më 4.7.2001; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.11.2020, me deklaruat A. V., i cili deklaroi se: “Nga viti 1977 - 2010 shtetasi S. K. ka punuar berber. Fillimisht kemi punuar në kinemaja e vjetër dhe pastaj në objektin që kemi privatizuar bashkë”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, në të cilën informon se shtetasi S. K. ka qenë regjistruar me kod fiskal nr. \*\*\* në datën 6.3.1993, me aktivitet berber; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, e ISSH-së, me në të cilën rezultoi se shtetasi S.K. është siguruar si person fizik për periudhën 22.7.1992 – 4.11.2001.

të rezultateve të hetimit, parashtroi se: “(a) Shuma e marrë hua është deklaruar në DIPP të vitit 2005, në rubrikën ‘detyrime’, pra, në vitin e marrjes së huas. Shlyerjet e saj janë deklaruar në DIPP-të e viteve 2006 dhe 2007, pra, të viteve ku ato janë shlyer (shuma 700 000 lekë në vitin 2006 dhe shuma 800,000 lekë në vitin 2007). Data e marrjes së huas, datë 30.10.2005, përkon me datën e lidhjes së kontratës së blerjes së truallit, datë 11.11.2005, pra, të kontratës për realizimin e të cilës është marre kjo shume hua (qëllimi i huas ka qenë blerja e truallit të banesës). Nga deklarata noteriale e babait të bashkëshortit tim S. K., të cilën po e bashkëngjiti, deklaratë noteriale nr\*\*\*, datë 10.7.2021, vërtetohet si marrja e huas ashtu edhe shlyerja e saj. Është pamundësi për të paraqitur dokumentacion për të vërtetuar ekzistencën e kësaj kontrate, si dhe shlyerjet e shumës së marrë hua prej bashkëshortit tim, qoftë dhe duke paraqitur një deklaratë nga huadhënësi S. K. . Kjo, pasi ai ka ndërruar jetë në datën 8.6.2019 ... dhe me familjaret e tij aktualisht nuk ekzistojnë marrëdhënie të mira. (b) Në lidhje me aftësitë huadhënëse të shtetasit S. K., vlerësoj se ai ka pasur mundësi të jepte shumën e mësipërme hua në favor të bashkëshortit tim J. K.; (c) Në lidhje me punën e tij, në kohën para demokracisë, ajo është e provuar dhe e pranuar dhe nga ana Juaj në rezultatet e hetimit kryesisht, ku sipas shkresës së Arkivit Qendror të ISSH-së Tiranë, ka rezultuar se ai ka qenë në marrëdhënie pune prej datës 13.7.1963 –27.11.1991, në profesione të ndryshme, nga të cilat ka punuar si berber në periudhën: 9.9.1976 –21.11.1991. Po kështu, vitet e punës së tij janë pasqyruar dhe në librezën e tij të punës, të cilën e kam depozituar bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, nga rezulton puna e tij si berber në periudhën: 15.7.1977 – 4.7.2001; (d) Ai ka privatizuar dyqanin(njësinë) ku ka punuar si berber në kohën para demokracisë, privatizim i bërë në bazë të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 ‘Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit’. Nga librezja e punës së shtetasit S. K., bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, rezulton marrëdhënia e tij e punës si berber në periudhën 15.7.1977 – 4.7.2001;(e) Në lidhje me mosekzistencën e dokumentacionit për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e shtetasit S. K., pavarësisht se sa më sipër, ka qenë një detyrim i tij, unë nuk mund të jap shpjegime sot në lidhje me këtë fakt, pasi ai nuk ka të bëjë me një veprim i cili duhet të kryhej nga unë ose nga bashkëshorti im”.

**1.18.9** Në analizë të llogarive bankare të depozituara nga subjekti rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, rezultoi se z. S. K. në datën 16.10. 2005, ka pasur gjendje në depozitë në shumën 2,686,614.09 lekë, në BKT. Ndërsa në vitin 2006 në të cilën subjekti deklaroi se i ka shlyer shumën 700,000 lekë në datën 21.11.2006, si datë e fundit në të cilën janë kryer veprime në llogari rezulton me gjendje në vlerën 2,191,014 lekë. Në vitin 2007 e konkretisht në datën 9.8.2007, në të cilën subjekti deklaroi se i ka shlyer shumën 800,000 lekë nuk rezultoi të jenë kryer veprime bankare në këtë llogari. Në vitin 2007 nuk rezultojnë veprime bankare në të dyja llogaritë bankare për shtetasin S. K.

**1.18.10** Në seancë dëgjimore, vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me deklarin nga subjekti i rivlerësimit të huas në vlerën 1.500.000 lekë si burim krijimi të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall+ ndërtesë, ka parashtruar dhe iu drejtua subjektit të rivlerësimit nisur nga se si subjekt ka bërë deklarin e parë në vitin 2003 dhe në vitin 2005, pra, dy vjet më pas, duke qenë një person i logjikshëm dhe në njohje shumë mirë të kuadrit ligjor të legjislacionit të ILDKPKI-së dhe përgjegjësisë si subjekt deklarues, pra, pas zbatimit dhe implementimit të ligjit përkatës dhe rregullores së ILDKPKI dhe duke qenë subjekt deklarues prej dy vjetësh, tashmë në vitin 2005, duke qenë edhe gjyqtare, duke ditur ligjin keni marrë hua xhaxhait të burrit në shumën 1,500,000 lekë pa asnjë kontratë, pa asnjë dokument provues pas asnjë gjurmë transferte parash për shlyerjen në vitin 2006 dhe në vitin 2007, duke e përdorur si burim origjinë të parave për të justifikuar ndërtimin e vilës tuaj trekatëshe që është pronë ekskluzive e bashkëshortit tuaj. Duke qenë gjyqtare dhe subjekt deklarues në ILDKPKI jeni në dijeni të plotë të kritereve ligjore dhe që gjithçka duhet të provohet me dokumente. Nga hetimi është zbuluar faktin se xhaxhai i burrit ka pasur gjithsej kursime 2.5 milionë lekë nga gjithë jeta e tij, nga puna e tij e ndershme me orare të zgjatura si berber, kaq ka pasur mundësi të kursejë gjithë jetën e tij dhe si ka mundësi që

ai ju ka dhënë juve 1.5 milionë lekë hua pa asnjë shkresë pa asnjë afat ripagimi /shlyerje, le të themi si dhuratë (nëse jua ka dhënë vërtetë sepse nuk ka gjurmë për këtë transfertë/borxh). Duket e çuditshme e tëra kjo sepse për faktin e të qenit gjyqtare e subjekt rivlerësimit jeni, jo thjesht një person i zakonshëm, sigurisht jeni njeri, por duke qenë gjyqtare duhet gjithnjë të paraqesësh prova dhe dokumentacione jo thjesht të deklarosh diçka. Si do ta vlerësonit, nëse dikush do të vinte në zyrën tuaj, duke ju thënë shumë gjëra në mënyrë deklarative pa sjellë asnjë provë, pra, nëse kjo do të ishte çështja juaj si gjyqtare a nuk do të kërkonit ju dokumente dhe prova si gjyqtare, si do ta vlerësonit, pra, vër veten në vendin e trupës së Komisionit. Në vijim vëzhguesi ndërkombëtar parashtrori se dëgjoi dhe i lexoi shpjegimet e dhëna nga subjekti për këtë çështje që pretendoni se ka thënë gjithçka, por nuk ato nuk ishin bindëse për të.

**1.18.11** Në përgjigje të parashtrimeve dhe pyetjeve gjatë seancës dëgjimore të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit, përgjigjet se : *“Për sa i përket kontratës së huas me xhaxhain e bashkëshortit tim, sikurse e kam sqaruar, këto kanë qenë marrëdhënie të ngushta familjare, janë dhënë në kushtet e mirëbesimit të plotë. Shtëpia e banimit është ndërtuar nga bashkëshorti im dhe nga babai i tij dhe babai i bashkëshortit tim me huadhënësin kanë qenë vëllezër dhe, pikërisht, duke u nisur nga marrëdhëniet e ngushta midis dy vëllezërve kontrata është dhënë, më falni, kontrata është bërë me gojë d.m.th., lekët janë dhënë pa kontratë me shkrim, ky është shpjegimi që mund të jap lidhur me këtë shumë, me këtë pyetje”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.18.12** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe pas dërgimit të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, çmon se në zbatim të neneve 1050 dhe 1055 të Kodit Civil, kontrata e huas është një kontratë jo formale, pra, si kusht për vlefshmërinë e saj është vullneti i palëve dhe dhënia në pronësi e një shume të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie. Në rastin konkret jeni para situatës kur:

**1.18.13** Marrja dhe dhënia e huas është bërë jashtë sistemit bankar dhe e vetmja provë shkresore për ekzistencën e saj është DIPP-ja e vitit 2005 dhe DIPP-të 2006 dhe 2007, për pasojë, të pamjaftueshme për të provuar dhënien dhe shlyerjen e huas.

**1.18.14** Në analizë të provave të administruara nga subjekti, trupi gjykues çmon se në rastin konkret nuk gjen zbatim pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**1.18.15** Subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të huas në shumën 1,500,000 lekë, dhënë nga shtetasi S.K., pasi nuk u arrit të provohej bindshëm dhe në mënyrë shteruese vlera e të ardhurave të fituara prej tij deri në momentin e dhënies së huas, në datën 30.10.2005.

### **1.19 Dy kredi të marra në “Alpha Bank”, kredia e parë me vlerë 30,000 euro dhe kredia e dytë me vlerë 2,500,000 lekë**

**1.19.1** Në deklaratën e pasurisë “*Vetting*”<sup>24</sup>, subjekti ka deklaruar se: *“Kredi e marrë në ‘Alpha Bank’, me kontratën nr. \*\*\*, datë 6.4.2007, kontratë me akt noterial nr. \*\*\*, datë 9.4.2007, me vlerë 30,000 euro, afati 20 vjet. Qëllimi i saj ka qenë përfundimi i punimeve për ndërtimin banesës. Kjo kredi ka filluar të shlyhet pas marrjes së kredisë dhe vazhdon të shlyhet edhe sot. Shuma e mbetur pa shlyer deri në plotësimin e deklaratës *Vetting* me 6,612 euro”.*

**1.19.2** **Për kredinë në vlerën 30,000 euro**, në seksionin e detyrimeve në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar se: *“Shtuar në datën 9.4.2007, marrje kredie nga ‘Alpha Bank’, Korça Branch, në vlerën 30,000 euro”.*

---

<sup>24</sup>Shihni Aneksin nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së; subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 6.4.2007, me kredimarrës J. dhe Ariola Kristo në “Alpha Bank”, për financimin e projektit prej 30,000 euro, me këst mujor 210 euro.

**1.19.3** Për kredinë në vlerën 2,500,000 lekë, në deklaratën *Vetting*, subjekti<sup>25</sup> deklaroi se: “Kredi e marrë nga ‘Alpha Bank’, me kontratë nr. \*\*\*, datë 30.6.2008, kontratë me akt noterial nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, me vlerë 2,500,000 lekë, me afat 15-vjeçar me qëllim rikonstruksion banese. Kjo kredi ka filluar të shlyhet pas marrjes së kredisë dhe është shlyer plotësisht në datën 11.11.2011. Kësti mujor ka qenë në vlerën 24,415.87 lekë”.

**1.19.4** Ndërsa në DIPP të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Shtuar në datën 30.6.2008, pasuri monetare marrje kredie nga ‘Alpha Bank’, Korça Branch, me kontratën nr. \*\*\*, datë 30.6.2008, në vlerën 2,500,000 lekë, pjesa takuese 50 %”.

**1.19.5** Në DIPP të vitit 2011, subjekti ka deklaruar se: “Marrja e një huaje në vlerën 2,500,000 lekë nga shtetasi Th. L., me kontratë nr. \*\*\*, data 18.10.2011. Hua e cila është përdorur për shlyerjen totale të kredisë marrë në ‘Alpha Bank’, me kontratën nr. 2565/2, datë 30.0.2008”.

**1.19.6** Gjatë hetimit<sup>26</sup> të Komisionit, subjekti deklaroi se: “Shpenzimet për mobilimin e shtëpisë janë mbuluar nga kredia e marrë në ‘Alpha Bank’, me kontratën nr. \*\*\*, datë 30.6.2008”.

Nga korrespondenca e Komisionit me institucione publike rezultoi si vijon:

**1.19.7** “Alpha Bank”<sup>27</sup> përcjellë në Komision, shtesë kontratë për kufi kredie shumëqëllimore nr. 904/509, datë 9.4.2007, për përfitimin e kredisë nga shtetasit J. dhe Ariola Kristo, në shumën 30,000 euro. Në kontratë përshkruhet se me kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 6.4.2007, i është akorduar kredia në shumën 35,000 euro, me afat 20 vjet. Nga kjo kredi deri në nënshkrimin e shtesës së kontratës është përdorur vlera prej 30,000 euro, e cila përcaktohet se do të jetë kufiri i ri i kredisë (jo vlera 35,000 euro). Në kontratë është cituar se kosto e projektit është në vlerën 83,300 euro (rreth 10,071,803 lekë) dhe se kontributi i huamarrësit do të jetë në vlerën 57,300 euro, ndërsa pjesa tjetër do të financohet nga banka. Nga hetimi i llogarive bankare rezultoi se vlera e pashlyer e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* përputhet me vlerën e pashlyer të kredisë të përcjellë nga “Alpha Bank”. Rezulton se vlera e kredisë është tërhequr *cash* nga bashkëshorti i subjektit.

**1.19.8** Gjithashtu, për kredinë në vlerën 2,500,000 lekë, “Alpha Bank” përcjell kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, akorduar shtetasve Ariola dhe J. K., me qëllim rikonstruksion banese. Rezulton se kjo kredi është likuiduar në datën 11.11.2011 nga derdhje cash të subjektit në llogarinë e tij bankare dhe jo nga transfera bankare. Subjekti deklaroi se për likuidimin e kredisë ka marrë hua vlerën 2,500,000 lekë prej shtetasit Th.L. .

**1.19.9** Në analizë të sa më sipër gjatë hetimit, Komisioni konstatoi se ka mospërputhje në deklarimin e subjektit gjatë hetimit, lidhur me qëllimin e përdorimit të kredisë me vlerë 2,500,000 lekë, e cila është deklaruar për mobilimin e shtëpisë, me qëllimin e saj të përcaktuar në kontratën e kredisë, cilësuar si rikonstruksion banese.

**1.19.10** Lidhur me këtë konstatim me parashtrime për rezultatet e hetimit, subjekti shpjegoi se: “Në lidhje me mospërputhjen që ka të bëjë me destinacionin e përdorimit të shumës prej 2,500,000 lekë, objekt i kontratës së kredisë të lidhur me ‘Alpha Bank’ nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, ku në kontratë është përcaktuar destinacioni i saj “rikonstruksion banese”, ndërkohë që kam deklaruar se ajo është përdorur për mobilimin e shtëpisë. Në lidhje me sa më sipër, sqaroj se pavarësisht nga emërtimi që ka pasur destinacioni i marrjes së kredisë në kontratën e kredisë, pra, “rikonstruksion banese”, emërtim i vendosur nga banka, e cila ka qenë pala që ka përpiluar kontratën, realisht kjo shumë nuk është përdorur për rikonstruksion banese, por për mobilimin e saj. Sa më sipër, rezultoi nga fakti se në atë kohe sapo kishte përfunduar ndërtimi i shtëpisë së re ... Në deklaratën *Vetting*, ku kam deklaruar se qëllimi i marrjes të kredisë ka qenë mobilimi

<sup>25</sup>Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. \*\*\*, datë 30.6.2008, me kredimarrës J. dhe Ariola Kristo, për marrjen nga “Alpha Bank” të shumës 2,500,000 lekë.

<sup>26</sup>Pyetësori standard, përgjigjja nr. 14.

<sup>27</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2020, të “Alpha Bank”.

*i shtëpisë, kam deklaruar qëllimin real të marrjes së asaj kredie. Kjo, rezulton dhe nga fakti se leja e shfrytëzimit të shtëpisë është dhënë nga Bashkia Korçë me shkresën nr. \*\*\*, datë 08.07.2008 e normalisht shtëpia pas përfundimit të ndërtimit të saj, do të kishte nevojë për mobilim. Në momentin e marrjes së kredisë, qëllimi i bashkëshortit tim dhe i imi ka qene marrja e shumës së mësipërme të kredisë nga banka e nuk i kemi kushtuar rendësi qëllimit të përdorimit të kredisë të përcaktuar në kontratë”.*

**1.19.11** Subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim edhe në shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore lidhur me destinacionin e përdorimit të kredisë në vlerën 2,500,000 lekë marrë në “Alpha Bak”, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 8.7.2008, akorduar Ariola dhe J. K. me qëllim rikonstruksion banese.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.19.12** Trupi gjykues çmon se pasaktësia në deklaram e destinacionit të përdorimit të kësaj kredie do të vlerësohet në vlerësimin përfundimtar për kriterin e pasurisë.

### **1.20 Hua marrë nga shtetasi Th. L., në shumën 2,500,000 lekë, me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2011**

Kjo shumë është përdorur kryesisht për të shlyer kredinë e dytë nga “Alpha Bank”, në vlerën 2,500,000 lekë.

**1.20.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë marrjen e huas të lartpërmendur në DIPP-në e vitit 2011, në të cilin deklaroi: *“Marrje huaje në vlerën 2,500,000 lekë nga shtetasi Th. Ll. me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011. Hua e cila është përdorur për shlyerjen totale të kredisë marrë në ‘Alpha Bank’, me kontratë nr. \*\*\*, datë 30.6.2008.”*

**1.20.2** Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje dhe shumat, ndër vite, në DIPP-të nga viti 2012 deri në vitin 2018, subjekti ka deklaruar si vijon:

a) Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *“Kursime në vlerën 300,000 lekë, që janë përdorur për shlyerjen e një pjese të huas së marrë nga z. Th. L., në kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, në vlerën 2,500,000 lekë”.*

b) Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Kursime në vlerën 300,000 lekë, që janë përdorur për shlyerjen e një pjese të huas së marrë nga z. Th. L., në kontratën nr.\*\*\*, datë 18.10.2011, në vlerën 2,500,000 lekë”.*

c) Në DIPP të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Hua e marrë z. Th. L. me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, shuma e shlyer 500,000 lekë”.*

d) Në DIPP të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Hua e marrë z. Th.L., me kontratën nr.\*\*\*, datë 18.10.2011, shuma e shlyer 500,000 lekë”,* ndërsa bashkëshorti i subjektit në deklaramin e interesave private periodike të vitit 2016 deklaroi: *“Hua e marrë z. Th. L. me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, shuma e shlyer 600,000 lekë”.*

e) Në DIPP-ë të 2016 u konstatua se kishte mospërputhje të shumës së deklaruar nga subjekti me atë të deklaruar nga bashkëshorti i subjektit për likuidimin e kësaj huaje. Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se: *“... mospërputhja që ekziston në lidhje me shumën e shlyer të kësaj huaje në DIPP-në e vitit 2016 midis deklaramit tim në shumën 500,000 lekë dhe deklaramit të bashkëshortit tim në shumën 600,000 lekë, është një lapsus, pra, një gabim material në plotësimin e deklaramit”.*

f) Në DIPP-të për vitet 2017 dhe 2018, subjekti deklaroi: *“... hua e marrë z. Th. L. me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, gjendjen e pashlyer të këtij detyrimi në vlerën 800,000 lekë”.*

**1.20.3** Subjekti i rivlerësimit bashkëlidh në pyetësorin standard deklaramit noteriale nr.\*\*\*, datë 24.4.2020, në të cilën bashkëshorti i subjektit dhe shtetasi Th.L. kanë deklaruar se: *“Në datën e përpilimit të deklaramit ka marrë në formën e huas nga shtetasi Th.L., shumën 2,500,000 lekë,*



*për një afat të pacaktuar, me të drejtën e huadhënësit për të kërkuar kthimin e shumës në çdo kohë, si dhe detyrimin që në momentin që do të kërkohet kthim i shumës, t'i paguaj huadhënësit edhe vlerën e interesit bankar nga momenti i marrjes së huas deri në ditën e kthimit". Huadhënësi Th. L., deklaroi se: "... këtë shumë të hollash të kursyer nga puna si brenda edhe jashtë vendit, është dakord t'ia japë huamarrësit J.K."*

**1.20.4** Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, palët kanë parashikuar se së bashku me shumën e marrë hua do të likuidoheshin edhe interesat e huas.

**1.20.5** Nga hetimi Komisionit rezultoi se nuk ishin likuiduar interesat e huas, sipas parashikimeve të deklaratës noteriale të vitit 2011. Subjekti në DIPP-të për vitet 2012 – 2018 ka deklaruar vetëm vlerën e shlyerjes së huas, por jo interesa dhe nga llogaritë bankare nuk rezultojnë pagesa për shlyerje interesash huaje për z. Th. L. .

**1.20.6** Gjithashtu, lidhur me këtë hua nga hetimi Komisionit, rezultoi se shuma e huas është dhënë *cash* nga z. Th. L. në vitin 2011 dhe kthimi i saj gjatë viteve 2012 – 2018 është bërë përsëri *cash* nga bashkëshorti i subjektit J. K. .

**1.20.7** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë konstatim, parashitroi se: *"Në lidhje me huan e marrë prej bashkëshortit J. K. nga shtetasi Th. L. me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, sqaroi se mospërputhja që ekziston në lidhje me shumën e shlyer të kësaj huaje në DIPP të vitit 2016 midis deklaramit tim prej 500,000 lekësh dhe deklaramit të bashkëshortit tim prej 600,000 lekësh, është një lapsus, pra, një gabim material në plotësimin e deklaratës. Vlera reale e shlyer në vitin 2016 ka qenë vlera prej 600, 000 lekësh. Kjo vlerë është në përputhje dhe me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.4.2020, bashkëngjitur pyetësorit standard, ku bashkëshorti J.K. dhe shtetasi Th. L., kanë deklaruar se deri në datën e përpilimit të deklaratës janë shlyer nga huaja e dhënë 2,300,000 lekë dhe pjesa tjetër prej 200,000 lekësh janë shlyer në datën e përpilimit të asaj deklaratë, rezultoi se shuma e shlyer në vitin 2016 ka qenë vlera 600,000 lekë.*

*Lidhur me likuidimin e interesave të huas, në lidhje me interesat, sqaroi se pavarësisht se në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, të hartuar nga bashkëshorti im J. K. dhe shtetasi Th.L. është parashikuar dhe pagimi i interesave të huas në momentin e kthimit të shumës së marrë hua, ashtu sikurse rezultoi dhe në pasqyrimet e deklaratat periodike vjetore e në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.4.2020, bashkëngjitur pyetësorit standard, të hartuar nga bashkëshorti im J. K. e shtetasi Th. L., nuk rezultoi se të jenë paguar interesat. Kjo, pasi sipas fakteve të mësuar nga bashkëshorti im, i cili ka qenë personi që ka hyre në këtë marrëdhënie huaje me shtetasin Th. L., ky i fundit për shkak të marrëdhënieve miqësore e shoqërore midis tyre, ka deklaruar se nuk kërkonte interesat për shumën e dhënë hua. Sa më sipër është pasqyruar dhe në deklaratën e mësipërme noteriale të datës 24.4.2020, ku pas shlyerjes dhe të diferencës së mbetur pa shlyer nga huaja e marrë prej 200,000 lekë, te dy palët, pra, edhe huadhënësi Th.L., ka deklaruar se me marrjen e asaj shume, ata nuk kanë më asnjë detyrim, ose pretendim ndaj njëri-tjetrit, pra, as pretendime për pagimin e interesave".*

**Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të ardhurave për dhënie e huas nga z. Th. L.**

**1.20.8** Në cilësinë e provës për huan e marrë nga shtetasi Th. L., subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1 bashkëlidhi edhe akte të procedimit penal në ngarkim të shtetasit Th. L. të akuzuar për veprat penale parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal, "refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive".

**1.20.9** Referuar akteve të procedimit penal me nr. 47/2015 në ngarkim të shtetasit Th. L. rezultoi se:

a) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. 47/2015, për kallëzimin nr. \*\*\*, datë 13.1.2015, të ILDKPKI-së në ngarkim të shtetasit Th.L.,

për veprat penale parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal, “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive”.

b) Me vendimin e pushimit, datë 8.6.2008, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka pushuar çështjen penale me nr. \*\*\*/2015 të regjistruar për veprën penale, “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive”, në ngarkim të shtetasit Th.L., akuzuar për veprat penale parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal.

**1.20.10** Subjekti i rivlerësimit e pyetur nga Komisioni, nëse vendimi i pushimit nr. \*\*\*, datë 8.6.2008, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë sqaron se: “... vendimi nr. \*\*\*, datë 8.6.2016, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.” Subjekti i bashkëlidh<sup>28</sup> përgjigjes vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të cilën vërtetohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë nga verifikimi në arkiva nuk rezulton të ketë pasur ndonjë çështje penale me objekt ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*.

**1.20.11** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit dhe iu drejtuar Gjykatës<sup>29</sup> së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila përcjellë informacionin se pranë kësaj gjykate nga subjekti i rivlerësimit nuk janë gjykuar çështje civile me palë shtetasin Th. L. . Gjithashtu, Komisioni i drejtoi pyetje edhe subjektit të rivlerësimit nëse shtetasi Th. L. ka qenë pjesë e vendimmarrjes së saj të bashkëshortit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, përkatësisht si prokuror dhe gjyqtare pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila është përgjigjur: “Jo, asnjë prej tyre nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes sime apo të bashkëshortit tim”.

**1.20.12** Komisioni konstatoi se referuar akteve të procedimit penal, sipas kopjes së librezës së punës, shtetasi Th.L. ka punuar si vijon:

- a) për periudhën tetor 1998 – janar 1999, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;
- b) për periudhën shtator 1999 – nëntor 2000, në Kishën Ortodokse të Ungjillizimit Tiranë;
- c) për periudhën maj 2001– prill 2011, administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a;
- d) për periudhën mars 2008 – dhjetor 2010, ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.20.13** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë gjatë hetimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasit Th. L. ka kryer dhe aktin e ekspertimi financiar për të ardhurat e shtetasit Th. L. dhe bashkëshortes O. L. për periudhën kohore nga viti 1998 – 2014. Sipas aktit të ekspertimit dhe dokumentacionit të marrë në referencë për kryerjen e këtij akti rezulton si vijon:

a) Shtetasi Th. L., për periudhën 21.10.1998 – 23.1.1999, ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Për këtë periudhë mungon vërtetimi sa është paguar, por sipas deklarimeve të tij, paga ka qenë në vlerën 300,000 lekë/muaj. Paga për periudhën tetor 1998 – janar 1999 llogaritet në vlerën 90,000 lekë/muaj.

b) Llogaritja është bazuar në vërtetimin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë gjatë periudhës shtator 1999 – nëntor 2000, ku ka punuar pranë Kishës Ortodokse të Ungjillëzimit me NIPT \*\*\*. Në këtë dokument nuk ka pagë referuese, por shtetasi Th. L. ka deklaruar gjatë hetimit penal se ka punuar arkëtar dhe paguhej në shumën 300,000 lekë/muaj.

c) Të ardhura në total në Kishin Ortodokse të Ungjillëzimit në total për 15 muaj janë në vlerën 450,000 lekë.

<sup>28</sup>Pyetësor nr. 2, përgjigjja 1.3.

<sup>29</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

d) Gjatë periudhës 1.5.2001 – 30.5.2011, shtetasi Th.L. ka qenë administrator në shoqërinë “\*\*\*\*”, Fier. Sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*”, paga *neto* e përfituar nga shoqëria si administrator është në vlerën 1,943,820 lekë.

e) Në periudhën maj 2004 – shkurt 2005 ka punuar në shoqërinë “\*\*\*\*” dhe ka marrë një pagë *bruto* në vlerën 180,000 lekë dhe *neto* 158,850 lekë si punëtor.

f) Në periudhën prill 2009 – dhjetor 2010, shtetasi Th. L. ka punuar në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Sipas vërtetimit të lëshuar nga kjo shoqëri paga *neto* në vlerën 582,000 lekë.

g) Në periudhën shkurt 2013 – shkurt 2014, shtetasi Th. L. ka punuar në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimore Korçë paga *neto* është në vlerën 386,170 lekë.

h) Shtetasit Th.L., në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka deklaruar se për periudhën 1992 – 1996 ka punuar në punë sezonale në Greqi dhe të ardhurat e kësaj periudhe janë në vlerën 400,000 lekë.

i) Po sipas deklaratës së shtetasit Th. L., nga puna në kambizëm dhe dhënia me fajde e lekëve ka pasur të ardhura në vlerën 4,000,000 lekë.

**1.20.14** Pra, sipas aktit të ekspertimit financiar, në total të ardhurat e shtetasit Th. L., për periudhën 1998 – 2014, rezultojnë në vlerën 13,148,013 lekë. Të ardhurat në total të shtetasit Th.L. së bashku me bashkëshorten O.G.(L.), sipas aktit të ekspertimit i kryer gjatë procedimit penal, janë në vlerën 15,935,889 lekë.

**1.20.15** Pavarësisht të dhënave dhe rezultateve financiare të referuara sa më sipër, Komisioni analizoi burimin e ligjshëm dhe aftësinë huadhënëse të shtetasit Th. L., bazuar në ligjin nr. 84/2016 “ Për procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

**1.20.16** Për të provuar aftësinë huadhënëse të z. Th.L., e pyetur nga Komisioni gjatë hetimit për huan e marrë nga bashkëshorti prej tij, subjekti gjatë hetimit deklaroi se: “... *kam vënë në dispozicion vendimin e pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*/2015, regjistruar në emër të shtetasit Th. L. për veprën penale të refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes, ose deklarimit të rremë të pasurive dhe pastrimit të produkteve të veprës penale, parashikuar përkatësisht nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal. Në këtë procedim penal është trajtuar dhe huaja prej 2,500,000 lekësh dhënë bashkëshortit. Në këtë vendim penal pasqyrohet fakti se ky shtetas ka qenë emigrant ekonomik në Greqi, në lidhje me të cilën në kushtet e punësimit informal, sikurse shumica e shqiptarëve në Greqi ai nuk disponon dokumentet përkatëse provuese. Po kështu, në vendimin e pushimit të prokurorisë thuhet dhe se ai ka punuar si kambist i pa licensuar në qytetin e Korçës fakt i konfirmuar sipas prokurorisë dhe nga deklaratuesit e pyetur në atë procedim”.*

**1.20.17** Referuar informacionit të përcjellë nga QKB<sup>30</sup>-ja dhe atij të gjeneruar nga QKB-ja *online*, shtetasi Th. L. rezulton të ketë qenë administrator dhe ortak 100% të kuotave të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., regjistruar prej datës 13.2.2001 dhe larguar më 27.10.2011. Duke administruar kopjen e librezës së punës, nga procedimi penal i prokurorisë, rezultoi se për periudhën tetor 1998 – janar 1999, shtetasi Th.L. ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, prej shtatorit 1999 – nëntor 2000, ka punuar pranë Kisha Orthodhokse të Ungjillëzimit Tiranë, për periudhën maj 2001 – prill 2011, si administrator shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe për periudhën mars 2008 – dhjetor 2010 ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.20.18** Gjithashtu, pjesë e procedimit penal nga prokuroria është edhe kontrata e blerjes së 1539 kuota aksione të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., Shijak, me kontratën nr. \*\*\*, datë 24.3.2004, me vlerë totale 2,179,224 lekë. Nga hetimi i Komisionit në QKB *online* rezultoi se shoqëria “\*\*\*\*”

<sup>30</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020.

sh.a. me NIPT \*\*\* është regjistruar në vitin 2002 dhe prej saj u aksesua kontrata e mësipërme e blerjes së kuotave të kësaj shoqërie nga shtetasi Th. L. dhe kontrata e shitjes<sup>31</sup> së tyre në datën 15.7.2005, me vlerë shitje 3,100,000 lekë.

**1.20.19** Ndërsa sipas aktit të ekspertimit të procedimit penal nga prokuroria, i cili i referohet vërtetimit të drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë, rezultoi se bashkëshortja ka punuar prej janarit 2008 dhe në vazhdim si edukatore dhe në aktin e ekspertimit referohen pagat *neto* të përfituara prej saj.

**1.20.20** Nga hetimi i llogarive bankare<sup>32</sup> të tij rezultoi se shtetasi Th.L. ka bërë veprime bankare me vlera të konsiderueshme si: depozitimi i vlerës 2,000,000 lekë, datë 8.2.2001, për kapital themeltar për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., e cila është tërhequr si vlerë pas një dite dhe transferimi i vlerës 2,500,000 lekë, datë 19.8.2005, në llogarinë e tij pranë “Tirana Bank”, për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a.

**1.20.21** Duke u mbështetur në informacionet e rezultuara nga hetimi i Komisionit u hartua analiza financiare në tabelën e mëposhtme, në lidhje me aftësinë huadhënëse të z. Th. L. . Në analizë u konsideruan të ardhurat nga shitja e aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. pas zbritjes së tatimit mbi të ardhurat personale.

<i>Analiza financiare</i>	<i>2005</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>1.1.2011– 11.10.2011</i>	<i>Totali 2005- 11.10.2011(vlerat në lekë)</i>
Të ardhura Th.L. nga shitja e aksioneve të shoqërisë “****”, më 15.7.2005	2,790,000					<b>2 790 000</b>
Të ardhura nga paga e bashkëshortes O.L. (G.)		290 446	358 380	386 957	300 682	<b>1 336 465</b>
Shpenzime jetike për 2 persona	219 114	273 240	273 240	273 240	273 240	<b>1 312 074</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>2 570 886</b>	<b>17 206</b>	<b>85 140</b>	<b>113 717</b>	<b>27 442</b>	<b>2. 814 391</b>

## Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, nisur nga analizimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ, deklaratimet e subjektit dhe analizës financiare të kryer lidhur me burimin e krijimit, çmoi se huadhënësi Th. L. ka pasur mundësi të krijojë të ardhura nga burime të ligjshme dhe, për pasojë, të japë hua vlerën 2,500,000 lekë, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në datën 11.10.2011.

### 1.21 Kursime të bashkëshortit, subjektit dhe/apo prindërve të tij para martesës së tyre

Subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting* ka deklaruar: “*Para fillimit të punimeve për ndërtimin e banesës janë mbledhur kursimet para martesës sime dhe të bashkëshortit dhe të prindërve të tij, që së bashku kanë qenë në vlerën 2,197,576 lekë. Këto kursime kanë qenë të grumbulluara në dy llogari bankare, në “Tirana Bank”, në një depozitë mujore me vlerën 1,454,295 lekë, mbyllur më 19.12.2005 dhe në një depozitë 6-mujore në vlerën 743,281 lekë, mbyllur më 2.10.2005 dhe në “ProCredit Bank” shumën 400,000 lekë kursime të mëparshme”.*

**1.21.1** Subjekti i ka bashkëlidhur<sup>33</sup> deklaratës së pasurisë *Vetting* kopje të statement bankar të “Tirana Bank”, në të cilin rezultoi se në datën 19.12.2005, z. J. K. ka tërhequr vlerën e depozitës

<sup>31</sup>Shihni faqen zyrtare të QKB-së, kontrata e shitjes së kuotave nr. \*\*\*, datë 15.7.2005.

<sup>32</sup>Shkresë e “Tirana Bank” dosja e Komisionit.

<sup>33</sup>Aneks 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

të hapur pranë kësaj banke dhe statement të “ProCredit Bank”, në të cilin konfirmohet deklarimi i subjektit për tërheqjen e shumës 743,281 lekë e mbajtur si depozitë.

**1.21.2** Vlerat e depozitave sa më sipër konfirmohen<sup>34</sup> edhe nga veprimet bankare pranë “Tirana Bank” dhe “ProCredit Bank”.

**1.21.3** Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Blerje trualli me sip. 159 m<sup>2</sup> ndodhur në qytetin e Korçës, me vlerë 1,900,000 lekë”* dhe në seksionin e detyrimeve ka deklaruar: *“Vlera 1,500,000 lekë marrë hua nga S. K. për blerjen e truallit të përshkruar në fletën 3, detyrim i lindur në datën 30.10.2005, në bazë të një kontrate të lidhur pa afat në të njëjtën datë”*.

**1.21.4** Subjekti në asnjë prej DIPP-ve për vitet 2003 – 2006, nuk deklaroi gjendje *cash*, kursime apo dhe depozitat në “Tirana Bank” dhe “ProCredit Bank” .

**1.21.5** E pyetur<sup>35</sup> nga Komisioni mbi mosdeklarimin e depozitave, subjekti gjatë hetimit deklaroi se:<sup>36</sup> *“...janë mbledhur kursimet para martese të prindërve të bashkëshortit që së bashku kanë qenë në vlerën 2,197,576 lekë. Këto kursime kanë qenë të grumbulluara në dy llogari bankare, një në ‘Tirana Bank’, në një depozitë mujore në vlerën 1,454,295 lekë, mbyllur në datën 19.12.2005 dhe në një depozitë 6-mujore në vlerën 743,281 lekë, mbyllur në datë 2.10.2005, në ‘ProCredit Bank’. Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga prindërit e bashkëshortit tim, ... sqaroj se ata të dy kanë qenë mësues që në momentin e përfundimit të shkollës së lartë e deri në momentin e daljes në pension...përveç kësaj, babai i bashkëshortit tim, i quajtur S. K., krahas punës si mësues, ka punuar kamerier në një lokal në qytetin e Korçës, prej nga ka siguruar të ardhura. Në lidhje me këtë punë të tij, nuk disponohet kontratë pune e as janë paguar sigurime, pasi në të njëjtën kohë ai ka qenë mësues, punë kjo, e cila ka qenë e siguruar e janë paguar sigurimet përkatëse. Për të provuar sa më sipër, po paraqes një deklaratë noteriale nga punëdhënësi i tij, shtetasi Dh.L., nga vërtetohet: puna e tij, periudha e punës e paga përkatëse. Të nderuar, vlerësoj faktin se pas hetimit Tuaj të thelluar e objektiv, vlera e përfshirë në këto dy depozita prej 2,197,576 lekësh është marrë në konsideratë si vlerë e përdorur për ndërtimin e shtëpisë së banimit, pra, të krijimit të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë”*.

**1.21.6** Subjekti me shpjegimet<sup>37</sup> bashkëlidhi dokumentacionin justifikues ligjor për burimin e krijimit të tyre dhe provueshmërinë e padijenisë lidhur me këto depozita.

**1.21.7** Në lidhje me veprimet financiare për depozitat rezultoi nga hetimi<sup>38</sup> se:

**a)** Në datën 13.12.2002, në “Tirana Bank” është bërë depozitimi i vlerës 600,000 lekë nga J. K. në llogarinë e tij, e cila ka kaluar si depozitë 6-mujore. Në datën 23.7.2003, J. K. ka kryer depozitimin e shumës 670,000 lekë në këtë llogari, e cila ka kaluar si shtesë e depozitës ekzistuese. Në datën 16.12.2005 rezultoi mbyllja e depozitës dhe tërheqja e saj nga J. K. me vlerë 1,454,295 lekë.

**b)** Ndërsa depozita pranë “ProCredit Bank” është hapur në datën 10.2.2004, pas derdhjes në këtë datë të vlerës 700,000 lekë nga J. K. . Vlera e saj është rritur prej kapitalizimit të interesave dhe është tërhequr në datën 10.2.2005, në vlerën 743,281 lekë.

Ndërsa për mundësitë financiare të prindërve të bashkëshortit, bashkëshortit dhe të subjektit, për të krijuar këto depozita, u hartua analiza financiare e mëposhtme:

<sup>34</sup>Shkresë nr.\*\*\*prot., datë 1.12.2020, e “Tirana Bank” dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2020, e “ProCredit Bank”.

<sup>35</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigjja e pyetjes 1.2.

<sup>36</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigjja e pyetjes 1.2.

<sup>37</sup>Prova bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, përgjigjja 1.6 dhe deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 24.11.2020, në të cilën shtetasi S. dhe J. K. deklarojnë se: *“[...] për blerjen e truallit, marrjen e lejes, ndërtimin, pagesat për punët e kryera jemi marrë në të dy dhe bashkëshortet respektive nuk kanë qenë në dijeni. Gjithashtu, deklarojmë se që prej vitit 2002 ne kemi depozituar kursimet tona në dy llogari bankare. Këto kursime kanë qenë kryesisht të S.Dh.K. familjarisht, rreth 1,500,000 lekë dhe pjesa tjetër rreth vlera 400,000 lekë të J.K. . Për këto dy depozita nuk ka pasur dijeni asnjë person tjetër veç nesh si për depozitimin ashtu edhe për tërheqjen...”*.

<sup>38</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 1.12.2020, e “Tirana Bank” dhe shkresë nr. \*\*\*prot., datë 27.11.2020, e “ProCredit Bank”.

<i>Analiza financiare</i>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004 (vlerat në lekë)</b>
Të ardhura nga paga J. K.	118,775	493,017	854,511	1,100,404
Të ardhura nga paga M. K.	180,052	209,348	233,584	247,959
Të ardhura nga paga S.K.	174,835	193,058	209,923	227,170
Të ardhura nga paga Ariola Kristo		71,614	599,530	622,650
Të ardhura nga interesat bankare			25,580	84,887
Shtesat e likuiditete në bankë		600,000	670,000	700,000
Blerja e automjetit me targa ***		311,850		
Shpenzime jetike të llogaritur për 4 persona dhe nga 2001 për 5 persona	156,440	56,440	156,440	156,440
Shpenzime qiraje			30,000	120,000
Shpenzime udhëtimi		89,636 Lekë	419,319	87,451
<b>Rezultati financiar</b>	<b>317,222</b>	<b>- 190,890</b>	<b>647,369</b>	<b>1 219 179</b>

**Nga sa më sipër, duket se familjarët e subjekti të rivlerësimit dhe ajo vetë kanë pasur vetëm pamjaftueshmëri financiare në vitin 2002, në vlerën 190,890 lekë, për të krijuar depozitat bankare me kursimet nga të ardhurat prej pagave.**

Sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi nga hetimit rezultoi:

- **Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këto dy depozita në DIPP-të e viteve 2003 – 2006.**
- **Duket se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vitin 2002, në vlerën 190,890 lekë, për të krijuar depozitat bankare me kursimet nga të ardhurat prej pagave.**

**1.21.8** Lidhur konstatimin e Komisionit mbi këto dy depozita në emër të bashkëshortit në “Tirana Bank” dhe në “ProCredit Bank”, subjekti i rivlerësimit në parashtrime, pas dërgimit të rezultateve të hetimit deklaroi se:

**a) Në lidhje me arsyen e mosdeklarimit të këtyre dy depozitave në DIPP-të për vitet 2003 – 2006 dhe të deklarimit të tyre në deklaratën Vetting, u qëndroj deklaramëve të dhëna më parë në përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Në lidhje me arsyen e mosdeklarimit, u qëndroj deklaramëve të dhëna më parë në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe sqaroj se unë nuk kam qenë në dijeni të ekzistencës së saj.**

**b) Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre depozitave, sikurse kam deklaruar edhe më parë, pas sqarimeve të dhëna nga bashkëshorti im, jam vënë në dijeni se ato kanë përfshirë kursime të përbashkëta familjare të tij e të prindërve të tij (kryesisht të këtyre të fundit), të cilat më pas janë përdorur për ndërtimin e shtëpisë, e ndërtuar me qellim realizimin e jetesës së përbashkët;**

**c) Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga prindërit e bashkëshortit tim sqaroj se ata të dy kanë qenë mësues që në momentin e përfundimit të shkollës së lartë dhe deri në momentin e daljes në pension. Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, kam vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës nga DRSSH-ja Korçë në lidhje me vitet e punës së tyre si mësues, pjesë e dosjeve të tyre të pensionit. Përveç kësaj, babai i bashkëshortit tim, i quajtur S. K., krahas punës si mësues, ka punuar kamerier në një lokal në qytetin e Korçës, prej nga ka siguruar të ardhura. Në lidhje me këtë punë të tij, nuk disponohet kontrate pune e as janë paguar sigurime, pasi në të njëjtën kohë ai ka qenë mësues, punë kjo e cila ka qenë e siguruar e janë paguar sigurimet përkatëse. Për të provuar sa më sipër, kam paraqitur bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 një deklaratë noteriale nga punëdhënësi i tij, shtetasi Dh.L., nga vërtetohet: puna e tij, periudha e punës e paga përkatëse. Edhe në deklaratën e mësipërme noteriale të hartuar nga bashkëshorti im e babai i tij S. K., është pasqyruar fakti se këto dy depozita janë krijuar nga kursimet familjare si të familjes së babait të bashkëshortit tim S. K., ashtu dhe të bashkëshortit tim.**

d) *Nga analiza financiare e bëra ana juaj, në kuadër të hetimit administrativ të kryer, ka rezultuar se bashkëshorti im dhe familjarët e tij kanë pasur burime të ligjshme në krijimin e këtyre dy depozitave dhe të kursimeve, me përjashtim të vitit 2002”.*

**1.21.9** Lidhur me burimin e krijimit të këtyre depozitave, subjekti mban të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2, në të cilin ka paraqitur edhe deklaratën noteriale të z. Dh. L., punëdhënës i z. S. K. .

**1.21.10** Gjatë seancës dëgjimore, subjekti lidhur me mospasjen dijani të këtyre depozitave shpjegoi se: *“Për sa i përket mosdeklarimit të dy depozitave bankare që kanë qenë në emër të bashkëshortit tim në ‘Tirana Bank’ dhe ‘ProCredit Bank’ edhe për këtë ju qëndroj shpjegimeve të dhëna në qëndrimin tim ndaj raportit të vlerësimit, pra faktit se unë nuk kam pasur fare dijani për këto, ato kanë qenë pasuri e bashkëshortit tim dhe kryesisht kursime të prindërve të tij, unë në atë kohë realisht nuk kam qenë e martuar, martesa faktike është lidhur në vitin 2003 dhe në vitin e stazhit profesional të shkollës së magjistraturës ku unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, unë kam jetuar në banesë me prindërit e mi, sikurse e kam deklaruar dhe në pyetjet e procesit të rivlerësimit dhe nuk kam pasur dijani lidhur me këtë depozitë. Për herë të parë jam vënë në dijani për të në 2015 kur jemi thirrur nga ILDKPKI-ja për të bërë kontrollin që ju bëhet në mënyrë periodike gjyqtarëve dhe prokurorëve, aty jam vënë në dijani dhe më tha kam bërë deklarimin e kësaj shume”.*

**1.21.11** Lidhur me mundësitë financiare të prindërve të bashkëshortit, bashkëshortit dhe të subjektit, për të krijuar këto depozita, u hartua analiza financiare e pasqyruar në tabelën vijuese.

<i>Analiza financiare</i>	<i>2001</i>	<i>2002</i>	<i>2003</i>	<i>2004 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga J.K.	118,775	493,017	854,511	1,100,404
Të ardhura nga paga M. K.	180,052	209,348	233,584	247,959
Të ardhura nga paga S. K.	174,835	193,058	209,923	227,170
Të ardhura nga paga Ariola Kristo		71,614	599,530	622,650
Të ardhura nga interesat bankare			25,580	84,887
Shtesat e likuiditeteve në bankë		600,000	670,000	700,000
Blerja e automjetit me targa ***		311,850		
Shpenzime jetike të llogaritur për 4 persona dhe nga 2001 për 5 persona	156,440	56,440	156,440	156,440
Shpenzime qiraje			30,000	120,000
Shpenzime udhëtimi		89,636	419,319	87,451
<b>Rezultati financiar</b>	<b>317,222</b>	<b>- 190,890</b>	<b>647,369</b>	<b>1,219,179</b>

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.21.12** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe pas dërgimit të barrës së provës, si dhe bazuar në deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzion se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 190,890 lekë, për të krijuar depozitat bankare me kursimet nga të ardhurat prej pagave.

### **1.22 Në lidhje me deklarimin e subjektit në deklaratën Vetting, për vlerën 400,000 lekë kursime**

**1.22.1** Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Truall me sip. 159 m<sup>2</sup>, ndodhur në qytetin e Korçës, me vlerë 1,900,000 lekë”* dhe në seksionin e detyrimeve ka deklaruar: *“Vlera 1,500,000 lekë marrë hua nga S.K. për blerjen e truallit të përshkruar në fletën 3, detyrim i lindur në datën 30.10.2005, në bazë të një kontrate të lidhur pa afat në të njëjtën datë”.*

**1.22.2** Nga hetimi Komisionit rezultoi se: *“ Subjekti në asnjë prej DIPP-ve të viteve 2003 – 2006, nuk deklaroi gjendje cash, kursime apo dhe depozitat pranë ‘Tirana Bank’ dhe ‘ProCredit Bank’ ”.*

**1.22.3** Gjatë hetimit<sup>39</sup> subjekti deklaroi: “Data e blerjes së truallit është më 11.11.2005, vlerë tij është 1,900,000 lekë dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie janë: (a) kursime të mëparshme, në vlerën 400,000 lekë nga puna ime si gjyqtare dhe e bashkëshortit tim prokuror; dhe (b) huaja e marrë nga bashkëshortit im J. K. prej xhaxhait të tij S. K. në vlerën 1,500,000 lekë”.

**1.22.4** Lidhur me këtë konstatim, pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti shpjegoi mbi burimin kursime të mëparshme në vlerën 400,000 lekë, të cilat janë përdorur për blerjen e truallit me kontratën e datës 11.11.2005, se: “ Është e vërtetë se këto kursime nuk janë deklaruar si gjendje cash në DIPP-të për vitet 2003 – 2006, por sa me sipër ka qenë një pakujdesi në plotësimin e deklaratave nga ana ime dhe e bashkëshortit”.

**1.22.5** Komisioni duke u nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë *Vetting*, gjatë hetimit dhe me parashtrimet pas rezultateve të hetimit, ku deklarohet si burim për krijimin e banesës edhe shuma 400,000 lekë kursime, konsideroi dhe analizoi mundësinë për kursim të kësaj vlerë gjatë vitit 2005, deri në datën e blerjes së truallit më 11.11.2005, të paraqitur në tabelën vijuese:

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2005 – 11.11.2005 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhurat nga paga si gjyqtarë e subjektit	660 076
Të ardhurat nga paga si prokuror e bashkëshortit	671 419
Të ardhura nga interesat bankare	32 645
Pakësime likuiditete në bankë	- 872 496
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa ***	150 000
Blerja e automjetit ***	380 000
Shpenzime qiraje	100 000
Kursime të deklaruara nga subjektit në deklaratën <i>Vetting</i>	400 000
Shpenzime jetese	273 893
Shpenzime udhëtimi	269 626
<b>Rezultati financiar</b>	<b>963 118</b>

**1.22.6** Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të kursyer vlerën 400,000 lekë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* nga të ardhurat nga paga gjatë vitit 2015.

**1.23 Dhurim në vlerën 20,000 euro, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit (sasi monetare të cilën ia kanë dhuruar subjektit dhe bashkëshortit, për shkak se jetojmë në të njëjtën banesë)**

Këto të ardhura janë dërguar nga blerësi nga shteti grek, veprim që është dokumentuar te nxjerrja e llogarisë nga “ProCredit Bank” .

**1.23.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *Vetting* gjendje llogarie, datë 26.1.2017, nga “ProCredit Bank”, në emër të shtetasit S.K., për periudhën 1.1.2005 – 30.10.2010, ku figuron kreditimi/ transfertë ndërkombëtare në vlerën 21,967 euro, në datën 25.1.2008.

**1.23.2** Në DIPP-ë të vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “Dhuratë vlerë monetare nga prindërit e bashkëshortit në shumën 20,000 euro me pjesë takuese 50%”, pa deklaruar në këtë vit burimin e dhurimit.

**1.23.3** Burimi i këtij dhurimi deklarohet për herë të parë nga subjekti në deklaratën *Vetting*, duke saktësuar se janë të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit, në shumën 21,967 euro, por pa përcaktuar vitin apo datën e shitjes së kësaj pasurie.

<sup>39</sup>Përgjigjja nr. 9, pyetësi standard.



**1.23.4** Nga konsultimi me sistemin multifunksional të pasurive të paluajtshme (IPS), Komisioni konstatoi se kjo pasuri figuronte ende në emër të nënës së bashkëshortit të subjektit, znj. M. K.. Regjistrimi i kësaj pasurie si pronare e vetme e shtetasës M. K. ishte kryer në datën 9.1.2012.

**1.23.5** Nga konsultimi me sistemin dixhital të sistemit të pasurive të paluajtshme, bazuar në dokumentacionit e gjeneruar nga arkiva dixhitale e këtij sistemi, Komisioni konstatoi se:

a) Pasuria e llojit apartament banimi është fituar në mbështetje të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në emër të shtetasve S., M. dhe Th. K. . Pas vdekjes së shtetasës Th.K. më 2.8.2000, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është çelur dëshmia e trashëgimisë së saj, duke u përcaktuar dhe rrethi i trashëgimtarëve ligjor. Dëshmia e trashëgimisë është depozituar në ZVRPP-në Korçë dhe pasuria është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të të ndjerës Th. K. .

b) Me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.9.2012, rezulton se trashëgimtarët e shtetasës Th. K., përfshi dhe shtetasin S.K., i cili ka pjesën e tij takuese bashkëpronar në pasurinë me nr. \*\*\*, z. k\*\*\*, Korçë, i kanë shitur shtetasës M. K. pasurinë apartament nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Pasuria është regjistruar me pronare të vetme shtetasen M. K. .

**1.23.6** Komisioni iu drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila mbi konstatimet sa më sipër e pyetur nga Komisioni<sup>40</sup>, lidhur me kohën e shitjes së apartamentit të prindërve të bashkëshortit të subjektit, të cilin subjekti në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar si burim dhe mbi gjendjen faktike dhe juridike aktuale të kësaj pasurie, si dhe dokumentacion justifikues ligjor mbi tjetërsimet dhe veprimet juridike të kryera për pasuri gjatë hetimit, subjekti shpjegoi se:

*“ Lidhur më gjendjen juridike të saj ky apartament është privatizuar në datën 15.5.1993, në mbështetje të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, në emër të S. M. Th. K. . Pas vdekjes së shtetasës Th.K., në datën 2.8.2000, është çelur dëshmia e trashëgimisë dhe janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës dhe pjesët e tyre takuese. Në vijim, është realizuar një kontratë shitblerje me nr. \*\*\*, datë 9.9.2012, ku bashkëpronarët-trashëgimtar .....i kanë shitur pjesët e tyre takuese .....shtetasës M. K....në vijim, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 6.12.2012, shtetasja M.K. e ka shitur këtë pronë tek shtetasi S. Sh.(bashkëshorti i motrës së bashkëshortit tim, shtetasës M. Sh.). Aktualisht kjo pasuri, pra, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë, figuron e regjistruar në emër të shtetasve S. e M. Sh. .*

*Në lidhje me gjendjen faktike të kësaj pasurie, sqaroj se ... aty që në kohën para privatizimit e deri në fund të vitit 2008 kanë jetuar prindërit e bashkëshortit tim S. e M. K., me fëmijët e tyre e me nënën e shtetasit S.K., zj. Th. K....që prej fundit të vitit 2008, ata nuk kanë jetuar në atë banesë, pasi banesa ishte shitur tek shtetasit S. Sh. e M. Sh., ku sikurse do të sqarohet dhe më poshtë ndonëse kontrata e shitjes është formalizuar në vitin 2012, çmimi i shitjes ishte dërguar prej tyre që në vitin 2008, me transfertën bankare të datës 18.1.2008. Që në vitin 2009 dhe deri aktualisht, banesa është lëshuar me qira nga pronarët e saj S. Sh. e M. Sh. (motra e bashkëshortit tim e bashkëshorti i saj), tek shtetas të ndryshëm në periudha të caktuara kohore, pasi pronarët e saj jetojnë në Greqi”.*

Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dhe deklarimeve të saj dokumentacionin<sup>41</sup> e veprimeve juridike dhe tyre financiare të tjetërsimit të kësaj pasurie.

<sup>40</sup>Pyetësor nr. 3, përgjigjja nr. 1.

<sup>41</sup>Vërtetim nr. \*\*\* regj., datë 6.5.2021, i Rajonit Administrativ Nr. 1, Bashkia Korçë; dokumenti i emërtuar akt paraqitje e deklaratash nr. \*\*\*, datë 12.4.2021, e shtetasve S. Sh. e M. Sh., hartuar në Rodos, Greqi; deklaratë noteriale e shtetasit Dh.B., një prej qiramarrësve të kësaj banese, deklarate nr. \*\*\*, datë 5.5.2021; deklaratë noteriale e shtetasës F. V., një prej banoreve të këtij pallati, deklarate nr. \*\*\*, datë 5.5.2021; kartelë e pasurisë së paluajtshme në lidhje me pasurinë nr\*\*\*, z. k. \*\*\*; vendim nr. \*\*\*, datë 2.10.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; certifikatë për vërtetim pronësie në emër të shtetasve S.Sh. e M. Sh., për pasurinë nr\*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 6.12.2012, ndërmjet shitëses M. K. dhe blerësit S. Sh. .

**1.23.7** Për të ardhurat dhe transfertën e shumës 21,967 euro, e pyetur nga Komisioni, gjatë hetimit, subjekti shpjegon<sup>42</sup>: “Prindërit e bashkëshortit tim kanë kontribuar në vlerën 20,000 euro, që ka ardhur si pasojë e shitjes së apartamentit të tyre të mëparshëm. Kjo shumë është dërguar me transfertë bankare nga blerësi i pronës në shtetin Grek, në lidhje me transaksionin e kryer për vlerën 21,967 euro, transfertë bankare në favor të babait të bashkëshortit tim S. K., nëpërmjet Pro Credit Bank,...sqaroj se kjo shumë përfaqëson shumën e të hollave që është paguar nga shtetasit S. Sh. e M. Sh. për blerjen e apartamentit të banimit, të përshkruar më lart, ...të blerë që në vitin 2008, kohë kur është bërë dhe pagesa e çmimit të blerjes prej tyre, por kontrata e rregullt e shitjes me akt noterial është bërë më vonë, konkretisht në datën 6.12.2012 ... duke pasur marrëdhënie të ngushta prind-fëmijë. Të gjitha veprimet në lidhje me këtë pasuri janë bërë në kushtet e mirëbesimit të plotë që ka ekzistuar midis tyre. Në vitin 2008, ka qenë duke u ndërtuar shtëpia e banimit ku ne jetojmë aktualisht ...meqenëse nevojiteshin të holla për ndërtimin e shtëpisë, prej tyre është dërguar çmimi i blerjes më shpejt se lidhja e kontratës së shitjes në formën e duhur ligjore”.

**1.23.8** Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve aktparaqitjen e deklaratës nr. \*\*\*, datë 12.4.2021, të shtetasve S. Sh. dhe M.Sh., hartuar në Rodos, Greqi, të cilët kanë deklaruar lidhur me vlerën dhe qëllimin për të cilën është dërguar transferta e shumës 21,967 euro.

**1.23.9** Subjekti vijon me shpjegimet në lidhje me mënyrën e deklarimit në deklaratën Vetting dhe në pyetësorin nr. 2, për sa i përket shumës prej 21,967 euro dhe sqaron se: “...në deklaratën Vetting, jam shprehur se kjo shumë është dhuratë nga prindërit e bashkëshortit, nisur nga fakti se shtëpia ka qenë e regjistruar vetëm në emër të bashkëshortit tim dhe ai konsiderohej pronari ‘de jure’ i saj dhe si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie kam pasqyruar dhe këtë shumë të hollash. Prindërit e bashkëshortit tim nuk figurojnë juridikisht pronarë të saj. Por në deklaratën Vetting, pavarësisht se e kam konsideruar dhuratë për arsyen e mësipërme, gjithashtu, kam sqaruar dhe faktin se në të njëjtën banesë banojnë edhe prindërit e bashkëshortit tim, të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e saj...pasi gjendja juridike e faktike e pronës është e ndryshme”.

**1.23.10** Subjektit të rivlerësimit<sup>43</sup> për transfertën e shumës prej 21,967 euro iu kërkua nga Komisioni të provonte me dokumentacion ligjor dhe financiar veprimin bankar të kryer nga shtetasit M. dhe S. Sh., për të cilin, subjekti gjatë hetimit bashkëlidh dokumentacionin provues ligjor si vijon:

- a) dokument bankar, datë 10.6.2021, nga Banka Kombëtare e Greqisë me përfitues të llogarisë filiali i tërheqjes \*\*\*, Rodos, datë 9.6.2021, i emërtuar “gjendja e lëvizjes analitike se llogarisë depozitave \*\*\*”, në të cilin rezulton se në datën 22.1.2008 është debitua nga llogaria shuma 22,080.00 euro. Llogaria e cila është debituar nuk ka të dhëna se në emër të cili shtetas është;
- b) në këtë llogari konstatohet se në datën 11.1.2008 është kredituar llogaria me shumën 40,287.00 euro dhe është debituar në datën 11.1.2008, në shumën 20,000 euro dhe në datën 22.1.2008, shuma 22,080 euro;
- c) vërtetim, datë 9.6.2021, i “ProCredit Bank”, në të cilën vërtetohet se në llogarinë me nr. \*\*\*, në datën 25.1.2008, në emër të shtetasit S.K. është kredituar shuma 21,967 euro.

**1.23.11** Komisioni konstatoi se dokumentacioni në gjuhën greke i përkthyer i dërguar në mënyrë elektronike me e-mail nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit, nuk kishte vulë apostile në zbatim të kriterëve të VKM-së nr. 134, datë 7.3.2003, “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim Brenda vendit”, sipas pikës 4: “Dokumentet e autoriteteve

<sup>42</sup>Pyetësor nr. 3, përgjigjja 1.2.

<sup>43</sup>Pyetësor nr. 5 përgjigjja 2.1.

të huaja që do të përdoren brenda vendit legalizohen nga përfaqësitë Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.

**1.23.12** Lidhur me apostilimin e dokumentacionit provues, subjekti deklaroi<sup>44</sup> se: “...dokumentacioni i lëshuar nga Banka e Kombëtare e Greqisë vërtetoi transfertën e shumës nga shtetasit S. e M. Sh. në datën 22.1.2008 dhe duke qenë se është një dokument privat dhe jo publik nuk mund të legalizohen me vulë apostile sipas nenit 1 paragrafi 1 dhe 2 i Konventës së Hagës ‘Mbi heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja’. Pas interesimit që kam bërë në shtetin Grek gjatë periudhës kohore që iu kam kërkuar, jam vënë në dijeni se e vetmja mundësi për vendosjen e vulës apostille, pra për të mundësuar përdorimin në një tjetër shtet të dokumentit të lëshuar nga një bankë private e një shteti tjetër, është që personi që disponon llogarinë bankare të bëjë një deklaratë para një organi shtetëror grek, sikurse është Policia Greke se dokumenti i lëvizjes së llogarisë bankare, është sipas dokumenteve në origjinal që ai disponon e më pas mbi konfirmimin që bën organi shtetëror i shtetit të huaj vendoset vula Apostille...për këtë arsye, po paraqes një dokument të emërtuar ‘deklaratë me përgjegjësi’, për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, të hartuar nga shtetasi S.Sh., para Komisionit të Policisë Rodos, Policia Greke, Republika e Greqisë, datë 17.6.2021, në të cilën ai ka deklaruar se dokumentet e lëvizjes së llogarisë bankare të Bankës Kombëtare të Greqisë nr. \*\*\* (numri i llogarisë në emër të shtetasve S. e M. Sh. i pasqyruar dhe në dokumentin nr. 3, bashkëngjitur përgjigjeve shpesh të pyetësorit nr. 5), me përfitues të llogarisë bankare shtetasit S. Th. Sh. e M. S. Sh. janë sipas dokumenteve në origjinal që ai disponon”.

**1.23.13** Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa vijon:

- Nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor dhe financiar nëse transaksioni bankar i kalimit në vitin 2008, në vlerë 21,969 euro, në emër të shtetasit S. K., është kryer për qëllim të blerjes së apartamentit dhe nëse kjo shumë është dërguar nga shteti grek, si dhe është dërguar nga blerësit M. dhe S. Sh. .
- Ka mospërputhje të deklaramëve të saj për shumën 20,000 euro, ku në deklaramet periodik 2008 deklaroi se është dhurim nga prindërit e bashkëshortit, në deklaratën *Vetting* i deklaroi si burim i krijimit të pasurisë banese me tre kate dhe si të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit dhe gjatë procesit të rivlerësimit mban qëndrimin se janë kontribut për ndërtimin e banesës së përbashkët, në të cilën jetojnë dhe prindërit e bashkëshortit.
- Nuk bashkëlidh me deklaratën *Vetting* dokumentacion justifikues ligjor, aktin noterial të shitjes së apartamentit, por vetëm gjatë procesit të rivlerësimit e pyetur nga Komisioni shpjegon dhe bashkëlidh kontratën e shitjes së tij.
- Veprimi juridik i shitjes së pasurisë është kryer 4 vjet më vonë në vitin 2012 dhe jo në vitin 2008 që deklaroi subjekti në deklaratën *Vetting*.
- Vlera 21,967 euro e shitjes së apartamentit e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* nuk përputhet me vlerën 3,200,000 lekë, sipas kontratës së shitjes së apartamentit.

**Në parashtrimet e depozituara në Komision,** në funksion të barrës së provës subjekti ka pretenduar lidhur me dokumentacionin justifikues ligjor dhe financiar mbi transaksionin bankar të kalimit në vitin 2008, të shumës prej 21,967 euro dhe dha të njëjtat shpjegime dhe mbajti të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur gjatë hetimit, si dhe deklaroi se: “*Babai i bashkëshortit tim S. K., nuk ka pasur asnjë person tjetër dhe asnjë arsye tjetër që shuma e mësipërme e eurove mund të ishte transferuar në emër të tij nga jashtë shtetit. Në lidhje me konstatimin se në dokumentin ‘Gjendja e lëvizjes analitike të llogarisë së depozitave nr. \*\*\*’ nuk është pasqyruar emri i poseduesve të kësaj llogarie në dokumentin tjetër të lëshuar nga ‘Banka Kombëtare e Greqisë’,*

<sup>44</sup>Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 5, depozituar me e-mail në datën 21.6.2021, në Komision.

filiali Rodos, datë 10.6.2021, është pasqyruar se llogaria me nr. \*\*\* është llogari në emër të shtetasve S. Th. Sh. dhe M. S. Sh. . Subjekti i rivlerësimit i bashkëlidh parashtrimeve, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dokumentacionin provues ligjor të transfertës së kryer si vijon:

- Vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2021, të “ProCredit Bank”, së bashku me nxjerrje llogarie, nga ku vërtetohet se në llogarinë bankare të shtetasit S. K. është kredituar në datën 25.1.2008, shuma prej 21,967,00 euro, e cila ka qenë transfertë ndërkombëtare.
- Dokument bankar nga Banka Kombëtare e Greqisë, filiali \*\*\* i tërheqjes, Rodos, datë 9.6.2021, i emërtuar “gjendja e lëvizjeve analitike të llogarisë së depozitave nr. \*\*\*\*” si dhe shkresë e “Bankës Kombëtare të Greqisë”, filiali i tërheqjes \*\*\*, datë 10.6.2021.
- Deklaratë noteriale e shtetasës M. K., shitëses së pronës dhe e bashkëshortit të saj S.K. (personit në llogarinë bankare të të cilit është transferuar kjo shumë), të cilët, gjithashtu, vërtetojnë se shuma prej 21,967 euro e transferuar në llogarinë bankare të shtetasit S. K., ka qenë çmimi i shitjes së apartamentit të tyre të banimit – se kjo shumë është dërguar nga blerësi i pronës S. Sh. dhe bashkëshortja e tij M. Sh. – se çmimi i blerjes është dërguar më parë në kohë se formalizmi i kontratës, pasi nevojiteshin lekët për ndërtimin e shtëpisë dhe se palët kanë vepruar në kushtet e mirëbesimit të plotë midis tyre, nisur nga marrëdhëniet e ngushta familjare (deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 10.7.2021).

***Në lidhje me formën e kërkuar nga ligji të dokumenteve të huaja subjekti***, në parashtrime, pas dërgimit të rezultateve të hetimit deklaroi se: “*Dokumenti i emërtuar akt paraqitje e deklarates nr\*\*\*, datë 12.4.2021, e shtetasve S.Sh. dhe M.Sh., hartuar në Rodos, Greqi, është paraqitur në gjuhën greke, e përkthyer në shqip dhe me vulë apostile, pasi është një akt i përpiluar para një autoriteti publik, sikurse është noteri. Sa më sipër është në përputhje me parashikimin e Konventës së Hagës, Konventës ‘Mbi heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja’, miratuar në datën 5.10.1961”.*

***Lidhur me mospërputhjen e deklarimeve për shumën 20,000 euro***, ku në DIPP-në e vitit 2008 subjekti deklaroi se është dhurim nga prindërit e bashkëshortit në deklaratën *Vetting*, ku deklaroi si burim krijimi të pasurisë banesë me tri kate dhe si të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit dhe gjatë procesit të rivlerësimit mban qëndrimin se janë kontribut për ndërtimin e banesës së përbashkët, në të cilën jetojnë edhe prindërit e bashkëshortit, subjekti ka shpjeguar se: “*Prindërit e bashkëshortit tim kanë kontribuar me të ardhurat e tyre në ndërtimin e kësaj shtëpie dhe kjo si me të ardhurat që mund të kishin nga kursimet e tyre (të cilat janë trajtuar më sipër në lidhje me dy depozitat bankare në ‘Tirana Bank’ dhe në ‘Pro Credit Bank’), ashtu edhe në lidhje me të ardhurat e siguruara nga shitja e shtëpisë se tyre të mëparshme, apartament banimi i ndodhur në Korçë, lagjja \*\*\*, rruga: ‘\*\*\*’. Ashtu sikurse kam deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, kontributi i prindërve të bashkëshortit tim në ndërtimin e kësaj shtëpie ka qenë në vlerën 20,000 euro dhe, si rrjedhojë, e shitjes së apartamentit të tyre të mëparshëm të banimit dhe në vlerën 1,700,000 lekë, e cila ka qenë pjesë e dy depozitave bankare të trajtuara më lart në ‘Tirana Bank’ dhe në ‘ProCredit Bank’. Sa më sipër, rezulton dhe nga deklarata noteriale e prindërve të bashkëshortit tim S. K. e M. K., të cilën po ia bashkëngjit sqarimeve të mia. Në kushtet kur dhënia e shumës së mësipërme është bërë midis personave që kanë qenë në lidhje shumë të afërt familjare me njeri-tjetrin, prind-fëmijë, nuk është hartuar ndonjë dokument në kohën e dhënies së tyre. Nga deklarata e mësipërme e prindërve të bashkëshortit tim konfirmohet dhënia e tyre.*

*Shtëpia e banimit, e ndodhur në Korçë, lagjja \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, është blerë nga shtetasi S. Sh. dhe aktualisht figuron e regjistruar në ASHK Drejtoria Vendore Korçë në emër të tij dhe të bashkëshortes së tij M. Sh. . Për këtë blerje, prej tyre është dërguar edhe vlera e mësipërme prej 22,080 euro në llogarinë bankare të shtetasit S.K. . Fakti se ata janë pronarë aktuale dhe realë të kësaj prone rezulton nga dokumentacioni i regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRRP dhe kontratat e shërbimit me UKKO dhe me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nga*

të cilat rezultoi se kontratat e furnizimit me këto shërbime janë në emër të shtetasit S.Sh.<sup>45</sup>. Gjithashtu rezultoi se dërguesit e shumës së mësipërme prej 22,080 euro, shtetasit S. Sh. dhe M.Sh., pra blerësit e pronës, kanë pasur mundësi faktike për të blerë këtë pronë, pasi ata që prej shumë vitesh kanë jetuar në Greqi dhe kanë punuar aty në punë të rregullta dhe të siguruar.

**Lidhur me kryerjen e veprimit juridik të shitjes së pasurisë 4 vjet më vonë në vitin 2012** dhe jo në vitin 2008, siç ka deklaruar në deklaratën Vetting, subjekti shpjegon se: “Në lidhje me faktin se ekziston diferenca në kohë midis kohës së dërgimit të shumës së mësipërme të eurove nga blerësit e pronës janar 2008 e kohës së lidhjes e të formalizimit të kontratës së shitjes datë 6.12.2012, ashtu sikurse kam sqaruar më parë në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, shtëpia ka qenë e prindërve të shtetasës M. Sh., të quajtur S.K. dhe M.K. e duke pasur marrëdhënie të ngushta prind-fëmijë, të gjitha veprimet në lidhje me këtë pasuri janë bërë në kushtet e mirëbesimit të plotë që ka ekzistuar midis tyre. Në vitin 2008 ka qenë duke u ndërtuar shtëpia e banimit ku ne jetojmë aktualisht, e ndodhur në qytetin e Korçës, lagjja \*\*\*, rruga \*\*\*\* e meqenëse nevojiteshin të holla për ndërtimin e shtëpisë, prej tyre është dërguar çmimi i blerjes më shpejt se lidhja e kontratës së shitjes në formën e duhur ligjore. Kjo dërgesë është bërë në rrugë bankare dhe, konkretisht, në datën 18.1.2008, është bërë transfertë bankare në shumën 21,967 euro, në ‘ProCredit Bank’, në favor të shtetasit S. K. . Shtetasit S. dhe M. Sh. kanë jetuar dhe jetojnë në Greqi dhe, për këtë arsye, është bërë dërgesa e eurove nga Greqia. Në vijim, në datën 6.12.2012 është bërë kontrata e shitjes në formën e duhur, me akt noteriel. Data e dërgimit të kësaj shume të hollash, pra janar 2008 përkon edhe me kohën e ndërtimit të shtëpisë sonë të banimit, e cila është ndërtuar në vitet 2007-2008, ç’ka vërteton nevojën e dërgimit në atë kohë të kësaj shume, pra për t’u përdorur për ndërtimin e shtëpisë”.

**Në lidhje me mospërputhjen midis vlerës së transferuar nga blerësit e pronës** prej 22,080 euro e vlerës së pasqyruar si çmim shitje në kontratën e shitjes së apartamentit prej 3,200,000 lekë, subjekti shpjegoi se: “Rezulton se në kohën e përpilimit të kontratës, para noterit, është konkluduar që çmimi i blerjes të mos pasqyrohet në valutë të huaj, por në lekë, meqenëse ishte një veprim juridik që kryhej në Shqipëri. Vlera në lekë e pasqyruar si çmim shitje në kontratë është vlera e përafërt që i korrespondon shumës prej 22,080 euro, në vitin 2012 kur është formalizuar kontrata e shitjes, në referencë të kursit të këmbimit të euros me lekë. Në lidhje me faktin se kontrata e shitblerjes e lidhur midis shitëses M. K. dhe blerësit S.Sh. nuk është paraqitur bashkëngjitur deklaratës Vetting, por vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, sqaroi se sa më sipër ka qenë një pakujdesi nga ana ime, pasi kontrata e shitblerjes i përket datës 6.12.2012, pra ka qenë ekzistente në kohën e depozitimit të deklaratës Vetting, janar 2017”.

**Në lidhje me deklarimin e vlerës 20,000 euro në deklaratën e pasurisë Vetting** dhe të vlerës gjatë procesit të rivlerësimit 21,967 euro, subjekti sqaroi se: “Vlera që i kanë dhënë prindërit e bashkëshortit tim këtij të fundit ka qenë 20,000 euro, ndërsa vlera prej 21,967 euro është vlera që i është dërguar me transfertë bankare shtetasit S.K. nga blerësi i pronës S.Sh.”.

**1.23.14** Në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar pas kalimit të barrës së provës, subjekti depozitoi një provë të re në gjuhën greke, nga përmbajta e së cilës rezultoi se në datën 22.1.2008 nga llogaria me nr. IBAN \*\*\* është transferuar shuma 22,080 euro.

<sup>45</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 6.12.2012; certifikatë për vërtetimin e pronësie lëshuar nga ish-ZVRPP-ja Korçë në emër të shtetasve S. Sh. dhe M. Sh., për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë; vërtetim datë 5.7.2021, nga UK Korçë, nga rezultoi se shtetasi S. Sh. është klient i kësaj shoqërie me nr. klienti \*\*\*, me adresë: lagjja \*\*\*, rruga \*\*\*\*, objekti \*\*\*, hyrja \*\*\*, Korçë; 4- Nga shkresa dërgim informacioni e furnizuesit të Shërbimit Universal të OSHE Grup Drejtoria Rajonale Korçë nr. \*\*\* prot, datë 5.7.2021, nga rezultoi se kontrata me kod \*\*\*, i takon abonentit S. Sh., me adresë rr: \*\*\*\*, \*\*\*, Korçë. Dokumentet nr.1 dhe 2 i kam dërguar bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, ndërsa dokumentet nr. 3 dhe 4 po i dërgoj bashkëngjitur këtyre shpjegimeve.

**1.23.15** Subjekti, në seancë dëgjimore lidhur me burimin e krijimit të pasurisë shumë 20,000 euro, mbajti të njëjtin qëndrim me atë gjatë hetimit dhe paraqiti në origjinal provat e transfertës së shumë 21,967 euro dhe deklaroi se: “Në datën 22.1.2008, nga llogaria bankare e shtetasve S. Th. Sh. dhe M. S. Sh., llogari me nr. \*\*\*, e ndodhur në Bankën Kombëtare të Greqisë, filiali Rodos, është transferuar shuma prej 22,080,00 euro. Kjo shumë është pikërisht shuma që është kredituar në llogarinë e shtetasit S.K. me nr. \*\*\*, e ndodhur në ‘ProCredit Bank’. Nga shkresa e Bankës Kombëtare të Greqisë, filiali Rodos datë 10.6.2021, rezulton se llogaria me nr. \*\*\* është llogari në emër të shtetasve S. Th. Sh. dhe M. S. Sh., dokumentet e depozituara provojnë faktin se kjo dërgesë është bërë prej tyre”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues çmon se është provuar se një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt analize është shitja e apartamentit të shtetasve S. dhe M.Sh. për arsye se:

- Transferta bankare nga shteti grek nga llogaria bankare e z. S. Sh. në atë të personit tjetër të lidhur/babait të bashkëshortit të subjektit shtetasit S.K. rezulton e kredituar.
- Lidhur me pasaktësitë e konstatuara në DIPP-të dhe në deklaratën *Vetting* lidhur me kohën e shitjes së këtij apartamenti, trupi çmon se në kushtet e një marrëdhënieje të ngushtë familjare midis palës shitëse dhe blerëse dhe konflikteve të provuara gjyqësore midis bashkëpronarëve, këto pasaktësi nuk të çojnë në konkluzionin se ky burim nuk mund të konsiderohet i ligjshëm.
- Në administrim të të gjitha provave gjatë hetimit, pavarësisht deklarimeve të pasakta lidhur me datën e shitjes *de jure* të kësaj prone, kjo prone sot është në pronësi të shitësve, të cilët kanë bërë edhe transfertën bankare.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të pasaktë, pasi ka mospërputhje të deklarimeve të saj për shumën 20,000 euro, kontribut/dhurim, ku në DIPP-në e vitit 2008 deklaroi se është dhurim nga prindërit e bashkëshortit, në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim i krijimi të pasurisë banesë me tre kate dhe si të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të bashkëshortit dhe gjatë procesit të rivlerësimit mban qëndrimin se janë kontribut për ndërtimin e banesës së përbashkët, në të cilën jetojnë edhe prindërit e bashkëshortit.

**1.24 Gjatë hetimit, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të pasurisë truall me sip. 159 m<sup>2</sup> + banesë me sip. 100 m<sup>2</sup> edhe kredinë e marrë në “Credins Bank” në datën 6.6.2013, për të cilën deklaroi gjatë procesit të rivlerësimit se kanë shërbyer si burim për vendosjen e grilave të jashtme.**

**1.24.1** Nga shkresa e “Credins Bank”<sup>46</sup> konfirmohet marrja e kredisë në datën dhe në vlerën e deklaruar nga subjekti dhe tërheqja e fondeve është bërë *cash* nga bashkëshorti i subjektit.

**1.24.2** Komisioni ka konsideruar në analizën financiare edhe këtë burim të krijimit të pasurisë, e cila është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të grilave.

<sup>46</sup>Shkresa nr. \*\*\*, datë 17.12.2020, nga “Credins Bank”.

**1.24.3** Komisioni, në tabelën vijuese, ka kryer përmbledhjen e burimeve të krijimit dhe vlerave të konsideruara nga Komisioni në analizën e tij.

Burimet e krijimit	Vlera sipas burimeve të deklaruar nga subjekti në deklaratën Vetting	Vlera e investimit total e deklaruar	Vlera e konsideruar nga Komisioni (vlerat në lekë)
Hua e z. S. K.	1,500,000	14,900,000	-
Dy kreditë bankare në "Alpha Bank"	6,127,300		6,127,300
Dhurim nga shitja e apartamentit të prindërve të bashkëshortit	2,463,650		-
Depozitat në "Tirana Bank" dhe "ProCredit Bank"	2,197,576		2,197,576
Kursime të mëparshme	400,000		400,000
Kredia në "Credins Bank" e përdorur si burim për grilat e jashtme	500,000		500,000
<b>Rezultati</b>	<b>13,188,526</b>		<b>14,900,000</b>

**1.24.4** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi se ka pamjaftueshmëri financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ka pasur burime të ligjshme për të bërë investimin e deklaruar, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 5,675,124 lekë.

**1.24.5** Në parashtrimet e depozituara në Komision, pas lënies së barrës së provës, subjekti ka shpjeguar lidhur me diferencën midis vlerës së investimit të deklaruar për krijimin e pasurisë shtëpi banimi + truall, prej 14,900,000 lekësh dhe shumës totale të burimeve të deklaruar prej 13,188,526 lekësh: *"Përveç burimeve të deklaruar, burim tjetër i krijimit të pasurisë shtëpi banimi + truall kanë qenë të ardhurat tona përgjatë tri viteve të krijimit të kësaj pasurie. Vërtet shtëpia e banimit ka filluar që të ndërtohet në vitin 2007, por përgjatë vitit 2006 janë bërë shpenzime në zëra të tillë si prishja e shtëpisë ekzistuese, sigurimi, pra blerja e materialeve të ndërtimit fillestar etj. Të gjitha këto shpenzime janë bërë përgjatë fundvitit 2006 (fakt që del i provuar nga datat e miratimit të lejes së prishjes, lejes së miratimit të sheshndërtimit, leja e ndërtimit) dhe vlera e investimit prej 10,000,000 lekësh duhet të shtrihet edhe në këtë vit. Gjithashtu, në vitin 2007 ka filluar ndërtimi i shtëpisë dhe në vitin 2008 ka vazhduar ndërtimi i shtëpisë. Në qoftë se do t'i referohemi tabelës së analizës financiare përgjatë vitit 2006 ne kemi pasur mundësi të kursejmë 404,996 lekë, që duhet të llogariten si burim për të paguar shpenzimet për prishjen e shtëpisë ekzistuese, sigurimi i materialeve të ndërtimit fillestare etj. Edhe në vitin 2008 në qoftë se ju do ta konsideroni si burim të ligjshëm vlerën e dhuruar nga prindërit që rrjedh nga shitja e shtëpisë së vjetër (në lidhje me të cilën kam paraqitur bashkëngjitur këtyre shpjegimeve dhe vërtetimin nga Banka Kombëtare e Greqisë, që vërteton dërguesin dhe marrësin e shumës së të hollave), rezulton se përgjatë vitit 2008 ne kemi pasur mundësi të kursejmë 461,265 lekë, që duhet të llogariten edhe këto si burim i krijimit të pasurisë shtëpi banimi + truall"*.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit gjatë hetimit, në seancë dëgjimore, si dhe në konkluzionet e mësipërme për secilin prej burimeve të deklaruar të krijimit të kësaj pasurie, arrin në përfundimin se analiza financiare përmbledhëse mbi pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* truall+ ndërtesë është si vijon:

Burimet e krijimit	Vlera	Vlera e investimit total e deklaruar	Vlera e konsideruar nga Komisioni (vlerat në lekë)
Hua e z. S. K.	1 500 000	14 900 000	-
Dy kreditë bankare në “Alpha Bank”	6 127 300		6 127 300
Dhurim nga shitja e apartamentit të prindërve të bashkëshortit	2 463 650		2 463 650
Depozitat në “Tirana Bank” dhe “ProCredit Bank”	2 197 576		2 197 576
Kursime të mëparshme	400 000		400 000
Kredia në “Credins Bank” e përdorur si burim për grilat e jashtme	500 000		500 000
<b>Rezultati</b>	<b>13 188 526</b>		<b>14 900 000</b>

Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm duke rezultuar me mungesë të krijimit të burimeve financiare të ligjshme në shumën 3,211,474 lekë për blerjen, ndërtimin dhe investimet e kryera në këtë pasuri.

**2 Automjeti tip “Volkswagen” me nr. shasie \*\*\***, me targa \*\*\*, i blerë më 19.5.2010, me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, në vlerën 50,000 lekë. Është zhdoganuar nga në vlerën 216,551 lekë në datën 8.7.2010. Automjeti është edhe sot në përdorim. Vlera: 266,551 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti, të cilat janë siguruar nga kursimet nga paga si gjyqtar dhe prokuror të subjektit dhe bashkëshortit dhe nga vlera e siguruar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa \*\*\*, shitur më 7.7.2010.

**2.1** Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010: “Blerje automjeti me targa \*\*\* me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.5.2010, në vlerën 50,000 lekë”.

Komisioni konstatoi gjatë hetimit se subjekti ka pasaktësi të vlerës së deklaruar të automjetit në DIPP-në e vitit 2010 me deklaratën *Vetting*, pasi në deklaratën *Vetting* vlera e automjetit rezulton e deklaruar me gjithë vlerën e zhdoganimit.

**2.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*<sup>47</sup> dokumentacionin e përfitimit të këtij automjeti. Në analizë të dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *Vetting* rezultoi se subjekti e ka blerë automjetin me targa \*\*\*, viti i prodhimit 1999, nga shtetasi S. Sh. . Vlera e automjetit është 1,000 euro dhe eksportues është shtetasi S. Sh., shitësi i automjetit. Zhdoganimi i automjetit është bërë në datën 8.7.2010. Konstatohet se kontrata e shitjes është kryer më parë se automjeti të zhdoganohej. Vlera e zhdoganimit sipas faturës doganore është në total 216,551 lekë.

### Hetimi/ analiza ligjore dhe financiare e kryer nga Komisioni

**2.3 ILDKPKI-ja** në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin, përcjellë në Komision përgjigjen e DPSHTRR-së<sup>48</sup>, e cila konfirmon automjetin me targa \*\*\*. Bashkëlidhur leja e qarkullimit dhe kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.5.2010, ku subjekti ble nga shtetasi S.Sh., automjetin me targa \*\*\*, vit prodhimi 1999, në vlerën 50,000 lekë.

**2.4 AMF-ja**<sup>49</sup>, me shkresë informon se për automjetin tip “Wolkswagen”, me targa \*\*\*, është prerë siguracion deri më 19.12.2019. Nga hetimi i Komisionit në faqen zyrtare të AMF-së

<sup>47</sup>Shihni aneksin nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë nr. \*\*\*, datë 19.5.2010, ku znj. Ariola Kristo ble nga shtetasi S.Sh. automjetin me targa \*\*\*, vit prodhimi 1999, në vlerën 50,000 lekë. Deklaratë zhdoganimi në vlerën 216,551 lekë, datë 8.7.2010. Vlera e automjetit është 1,000 euro dhe eksportues është shtetasi S.Sh., shitësi i automjetit. Vula e doganës së Kapshticës, me shënimin “u zhdoganua pa u kryer kontrollin”.

<sup>48</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2017 dhe datë 7.8.2017.

<sup>49</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020.



rezulton se polica e sigurimit është prerë deri më 31.1.2021 dhe subjekti rezulton edhe përdorues edhe pronar i automjetit.

**2.5** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit dhe iu drejtua Gjykatës<sup>50</sup> së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila përcjell informacionin se pranë kësaj gjykate, nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë gjykuar çështje civile me palë shtetasin S. Sh. .

**2.6** Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit me targa \*\*\*.

**2.7** Në DIPP-në e vitit 2010 subjekti deklaroi se është shtuar pasuria nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, sipas kontratës nr\*\*\*, datë 7.7.2010, në vlerën 700,000 lekë. Subjekti bashkëlidh me deklaratën e pasurisë *Vetting*<sup>51</sup> kontratën e shitjes së automjetit.

**2.8** Duke qenë se data e shitjes së automjetit me targa \*\*\*është e mëvonshme (datë 7.7.2010) nga data e blerjes së automjetit me targa \*\*\* (datë 19.5.2010), atëherë Komisioni nuk konsiderohet si burim i krijimit të automjetit të fundit.

**2.9** Në lidhje me kursimet nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit Komisioni hartoi analizën në tabelën e mëposhtme, e cila i referohet të ardhurave për periudhën 1.1.2010 – 19.5.2010.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2010 - 19.5.2010 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	300 887
Të ardhura nga paga e z. J.K.	304 350
Pakësim likuiditetesh në bankë	- 21 534
Shpenzime jetike për 3 persona	136 620
Shpenzime udhëtimi	99 777
<b>Rezultati financiar</b>	<b>347 306</b>

Referuar analizës financiare sa më sipër rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë vlerën 347,306 lekë nga të ardhurat prej pagës së vitit 2010. Ndërsa në tabelën vijuese janë përmbledhur burimet e krijimit të pasurisë.

<i>Burimet e krijimit</i>	<i>Vlera</i>	<i>Vlera e automjetit me targa *** (në lekë)</i>
Kursimet nga pagat e vitit 2010	347 306	216,551 lekë zhdoganimi + 50,000 lekë vlera e blerjes
Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***	0	
<b>Totali</b>	<b>347, 306</b>	<b>266, 551</b>

**2.10** Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasaktësi të konstatuar nga Komisioni, sqaroi se: “*Lidhur me automjetin me targa\*\*\*, tip ‘Volkswagen’ për shkak të një pakujdesie në DIPP-në e vitit 2010, është deklaruar vetëm vlera e blerjes së automjetit dhe jo dhe vlera e zhdoganimit të tij, i cili është bërë gjithashtu në vitin 2010. Më pas, në deklaratën Vetting është pasqyruar çmimi i shitjes së bashku me vlerën e zhdoganimit, shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës shoqëruar. Kontrata e shitjes është realizuar më parë se automjeti të zhdoganohej, pasi zhdoganimi është bërë nga ne dhe jo nga shitësi i pronës. Unë kam deklaruar se burim i blerjes së këtij automjeti kanë qenë kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortit dhe të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, në emër të bashkëshortit tim, sipas kontratës së shitjes të datës 7.7.2010. Në lidhje me konstatimin se data e blerjes së automjetit me targa \*\*\*, datë 19.5.2010, ka qenë më e hershme se data e shitjes së automjetit me targa*

<sup>50</sup>Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 22.4.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

<sup>51</sup>Aneks 4/11 dosja e ILDKPKI-së.

\*\*\*, datë 7.7.2010 dhe, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet si burim i krijimit të këtij automjeti, sqaroj se vlera e automjetit me targa \*\*\*, përbëhet nga çmimi i blerjes 50,000 lekë e vlera e zhdoganimit 216,551 lekë, në total 266,551 lekë. Në datën e lidhjes së kontratës datë 19.5.2010 është paguar vetëm çmimi i blerjes, pra 50,000 lekë, ndërkohe që vlera e zhdoganimit prej 216,551 lekësh, e cila zë pjesën kryesore në vlerën e këtij automjeti është paguar në datën e zhdoganimit 8.7.2010, e cila është pas datës së shitjes së automjetit me targa \*\*\*, datë 7.7.2010”.

**2.11** Në përfundim të analizës financiare rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të investuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme, të krijuara nga kursimet e pagave të tyre, të vitit 2017.

### **3 Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\***

**3.21** Subjekti, në pyetësorin standard, ka deklaruar për këtë pasuri se: “Në kohën e blerjes automjeti kishte targën \*\*\* dhe pastaj kur është kaluar në emrin e bashkëshortit tim është ndryshuar targa në \*\*\*. Këtë automjet e kemi blerë në datën 9.10.2013 me kontratë shitjeje nr\*\*\*, në vlerën 400,000 lekë. Automjeti është edhe sot në përdorim në vlerë 400,000 lekë. Pjesa takuese 50%, me burim të krijimit të ardhurat për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti janë siguruar nga kursimet tona nga paga si gjyqtar dhe prokuror, unë dhe bashkëshorti im”.

#### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**3.4** Subjekti, në DIPP-në e vitit 2013, ka deklaruar: “Blerjen e një automjeti me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.10.2013, në vlerën 400,000 lekë”.

**3.5** Subjekti i bashkëlidh deklaratës së pasurisë *Vetting*, kontratën nr. \*\*\*, datë 9.10.2013, ku shtetasi J. K. ble automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në vlerën 400,000 lekë nga shtetasi E.K. .

**3.6** Subjekti, lidhur me këtë automjet, gjatë procesit të rivlerësimit ka shpjeguar se: “Blerja e një automjeti tip ‘Mercedes-Benz’ me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*. Këtë automjet e ka blerë bashkëshorti im në datën 9.10.2013 me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, me vlerë 400,000 lekë. Pagesa është bërë cash. Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga shitja e automjetit të parë, nga kursimet tona, si dhe nga paga si gjyqtare dhe prokuror, unë dhe bashkëshorti im”.

**3.1** Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR<sup>52</sup>-në konfirmohet dokumentacioni për automjetin me targa \*\*\*. Bashkëlidhur është leja e qarkullimit dhe kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 9.10.2013, ku shtetasi J. K. ble automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në vlerën 400,000 lekë. Bashkëshorti i subjekti me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.7.2017, i shet automjetin shtetasit P.P., në vlerën 500,000 lekë.

**3.2** Komisioni konstatoi gjatë hetimit se subjekti ka mospërputhje të deklaramit të burimit të krijimit të këtij automjeti në deklaratën *Vetting*, në të cilën deklaroi kursime nga pagat e përbashkëta, me qëndrimin e mbajtur gjatë procesit të rivlerësimit, ku si burim krijimi referon edhe shitjen e automjetit të parë<sup>53</sup>.

**3.3** Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti, në parashtrimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi se: “Në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti me targa \*\*\*, tip ‘Mercedes-Benz’, blerë nga bashkëshorti im me kontratë shitblerjeje në datën 9.10.2013, në vlerën 400,000 lekë sqaroj se burim i tij kanë qenë si kursimet nga pagat e përbashkëta të miat dhe të bashkëshortit tim, ashtu edhe të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, shitur me kontratë shitblerje të datës 7.7.2010, në vlerën 700,000 lekë. Pasaktësia

<sup>52</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>53</sup>Automjeti të cilën subjekti deklaroi se është automjeti i shitur më 7.7.2010, në vlerën 700,000 lekë, me targa \*\*\*.

*në deklarinim në lidhje me burimin e krijimit është një gabim dhe pakujdesi nga ana jonë. Në lidhje me të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm është e vërtetë se nga ana jonë nuk janë deklaruar gjendje cash në vlera monetare. Sa më sipër ka qenë një gabim i bërë në plotësimin e deklaratave të pasurisë, të cilat sikurse kam deklaruar nuk janë hartuar në mënyrë shumë të kujdesshme nga ana jonë. Ashtu sikurse rezulton nga raporti i rivlerësimit, nga ana juaj nuk është pranuar si vlerë, pra si burim i blerjes së këtij automjeti vlera e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm, meqenëse nuk janë deklaruar më parë kursime cash”.*

### **Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë**

**3.1** Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* se për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer pagat si gjyqtar dhe prokuror dhe në shpjegime gjatë hetimit shpjegoi se ka shërbyer edhe shitja e automjetit të parë.

**3.2** Gjatë hetimit të Komisionit u konstatua se shitja e automjetit të parë (me targa \*\*\*) të deklaruar si burim gjatë hetimit nga subjekti është shitur në datën 7.7.2010 dhe subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të mbajtur gjatë kësaj periudhe kohore. Për këtë arsye nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni shitja e automjetit me targa \*\*\* gjatë analizës financiare si burim krijimi.

**3.3** Komisioni hartoi analizën financiare në tabelën e mëposhtme duke u mbështetur në deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*, pra ka analizuar mundësinë e subjektit për të blerë automjetin me të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit deri në datën e blerjes.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2013 - 9.10.2013 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	643 718
Të ardhura nga paga e z. J.K.	768 404
Të ardhura nga interesat bankare	11 306
Shtim likuiditetesh në bankë	100 217
Kredia e marrë në “Credins Bank”	389 504
Blerja e automjetit me targa ***	400 000
Pagesa për kreditë në “Alpha bank” dhe “Credins Bank”	162 511
Shpenzime për grilat e banesës	500 000
Shpenzime jetike për 4 persona	423 072
Shpenzime udhëtimi	550 394
Rezultati financiar	- 323 262

**3.4** Gjatë hetimit, Komisioni, pas kryerjes së analizës financiare konstatoi se subjekti rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijojë më të ardhura të ligjshme pasurinë e mësipërme, duke rezultuar me pamjaftueshmëri të ardhurash në vlerën 323,262 lekë për periudhën 1.1.2013 - 9.10.2013.

**3.5** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*.

**3.6** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti, në funksion të barrës së provës shpjegoi se: *“Në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti, sqaroj se burim i tij kanë qenë si kursimet nga pagat e përbashkëta të miat dhe të bashkëshortit tim, ashtu edhe të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, shitur me kontratë shitblerje të datës 7.7.2010, në vlerën 700,000 lekë. Pasaktësia në deklarinim në lidhje me burimin e krijimit është një gabim dhe pakujdesi nga ana jonë. Në lidhje me të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm, është e vërtetë se nga ana jonë nuk janë deklaruar gjendje cash në vlera monetare. Sa më sipër ka qenë një gabim i bërë në plotësimin e deklaratave të pasurisë, të cilat sikurse kam*

deklaruar nuk janë hartuar në mënyrë shumë të kujdesshme nga ana jonë. Ashtu sikurse rezulton nga raporti i rivlerësimit, nga ana juaj nuk është pranuar si vlerë, pra si burim i blerjes së këtij automjeti vlera e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm, meqenëse nuk janë deklaruar më parë kursime cash”.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “Pavarësisht sa më sipër, nga analiza financiare e vitit 2013, konstatohet se kredia e marrë në ‘Credins Bank’ ka qenë në vlerën 500,000 lekë, sipas kontratës së kredisë datë 6.6.2013, ndërkohë që në tabelën financiare përkatëse vlera e kredisë është pasqyruar 389,504 lekë, pra më pak se vlera e kredisë e marrë realisht. Kredia ka qenë me afat 24-mujor dhe me interes të përcaktuar në kontratë e pjesa e interesave dhe e kësteve të kredisë të shlyera gjatë vitit 2013, pra në periudhën korrik-dhjetor 2013 është llogaritur në këtë tabelë financiare në rubrikën ‘Pagesa për kredi në ‘Alpha Bank’ dhe në ‘Credins Bank’ në vlerë totale 162,511 lekë. Në analizën financiare të pasqyruar në faqen 26 të raportit në lidhje me këtë automjet, në rubrikën ‘Të ardhura nga paga e Ariola Kristo’, ku janë pasqyruar të ardhurat nga paga ime për periudhën: 1.1.2013 - 9.10.2013, pra për 9 muaj pagë, rezulton se paga në total është llogaritur 643,718 lekë. Nga mbledhja e pagës time për periudhën e mësipërme, sipas vërtetimit të pagës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasqyruar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016, bashkëngjitur deklaratës Vetting, por që po e bashkëngjiti dhe këtyre sqarimeve, rezulton se paga ime ka qenë 702,005 lekë, pra më tepër sesa është llogaritur. Po kështu, të nderuar pretendoj se në të ardhurat që unë kam marrë nga paga në vitin 2013, duhet të llogaritet edhe paga e muajit dhjetor 2012, për arsye se paga e këtij muaji merret në janar të vitit 2013. Kjo pagë ka qenë 73,339 lekë (vërtetimi i pagës i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasqyruar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016). Në rast se pagës time të periudhës janar-shtator 2013, prej 702,005 lekë i shtohet paga e dhjetorit 2012, e marrë faktikisht në janar 2013, rezulton që të ardhurat nga paga ime janë: 775,344 lekë. Me të njëjtin arsyetim si më sipër, pretendoj se në të ardhurat nga paga të bashkëshortit tim J.K., duhet të llogaritet edhe paga e tij e muajit dhjetor 2012, për arsye se paga e këtij muaji merret në janar të vitit 2013. Kjo pagë ka qenë 98,296 lekë (vërtetimi i pagës i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bashkëngjitur deklaratës Vetting, por që po e dërgoj edhe bashkëngjitur këtyre sqarimeve). Në rast se pagës së bashkëshortit tim të periudhës janar-shtator 2013, prej 768,404 lekësh i shtohet paga e dhjetorit 2012, e marrë faktikisht në janar 2013, rezulton që të ardhurat nga paga e tij janë: 866,700 lekë. Nëse bëhen përlllogaritjet sipas kësaj tabele financiare, por duke llogaritur vlerën e kredisë së marrë në ‘Credins Bank’, pra ashtu sikurse është pasqyruar në kontratë 500,000 lekë; të ardhurat nga paga ime në vlerën 775,344 lekë e të ardhurat nga paga e bashkëshortit tim në vlerën 866,700 lekë, rezulton se diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve është 417,156 lekë, pra del që të kemi qenë në mundësi financiare për të blerë automjetin në vlerën 400,000 lekë”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, të dhëna pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk rezultuan të mjaftueshme për të provuar mundësinë financiare të saj për blerjen e automjetit. Komisioni, në analizën financiare, ka përfshirë vlerën e kredisë, e cila është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit në “Credins Bank”, vlerë e cila është më e vogël se vlera e aprovuar nga kjo bankë, prej 500,000 lekësh, pas zbritjeve të aplikuar nga banka si komisione disbursimi, etj. Gjithashtu, Komisioni ka llogaritur si të ardhura nga paga e subjektit shumat e transferuara në bankë deri në momentin e blerjes së automjetit, nga ku ka rezultuar se paga e dhjetorit të vitit 2012 është transferuar në janar të vitit 2013 dhe, si e tillë, është konsideruar në analizën e automjetit edhe paga e muajit shtator të vitit 2013, e cila nuk rezulton të ketë kaluar deri më 9.10.2013, kur është blerë automjeti. Për pasojë, rezultati i analizës financiare për automjetin është pamjaftueshëm për krijimin e pasurisë nga burime të ligjshme në vlerën 323,262 lekë.

#### **4. Pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të cilat i ka pasur dhe i ka shitur**

**4.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip ‘BMW’ me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*. Këtë automjet e kemi blerë në datën 23.5.2002 me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, në vlerën 150,000 lekë. Është zhdoganuar në vlerën 161,850 lekë, datë 24.5.2002. Automjeti është shitur në datën 11.10.2005 me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, në vlerën 150,000 lekë. Në kohën e shitjes, automjeti është shitur e dëmtuar dhe në atë kohë kemi marrë dëmshpërblim nga siguracioni në vlerën e përafërt 100,000 lekë, fakt që nuk e dokumentojmë dot*”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat për blerjen e këtij automjeti, të cilat janë siguruar pjesërisht dhuratë nga prindërit dhe pjesërisht nga kursimet që merrnin si studentë subjekti dhe bashkëshorti në Shkollën e Magjistraturës. Vlera e shitjes së këtij automjeti është shtuar në kursimet e tyre.

#### **Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**4.2** Subjekti ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2003, në të cilën ka deklaruar: “*Vetura BMW vlera 400,000 lekë, nr. \*\*\*, datë regj. 24.5.2002. Automjeti regjistruar në emër të bashkëshortit tim J. K., burimi të ardhurat e tij nga kursimet, në bazë të kontratës së shitblerjes përpara noterit V.M.*”. Bashkëshorti deklaroi në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2003: “*Automjet, vlera 400,000 lekë, pjesa takuese 50%, \*\*\*, burimi kontratë shitblerjeje, kursimet familjare*”.

**4.3** Ndërsa në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2005 subjekti ka deklaruar: “*Pakësim pasurie, pra kam shitur automjetin tip 524 BMW, me targa \*\*\*. Shitur në shkurt të vitit 2005, pas ndodhjes së aksidentit automobilistik në vlerën 150,000 lekë, që u përfitua nga siguracioni ‘A.’ dhe 250,000 lekë nga shitja*”.

**4.4** Bashkëshorti i subjektit në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar se është pakësuar në shkurt të vitit 2005 automjeti tip “BMW” me targa \*\*\*, pa përshkruar veprimin juridik dhe vlerën.

**4.5** Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* dokumentacionin ligjor-financiar të tjetërsimit dhe transaksionet e kryera për këtë pasuri<sup>54</sup>.

**4.6** Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni në pyetësorin standard<sup>55</sup>, sqaron lidhur me burimin e krijimit të këtij automjeti: “*Prindërit e bashkëshortit tim S. dhe M. K. kanë ndihmuar për të blerë automjetin e parë, në kohën që bashkëshorti im ka qenë në vitin e stazhit profesional (automjeti me targa \*\*\*, me vlerë 150,000 lekë+161,850 zhdoganimi). Në lidhje me shumën e dhuruar nga prindërit, ajo është 150,000 lekë, pasi ata blenë automjetin dhe bashkëshorti im bëri zhdoganimin. Burimi i kësaj shume është nga të ardhurat e tyre nga kursimet nga paga e tyre si mësues dhe arsyeja ishte të ndihmonin bashkëshortin tim (djalin e tyre) me një mjet udhëtimi, pasi vendi i tij i punës (në Elbasan) ishte i ndryshëm dhe i largët nga vendi i banimit (në Tiranë). Në lidhje me sa më sipër, sqaroj se i përket një periudhe kohore para fillimit të detyrës sime si gjyqtare, por po e pasqyroj meqenëse lidhet me dhurime të bëra bashkëshortit tim. Unë e kam filluar stazhin profesional në tetor të vitit 2002 dhe punën si gjyqtare në nëntor të vitit 2003 dhe koha e dhurimit të mësipërm daton më parë. Automjeti është blerë me kontratën noteriale në datën 23.5.2002 dhe është zhdoganuar në datën 24.5.2002*”.

**4.7** Sa më sipër, nga hetimi Komisioni rezultoi se subjekti:

<sup>54</sup>Aneks 4/9 dosja ILDKPKI.

<sup>55</sup>Përgjigjja nr. 4, pyetësori standard. Kontratë nr. \*\*\*, datë 23.5.2002, ku z. J.K. ble automjetin tip “BMW”, në vlerën 150,000 lekë nga shtetasi R. K. Th.. Deklaratë zhdoganimi me importues shtetasin R. Th. në datën 24.5.2002, vendin e origjinës Gjermani dhe vlerë të automjetit në momentin e hyrjes prej 1,550 euro. Përcillet edhe vërtetimi i zhdoganimit me vlerë 161,850 lekë. Kontratë nr. \*\*\*, datë 11.1.2005, ku shtetasi J. K. shet automjetin tip “BMW”, në vlerën 250,000 lekë.

- a) Ka pasaktësi në deklaram në lidhje me vlerën e blerjes së automjetit, të cilin e deklaroi në vlerën 400,000 lekë në DIPP-në e vitit 2003 dhe, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarohet vlera 311,850 lekë.
- b) Ka mospërputhje të deklaramit të vlerës së shitjes në DIPP-në e vitit 2005, në të cilën deklaroi vlerë shitjeje të automjetit 250,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitjes deklarohet vlera 150,00 lekë.

**4.8** Lidhur me këtë pasaktësi të konstatuar nga Komisioni, pas dërgimit të parashtrimeve rreth rezultateve të hetimit, subjekti, lidhur me automjetin me targa \*\*\*, tip “BMW”, blerë nga bashkëshorti i subjektit në datën 23.5.2002, shpjegoi se: *“Në lidhje me këtë automjet, nga ana juaj në raportin e rivlerësimit është pasqyruar se bashkëshorti im ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojë këtë pasuri. Nga ana tjetër rezultoi se janë konstatuar pasaktësi në lidhje me vlerën e blerjes dhe të shitjes së tij, të pasqyruara në deklaratat periodike vjetore, respektivisht, DIPP-të e viteve 2003 dhe 2005 me ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*. Pranoj se sa më sipër ka qenë një pakujdesi në plotësimin e deklaratave, ku ato janë plotësuar pa u bazuar në dokumentacionin real ekzistues, pra në kontratat përkatëse të blerjes e të shitjes së automjetit, por në një vlerë të përafërt të tyre. Kjo ka ardhur edhe për shkak të faktit se kanë qenë vitet e para të deklaramit e në mënyrë të gabuar nuk është treguar kujdesi i duhur në plotësimin e tyre”*.

**4.9** Mbështetur në deklaramet e mësipërme të subjektit dhe bashkëshortit të saj, u hartua analiza financiare në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë deri në momentin e blerjes së automjetit sipas tabelës vijuese.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2002 - 23.5.2002 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e z. J.K.	205 424
Të ardhura nga paga e znj. M.K.	209 348
Të ardhura nga paga e z. S. K.	196 971
Blerja e automjetit	311 850
Shpenzime jetike të llogaritura për 4 persona	156 440
Shpenzime udhëtimi	75 846
Rezultati financiar	67 607

**4.10** Referuar analizës financiare sa më sipër rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme pasurinë e mësipërme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**4.11** Trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara lidhur me këtë pasuri do të vlerësohen në dhënien e vendimit përfundimtar.

### **5. Automjet tip “BMW”, me targa \*\*\***

Ky automjet është blerë në datën 7.2.2005, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, me vlerë 200,000 lekë, me nr. shasie \*\*\*, Është zhdoganuar në vlerën 180,000 lekë, por në DPSHTRR-në Korçë nuk ndodhet dosja e këtij automjeti për të përcaktuar vlerën e saktë të zhdoganimit. Automjeti është shitur në datën 5.6.2006 me kontratën e shitblerjes nr\*\*\*, në vlerën 400,000 lekë.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga kursimet që merrnin nga paga si gjyqtar dhe prokuror së bashku me bashkëshortin.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**5.1** Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005: *“Automjet tip ‘BMW’, me targa \*\*\*, shtim pasurie, mars 2005. Vlera 470,000 lekë”*.

**5.2** Në DIPP-në e vitit 2006 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Është pakësuar në datën 5.4.2006 automjet tip ‘BMW’ me targa \*\*\*, kontratë nr. 455/216, datë 5.4.2006, në vlerën 400,000 lekë”.

**5.3** Subjekti i bashkëlidh deklarates *Vetting*<sup>56</sup> dokumentacionin tekniko-ligjor dhe atë të veprimeve financiare për blerjen, regjistrimin dhe shitjen e automjetit<sup>57</sup>.

**5.4** Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit, në pyetësorin standard subjekti shpjegoi: “Blerja dhe zhdoganimi i një automjeti tip ‘BMW’, me targa \*\*\*. Ky automjet është blerë në datën 7.2.2005 nga bashkëshorti im J. K. me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, me vlerë 200,000 lekë dhe po rreth kësaj date është zhdoganuar vlera rreth 180,000 lekë. Vlera totale e këtij automjeti është 380,000 lekë. Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga kursimet tona që merrnim nga paga si gjyqtar e prokuror, unë dhe bashkëshorti im. Pagesa është bërë cash”.

**5.5** Subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2004 dhe, për këtë arsye, janë konsideruar në analizën financiare të burimit të krijimit të pasurisë, në të cilën janë pasqyruar vetëm të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëshortit deri në momentin e blerjes së automjetit.

<i>Analiza financiare</i>	<i>7.2.2005 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	6 493
Të ardhura nga paga e z. J. K.	67 142
Të ardhura nga interesat bankare	21 292
Pakësim likuiditetesh në bankë	- 904 336
Blerja e automjetit	380 000
Shpenzime qiraje	10 000
Shpenzime jetike të llogaritur për 3 persona	27 389
Shpenzime udhëtimi	0
Rezultati financiar	581 873

Sa më sipër është kryer analiza financiare, nga e cila rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme pasurinë e lartpërmendur.

## **6. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\***

**7.** Ky automjet është blerë në datën 20.3.2006, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, me vlerë 500,000 lekë, nr. shasie \*\*\*. Automjeti është zhdoganuar nga shitësi P. J. për llogarinë e bashkëshortëve Kristo në vlerën 205,970 lekë, në datën 19.3.2006 dhe është shitur në datën 7.7.2010 me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, në vlerën 700,000 lekë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit janë të ardhurat e siguruar pjesërisht nga shitja e automjetit të parë (pavarësisht veprimit juridik të dokumentuar më vonë) dhe pjesërisht nga kursimet që merrnim nga paga si gjyqtar dhe prokuror. Vlera e shitjes së këtij automjeti është shtuar në kursimet e tyre.

## **Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**6.1** Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar: “Shtuar automjet tip ‘Mercedes-Benz C180’ me nr. shasie \*\*\*, ngjyrë gri me benzinë. Blerë më 23.3.2006, vlera 450,000 lekë.” Ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 subjekti deklaroi: “Shtim i pasurisë në vlerën 700,000 lekë nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 7.7.2010”.

<sup>56</sup>Shihni Aneksin 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>57</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 7.2.2005, ku shtetasi J. K. ble automjetin tip “BMW” në vlerën 200,000 lekë nga shtetasi E. K.; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.4.2006, ku shtetasi J. K. shet automjetin tip “BMW”, në vlerën 400,000 lekë shtetasit O. Xh. .

Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin<sup>58</sup> e shitblerjes<sup>59</sup> së automjetit.

**6.2** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë subjekti ka shpjeguar se:<sup>60</sup> *“Blerjen dhe zhdoganimin e një automjeti të llojit veturë, tip ‘Mercedes-Benz’ me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*. Këtë automjet e ka blerë bashkëshorti im J. K. në datën 20.3.2006, me kontratën e shitjes nr\*\*\*, me vlerë 500,000 lekë. Është zhdoganuar nga shitësi (P. J.) për llogarinë e bashkëshortit tim në vlerën 205,970 lekë, në datën 19.3.2006. Vlera totale e këtij automjeti është 705,970 lekë. Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga kursimet tona që merrnim nga paga si gjyqtare e prokuror, unë dhe bashkëshorti im, si dhe nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, që është shitur faktikisht para se të formalizohej me kontratë. Pagesa është bërë cash në të dyja veprimet”.*

**6.3** Komisioni hartoi analizën financiare të burimit të krijimit të pasurisë, e cila është pasqyruar në tabelën vijuese, duke konsideruar të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëshortit deri në momentin e blerjes së automjetit dhe të ardhurat e periudhës. Nuk janë konsideruar në analizë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “BMW” me targa \*\*\*, në vlerën 400,000 lekë, duke qenë se data e kontratës së shitjes është 5.4.2006, pra është nënshkruar rreth 16 ditë nga blerja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2006 - 20.3.2006 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	197 671
Të ardhura nga paga e z. J.K.	225 517
Pakësim likuiditetesh në bankë	28 154
Blerja e automjetit	705 970
Shpenzime jetike të llogaritur për 3 persona	82 168
Shpenzime qiraje	30 000
Shpenzime udhëtimi	4 330
Rezultati financiar	- 427 434

**6.4** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me pamundësinë financiare për të mbuluar shpenzimet për krijimin e pasurisë së mësipërme me të ardhura të ligjshme në vlerën 427,434 lekë.

**6.5** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, blerë nga bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitjes së datës 20.3.2006, në vlerën 500,000 lekë, zhdoganuar në datën 19.3.2006, në vlerën 205,970 lekë, vlera totale 705,970 lekë, subjekti ka deklaruar: *“Si burim i blerjes së këtij automjeti janë pasqyruar të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, e tipit ‘BMW’, shitur me kontratën e datës 5.4.2006 nga bashkëshorti im J.K. te shtetasi O.Xh., në vlerën 400,000 lekë e pjesërisht nga kursimet tona nga puna ime dhe e bashkëshortit si gjyqtar e prokuror. Në raportin e rivlerësimit rezulton që të mos jenë marrë parasysh në analizën financiare të vitit 2016 të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, për faktin se kontrata e shitjes së këtij automjeti që i përket datës 5.4.2006 daton më vonë, rreth 16 ditë më vonë nga data e blerjes së automjetit të ri, më 20.3.2006 dhe pas analizës financiare të vitit 2016 deri në datën e blerjes së këtij automjeti ka rezultuar pamundësi financiare në një vlerë prej 427,434 lekësh. Në lidhje me këtë konstatim, sqaroj se pavarësisht se kontrata e shitjes me*

<sup>58</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 20.3.2006, ku shtetasi J. K. blen automjetin tip “Mercedes-Benz” në vlerën 500,000 lekë; deklaratë zhdoganimi datë 19.3.2006, në vlerën 205.970 lekë; kontratë nr. \*\*\*, datë 7.7.2010, ku shtetasi J. K. shet automjetin tip “Mercedes-Benz” në vlerën 700,000 lekë shtetasit N. M. . Aneks 4/11, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>59</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 20.3.2006, ku shtetasi J.K. ble automjetin tip “Mercedes-Benz” në vlerën 500,000 lekë; deklaratë zhdoganimi datë 19.3.2006, në vlerën 205.970 lekë; kontratë nr. \*\*\*, datë 7.7.2010, ku shtetasi J.K. shet automjetin tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 700,000 lekë shtetasit N. M. .

<sup>60</sup>Pyetësori standard.



blerësin e automjetit me targa \*\*\*, z. O.Xh. është formalizuar në datën 5.4.2006, automjeti është marrë në përdorim prej tij më parë dhe lekët e blerjes së këtij automjeti i janë paguar bashkëshortit tim prej tij më parë. Pra, blerësi i automjetit O.Xh. ka paguar çmimin e blerjes së automjetit prej 400,000 lekësh që në shkurt - mars të vitit 2006, ka marrë edhe automjetin në përdorim që në atë kohë e më pas kontrata e shitjes është formalizuar më vonë, nisur edhe nga marrëdhëniet shoqërore që kanë ekzistuar midis bashkëshortit tim dhe shtetasit O.Xh. ”.

**6.6** Komisioni çmon se pas vlerësimit të shpjegimeve të dhëna pas kalimit të barrës së provës se për shkak të marrëdhënieve të ngushta shoqërore, çmimi i blerjes së automjetit mund të jetë shlyer edhe paraprakisht nga shtetasi O. Xh. nga shitja e tij ligjore, duke përfshirë në analizën financiare të automjetit edhe këtë vlerë, subjekti rezulton me pamundësi financiare për blerjen e tij si në vijim.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2006 - 20.3.2006 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	197 671
Të ardhura nga paga e z. J. K.	225 517
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa ***	400,000
Pakësim likuiditetesh në bankë	28 154
Blerja e automjetit	705 970
Shpenzime jetike të llogaritur për 3 persona	82 168
Shpenzime qiraje	30 000
Shpenzime udhëtimi	4 330
Rezultati financiar	- 27 434

**6.7** Lidhur me këtë automjet, në seancë dëgjimore, subjekti shpjegoi se: “Lidhur me automjetin tjetër, pra, mjeti \*\*\*, mjet i blerë në vitin 2006, edhe për këtë mjet kam pasur barrën e provës e, lidhur me këtë mjet kam deklaruar si të ardhura, të ardhurat të siguruara nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, të ardhurat e këtij mjeti nuk janë marrë në konsideratë nga ana juaj meqenëse ka pasur diferencë kohore rreth 16-ditore midis momentit të shitjes së mjetit të mëparshëm dhe blerjes së mjetit të ri, pasi mjeti i ri është blerë në mars të vitit 2006, ndërkohë që mjeti i mëparshëm 4060 është shitur në prill të vitit 2006, pra rreth 16 ditë më vonë. Lidhur me këtë moment sqaroj se ky mjet, pavarësisht se kontrata noteriale e shitjes së mjetit është lidhur në prill të vitit 2006, blerësi i automjetit e ka marrë pra mjetin në përdorim që në periudhën shkurt – mars 2006, ka paguar dhe lekët që në atë kohë, pavarësisht se për shkak të marrëdhënieve shoqërore që ka pasur bashkëshorti im me blerësin e pronës është bërë lidhja e kontratës në një moment të mëvonshëm. Lidhur me këtë unë kam depozituar edhe një deklaratë noteriale të blerësit të këtij mjeti, shtetasit O. Xh., i cili ka deklaruar pikërisht këtë fakt që mjetin e ka blerë, e ka marrë në përdorim pra që në muajt shkurt - mars 2006, ka paguar edhe lekët që në atë kohë dhe, për shkak të marrëdhënieve shoqërore që ai ka pasur me bashkëshortin tim, kontrata është lidhur pak ditë më vonë dhe lidhur për të blerë këtë mjet, blerësi i pronës, shtetasi O. Xh. ka marrë edhe një kredi bankare në ‘Tirana Bank’, me të cilën vërtetohet pikërisht se ai ka marrë kredi dhe kredia është marrë që në shkurt ose mars, mos gaboj të vitit 2006, para momentit të lidhjes së kontratës, e cila ka qenë në prill të vitit 2006, ku vërtetohet fakti që pagesa është bërë më parë se lidhja e kontratës. Madje dua të theksoj se shtetasi O. Xh. për shkak të funksionit të tij si gjyqtar ka qenë edhe ai subjekt rivlerësimi dhe nga trupi gjykues, i cili ka vlerësuar çështjen e tij është marrë në konsideratë kjo kredi si burim për të krijuar pikërisht këtë mjet, pra mjetin me targa \*\*\*”.

**6.8** Në konkluzion të sa më sipër dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit, si dhe pas dërgimit të barrës së provës, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri financiare në vlerën 27,434 lekë për krijimin e pasurisë së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*.

## 8. Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni lidhur me deklarin e likuiditeteve në sistemin bankar

**7.1 Llogari bankare në emër të djalit, E. K., në “Intesa Sanpaolo Bank”.** Numri i llogarisë/klientit\*\*\*. Vlera: 320.311 lekë. Pjesa takuese: 50%. Kjo llogari është krijuar nga dhuratat, gjatë viteve nga prindërit e tij dhe të afërmit e tjerë (gjyshërit, kumbara, etj.).

**7.2 Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting<sup>61</sup> statementin nga “Intesa Sanpaolo Bank” të datës 23.1.2017, ku gjendja e llogarisë në këtë datë është 320,311 lekë.**

**7.3 “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>62</sup>** konfirmon se në emër të djalit E.K. është hapur llogari rrjedhëse në datën 31.7.2012 me vlerë fillestare 90,000 lekë, të derdhur nga subjekti i rivlerësimit dhe në të njëjtën datë është bërë edhe një transfertë nga llogaria e saj bankare me vlerë 189,161 lekë. Nga hetimi në llogarinë rrjedhëse të subjektit A.K. në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se transfertat e realizuar prej saj në datën e hapjes së llogarisë së djalit E.K. është krijuar nga derdhja e znj. O.K. – deklaruar kumbara e tij (datë 16.9.2005, vlera 15,452 lekë), nga znj. V.C.(datë 20.9.2006, vlera 75,000 lekë), derdhje *cash* prej vetë subjektit në datën 6.8.2007, në vlerën 70,000 lekë, si dhe nga interesat kreditore të akumuluar në vite të kësaj llogarie. Kjo llogari vazhdon të jetë e hapur edhe sot dhe të akumulojë interesa kreditore ndërsa gjendja e saj në datën 30.12.2016 rezulton të jetë në vlerën 320,311,57 lekë.

**7.4** Në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se për këtë pasuri deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e saj.

## 9. Llogari bankare në emër të djalit, E. K., në “Intesa Sanpaolo Bank”

Numri i llogarisë/klientit \*\*\*. Vlera: 206.533 lekë. Pjesa takuese: 50% me burim të krijimit nga dhuratat gjatë viteve nga prindërit e tij dhe të afërmit e tjerë (gjyshërit, kumbara, etj.).

**8.1** Subjekti ka përcjellë më deklaratën e pasurisë,<sup>63</sup>statementin nga “Intesa Sanpaolo Bank” të datës 23.1.2017, ku gjendja e llogarisë është 206,533 lekë.

**8.2 “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>64</sup>**konfirmon llogarinë rrjedhëse në emër të djalit E.K. me balancë në datën 30.12.2016, në shumën 206,533.06 lekë. Kjo llogari është hapur në datën 31.7.2012 nga derdhja *cash* e subjektit Ariola Kristo, në vlerën 180,000 lekë dhe, më pas, ka vazhduar të rritet vlera e saj nga interesat kreditore të akumuluar gjatë kohës.

**8.3** Lidhur me burimin e krijimit të vlerës së derdhur *cash* në llogarinë rrjedhëse të djalit E.K. nga subjekti është konsideruar paga e vitit dhe është hartuar analiza financiare e shumës së derdhur *cash* në llogarinë e djalit sipas tabelës vijuese.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2012 - 31.7.2012 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhurat nga paga si gjyqtar të subjektit të vlerësimit	286 096
Të ardhurat nga paga si prokuror të bashkëshortit	625 818
Të ardhura nga leja e lindjes së djalit E. K.	185 294
Pakësime të likuiditeteve në bankë	- 396 719

<sup>61</sup>Shihni aneksin nr. 4/3 dhe nr. 9 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>62</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2021, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>63</sup>Shihni Aneksin nr. 4/4 dhe aneksin nr. 9 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>64</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 27.11.2021.

Pagesa për kredinë bankare në “Alpha Bank”	106 526
Shpenzime jetese	329 056
Shpenzime udhëtimi	160 719
<b>Rezultati financiar</b>	<b>104 188</b>

**8.4** Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ rezultoi se në llogarinë e subjektit në “Union Bank”, për periudhën 2012 – 1.6.2012 kanë kaluar vlerat për leje barrëindje të djalit E.K., të cilat subjekti i ka tërhequr në mënyrë të herë pas hershme.

**8.5** Në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, shpjegimeve dhe deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit, deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe trupi gjykues çmoi se subjekti ka pasur mundësi të krijojë me të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e lejëlindjes vlerën fillestare të derdhur *cash* në llogarinë e djalit E. K.

## **10. Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me deklarimin e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar**

### **9.1 Gjendje *cash* në banesë në vlerën 750,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

**9.1.1** Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-të e viteve 2003 -2011 nuk deklaroi vlera *cash* kursimesh.

**9.1.2** Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-të e viteve 2012, 2013, 2015 dhe 2016, ka deklaruar lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar si vijon:

- Në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar: “Kursime në vlerën 300,000 lekë, që janë përdorur për shlyerjen e një pjese të huas së marrë nga z. Th.L., me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011”.
- Në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar: “Kursime në vlerën 300,000 lekë, që janë përdorur për shlyerjen e një pjese të huas së marrë nga z. Th. L., me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011”.
- Në DIPP-në e vitit 2015 deklaroi: “Kursime në gjendje *cash* në vlerën 500,000 lekë”.

**9.2** Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se subjekti në DIPP-të e viteve 2003 – 2016 nuk deklaroi as gjendje as shtesa/pakësime të kursimeve *cash*.

**9.3** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues çmoi dhe konsideroi në analizë deklarimet e subjektit si gjendje *cash* kursimesh. Në lidhje me analizën e burimit të krijimit të gjendjeve *cash*, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi burimin e tyre, por nga trupi gjykues janë konsideruar të tilla, të ardhurat e viteve përkatëse dhe gjendjet e kursimeve nga vitet e mëparshme, të cilat janë pjesë e analizës financiare (referojuni analizës financiare të viteve 2003 – 2016).

**9.4** Në konkluzion, gjatë hetimit të Komisioni rezultoi se ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit për gjendjen e kursimeve në banesë midis deklaratës *Vetting* dhe DIPP-së së vitit 2016. Duke iu referuar deklaratës të subjektit në DIPP-në e vitit 2016, rezultoi se gjendja *cash* në fund të vitit 2016 është në vlerën 500,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* vlerën 750,000 lekë.

**9.5** Subjekti iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me mospërputhjen pasi gjendja *cash* e deklaruar në fund të vitit 2016 është në vlerën 500,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* vlerën 750,000 lekë.

**9.6** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar: “Në lidhje me këtë konstatim, sqarohet se në DIPP-në e vitit 2015 kam deklaruar gjendje *cash* në banesë në masën 500,000 lekë. Ky deklaram është bërë në muajin mars të vitit 2016. Në deklaratën *Vetting* kam deklaruar gjendje *cash* në banesë në masën 750,000 lekë (500,000 lekë të kursyera gjatë vitit 2015 dhe 250,000 lekë të kursyera gjatë vitit 2016). Ky deklaram është bërë në muajin janar të vitit 2017 (data e dorëzimit të deklaratës *Vetting*). Në DIPP-në e vitit 2016 deklarimi i bërë në mars të vitit 2017,

unë nuk kam deklaruar as gjendje, as shtesa, as pakësime. Kjo për arsyen se deklarata DIPP kërkon që të bëhet deklarimi vetëm i shtetasve, ose pakësimeve nga deklarimi i mëparshëm. Ndërkohë gjendja cash në vlerën 750,000 lekë nuk ka pësuar ndryshim nga muaji janar i vitit 2017, kur unë kam deklaruar këtë gjendje cash në deklaratën Vetting me gjendjen cash që unë kam pasur deri në fund të vitit 2016. DIPP-ja e vitit 2016 që pasqyron gjendjen deri në fund të vitit 2016, është plotësuar dhe është dorëzuar në mars të vitit 2017. Pra, unë kam interpretuar se në DIPP-në e vitit 2016 duhet të pasqyroja vetëm ndryshimet nga deklarata paraardhëse (deklarata Vetting). Në këto kushte kur nuk ka pasur ndryshim gjendja cash midis këtyre dy deklaratave kam çmuar se nuk duhej të deklarohet asgjë (gjendje, shtim, pakësim) në deklaratën DIPP të vitit 2016. Fakti që gjendja cash në fund të vitit 2016 ka qenë 750,000 (500,000 lekë nga viti 2015 dhe 250,000 lekë nga viti 2016), provohet edhe me deklaratën DIPP të vitit 2017, ku si burim të ardhurash për krijimin e pasurisë automjet tip 'Audi A6', me targa \*\*\*, kam përdorur edhe gjendjen cash në masën 750,000 lekë. Edhe në analizën financiare të burimit të krijimit të pasurisë automjet tip 'Audi', me targa \*\*\*, të bërë nga ana juaj në raportin e rivlerësimit janë marrë në konsideratë kursimet cash (deklarimi në DIPP-në e vitit 2017) në vlerën 750,000 lekë. Kjo ka qenë logjika dhe arsyeja që kam përdorur kur nuk kam deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 gjendje, shtim, pakësim cash. Në DIPP-në e vitit 2016 nuk është pasqyruar gjendje cash 500,000 lekë”.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**9.7** Trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting mbi gjendjen e kursimeve cash me vlerë 750,000 lekë, jashtë sistemit bankar, rezultoi i saktë në vlerësimin sasior të saj në vijimësinë e deklaratave edhe në DIPP-në e vitit 2017, ku subjekti deklaroi se gjendja cash e akumuluar (vlera 750,000 lekë) është përdorur gjatë vitit 2017 si burim për krijimin e pasurive të luajtshme (automjet tip “Audi A6”, me targa \*\*\*). Ndërsa në lidhje me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2016, për të cilën subjekti shpjegon se ka interpretuar se ka pasur detyrim të deklarohet vetëm ndryshimin nga deklarimi i mëparshëm (pra, nga data e deklaratës Vetting), trupi gjykues çmon se subjekti ka pasaktësi në deklarimin në DIPP-në e vitit 2016 dhe se ky deklarim nuk është sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”. Duke konsideruar se rezultati financiar i vitit 2016, në analizën e Komisionit për periudhën 2003 – 2016 është me vlerë negative prej 340,298 lekësh, vlerësohet nga Komisioni se edhe shtesa e shpjeguar nga subjekti gjatë vitit 2016 me vlerë 250,000 lekë rezultoi me pamjaftueshmëri financiare për krijimin e saj në këtë vit.

## **11. Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me deklarimin e likuiditeteve të ardhura nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit**

**10.1** Llogari rrjedhëse e pagës në vlerën 955 lekë, me nr. \*\*\*e bashkëshortit J. K. . Pjesa takuese: 50%. Nga korrespondenca e Komisionit me “Credins Bank”<sup>65</sup> konfirmohet vlera e deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse në emër të shtetasit J. K. në datën 31.12.2016. Sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

**10.2** Llogari rrjedhëse në vlerën 592 lekë, me nr. \*\*\*, e pagës së subjektit Ariola Kristo. Pjesa takuese: 50%.

**10.2.1** Referuar korrespondencës së Komisionit, në kuadër të procesit të rivlerësimit nga korrespondenca institucionale, rezultoi si vijon:

**10.2.2** “Union Bank”<sup>66</sup> konfirmon vlerën e deklaruar nga subjekti si gjendje e llogarisë rrjedhëse në datën 31.12.2016. Sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues

<sup>65</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 17.12.2020, nga “Credins Bank”.

<sup>66</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 2.12.2020, nga “Union Bank”.

çmoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

**12.** Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë në deklaratën *Vetting* të ardhurat e mëposhtme, të cilat janë trajtuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe janë përfshirë në analizën financiare sipas konsideratave të paraqitura në vijim:

**11.1** Paga *neto* plus shpërblime nga puna si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (nëntor 2002 - fillimi i stazhit profesional, i cili ka qenë i pagueshëm me pagë të plotë të gjyqtarit-dhjetor 2016, duke mos përfshirë lejen e lindjes për të dy fëmijët). Këto të ardhura pasqyrohen në dy vërtetimet e pagës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe paga e muajit dhjetor të vitit 2013, që nuk rezulton në këtë vërtetim pasqyrohet në dokumentin “nxjerrje llogarie” të “Union Bank” në shumën 11,695,837 lekë.

**11.2** Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur me deklaratën *Vetting*<sup>67</sup>: statementin e llogarisë së pagës nga “Union Bank”, në emër të subjektit Ariola Kristo, datë 24.1.2017, me gjendje 592 lekë; vërtetimin<sup>68</sup> e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën e punësimit janar 2002 – dhjetor 2016; vërtetimin<sup>69</sup> e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën e punësimit tetor 2016 - dhjetor 2016.

**11.3** Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe mbështetur në të dhënat e rezultuara nga korrespondenca shkresore e institucioneve përkatëse<sup>70</sup> rezultuan dhe këto të dhëna janë përfshirë në analizën financiare të të ardhurave sipas tabelës vijuese.

(vlerat në lekë)

<i>Viti</i>	<i>2002</i>	<i>2003</i>	<i>2004</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>
Të ardhurat nga paga subjekti Ariola Kristo	71 614	599 530	622 650	792 091	790 683	820 430	787 040	604 147
<i>Viti</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>	<i>Totali</i>
Të ardhurat nga paga subjekti Ariola Kristo	902 660	430 172	490 450	858 291	1 253 941	1 117 110	1 169 407	<b>11 310 216</b>

**11.4** Në konkluzion të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit, trupi gjykues çmoi se rezultoi mospërputhje (shuma 385,621 lekë) në vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, prej 11,695,837 lekësh me të ardhurat e rezultuara nga hetimi prej 11,310,216 lekësh.

**11.5** Në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë konsideruar në analizën financiare të ardhurat e konstatuara nga dietat, të cilat janë dhënë për mbulimin e shpenzimeve specifike të lidhura me funksionin e subjektit.

### **13. Honorare nga puna si pedagogë në universitetin “\*\*\*\*”, Korçë, në vitet akademike 2008 - 2009 dhe 2010 – 2011**

Këto pagesa pasqyrohen në dokumentin e “Credins Bank” dhe në nxjerrjen e llogarisë në “Union Bank”, në shumën 389,295 lekë.

**12.1** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kopjen e statementit<sup>71</sup> bankar të “Credins Bank” për vitin 2009, në të cilin rezultoi se i është transferuar vlera totale prej 146,970 lekësh nga universiteti “\*\*\*\*” sh.p.k. me përshkrimin “honorarë”.

<sup>67</sup> Aneks 4/12 dosja e ILDKPKI-së.

<sup>68</sup> Vërtetim nr.\*\*\*, datë 14.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

<sup>69</sup> Vërtetim nr.\*\*\*, datë 5.1.2016.

<sup>70</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020 (periudha 2009 – 2016), nga “Union Bank” dhe vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, aneks 4/12 dosja e ILDKPKI-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2020 (periudha 2005 – 2008), nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2020, nga DTP-ja; shkresë nr. \*\*\*prot., datë 26.12.2020, nga ISSH-ja.

<sup>71</sup> Statement nga “Credins Bank” aneks 4/12 dosja e ILDKPKI-së.

**12.2** Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se në llogarinë e subjektit në “Union Bank”<sup>72</sup> është transferuar shuma totale prej 242,325 lekësh me përshkrimin “honorare tetor 2010 - janar 2011” dhe “honorare Fakulteti i Drejtësisë shkurt – qershor 2011”.

**12.3** Subjektit, e pyetur nga Komisioni<sup>73</sup> gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me marrëdhënien e punës në universitetin “\*\*\*”, iu kërkuan dokumentacion provues mbi marrëdhënien e punës si pedagoge pranë këtij universiteti, si dhe iu kërkuan shpjegime lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara për të cilat shpjegon se: *“Shuma totale e të ardhurave që kam përfituar si honorare nga universiteti ‘\*\*\*’, Korçë, për punën time si pedagoge e jashtme në vitin akademik 2008 - 2009 dhe në vitin akademik 2010 - 2011 është 389,295 leke, ashtu sikurse është deklaruar nga ana ime edhe në deklaratën Vetting. Nga këto vlera prej 242,325 lekësh ka qenë e transferuar në ‘Union Bank’ dhe pjesa tjetër prej 146,970 lekësh ka qenë e transferuar në ‘Credins Bank’.*

**12.4** Subjekti i bashkëngjiti shpjegimeve: (a) nxjerrjen e llogarisë nga “Union Bank”, dega Korçë, në emër të subjektit të rivlerësimit datë 9.6.2021, nga ku rezulton se në datën 22.7.2011 janë hedhur në llogari me përshkrimin “honorare Fakulteti i Drejtësisë shkurt-qershor 2011” shuma 176,416.79 lekë; (b) nxjerrjen e llogarisë nga “Union Bank”, dega Korçë, në emër të subjektit të rivlerësimit datë 9.6.2021, nga ku rezulton se në datën 17.5.2011 janë hedhur në llogari me përshkrimin “honorare Korça tetor 2010 - janar 2011, shuma 92,407.39 lekë”.

**12.5** Subjekti vijon me shpjegimet në lidhje me paraqitjen e dokumentacionit që provon marrëdhënien e punës si pedagoge në këtë universitet: *“Unë kam qenë pedagoge e jashtme, e caktuar për mësimdhënien e një lënde të caktuar në vitin akademik 2008 - 2009 dhe në vitin akademik 2010 - 2011 nuk janë lidhur kontrata pune. Po kështu, unë sot nuk disponoj asnjë akt që të vërtetojë se jam caktuar për të dhënë lëndët e mësipërme në atë universitet. I vetmi dokumentacion është ai që u kam bashkëngjitur deklaratës Vetting nga ‘Credins Bank’ dhe nga ‘Union Bank’, nga ku rezulton se janë transferuar shumat e mësipërme nga universiteti ‘\*\*\*’ sh.p.k. me përshkrimin ‘honorare’, një dokumentacion të tillë nuk mund ta marr as pranë universitetit ‘\*\*\*’, pasi ai rezulton të jetë një person juridik që tashmë nuk ekziston më dhe që është mbyllur që në vitin 2014 me urdhër të Ministrisë së Arsimit. Po kështu, nuk kam asnjë informacion se ku mund të ndodhet aktualisht arkiva e tij”.*

Subjekti shpjegon gjithashtu edhe lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore nga universiteti “\*\*\*” se: *“Unë nuk kam as informacion në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore në lidhje me këtë shpërblim që kam marrë. Në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, detyrimi i pagimit të tatimit është një detyrim që rëndon mbi punëdhënësin. I tillë është edhe detyrimi për regjistrimin në listëpagesa. Unë nuk jam në dijeni nëse nga universiteti ‘\*\*\*’ është zbatuar ose jo ky detyrim dhe, për shkak të mosekzistencës së tij aktualisht (mbylles së tij), unë nuk mund të marr një informacion prej tij aktualisht”.*

Subjekti dërgon në Komision<sup>74</sup> dokumentacionin lidhur me shpjegimet sa më sipër.

<sup>72</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020, nga “Union Bank”.

<sup>73</sup>Përgjigja nr. 2 pyetësor nr. 5.

<sup>74</sup>Vërtetimin nr\*\*\*prot., date 8.6.2021, të Drejtorisë së Arkivit Qendror Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë për verifikimin e vjetërsisë në punë për periudhën 2008 – 2011, në të cilën citohet se: *“Për subjektin Kolegjin Kristal me dosje nr. \*\*\* listëpagesa për rrethet fillon në shtator 2010 .Për periudhën tetor 2010 - dhjetor 2011 në vërtetim citohet se emri i subjektit nuk figuron në listëpagesë. Vërtetimin për bazën e vlerësuar të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, datë 1.1.2008, në të cilin nuk figurojnë të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi për periudhën 1.1.2008 - 31.8.2010, në emër të subjektit të rivlerësimit. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nga i cili informohemi se nga të dhënat që disponohen në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se nga subjekti “\*\*\*” me NIPT \*\*\*, është kryer pagesë totale për tatimin në burim për vitin 2011, por nuk mund të individualizohen pagesat dhe nuk ka ndonjë dokument të dorëzuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë ku të jetë deklaruar se për cilët individë janë kryer këto pagesat.*

**12.6** Në vijim të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, Komisioni iu drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë<sup>75</sup> për vënien në dispozicion të informacionit mbi pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga honoraret si pedagogje e jashtme ose me kohë të plotë në universitetin “\*\*\*” me NIPT \*\*\* gjatë periudhës 2008 – 2011 për subjektin e rivlerësimit dhe nga kjo drejtori me shkresë<sup>76</sup> informohemi se në të dhënat që disponohen në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë rezultoi se nga subjekti “Kristal” me nr. NIPT \*\*\* është kryer pagesë totale për tatimin në burim për vitin 2011, por nuk mund të individualizohen pagesat për subjektin e rivlerësimit dhe nuk ka ndonjë dokument të dorëzuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ku të jetë deklaruar se për cilët individë janë kryer këto pagesa.

**12.7** Nga sa më sipër, në konkluzion të hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se vlerat e transferuara në bankat e nivelit të dytë si honorare përputhen me vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe e përfshiu në analizën financiare vlerën e të ardhurave të rezultuar në llogaritë bankare të subjektit.

#### **14. Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për bashkëshortin**

**13.1** Paga *neto* e bashkëshortit J. K. plus shpërblimet nga puna si prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën qershor 2005 - dhjetor 2016. Këto pasqyrohen në vërtetimin e pagës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe paga e muajve qershor 2005-nëntor 2005, që nuk rezultoi e detajuar në këtë vërtetim, pasqyrohet në muajin dhjetor, bashkë me pagën e këtij muaji në shumën 11,922,106 lekë.

**13.2** Paga *neto* plus shpërblime dhe dieta të bashkëshortit J. K. nga puna si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nga tetori 2001, fillimi i stazhit profesional, i cili ka qenë i pagueshëm me pagën e plotë të prokurorit, deri në shtator të vitit 2002, në vlerën 466,466 lekë.

**13.3** Paga *neto* plus shpërblime dhe dieta të bashkëshortit J. K. nga puna si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në periudhën 2002 – maj 2005, në vlerën 2,201,336 lekë.

**13.4** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*<sup>77</sup>, për të ardhurat e paraqitura në pikat 13.1-13.2 (më sipër), dokumentet: statementin e llogarisë së pagës nga “Credins Bank”, në emër të shtetasit J.K., në datën 24.1.2017 me gjendje vlerën 955,37 lekë; vërtetimin e pagës<sup>78</sup> nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën e punësimit janar 2005 - dhjetor 2016 për shtetasin J. K.; vërtetimin e pagës<sup>79</sup> nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën e punësimit tetor 2001 - shtator 2002 për shtetasin J.K.; vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për të ardhurat e shtetasit J. K. në periudhën tetor 2002 – maj 2005.

**13.5** Nga hetimi i Komisionit, referuar të dhënave të rezultuara nga korrespondenca shkresore me institucionet përkatëse<sup>80</sup>, rezultuan të ardhurat e mëposhtme, të cilat janë përfshirë në analizën financiare:

<sup>75</sup>Shkresë nr\*\*\*prot., datë 1.6.2020, e DRTT-së.

<sup>76</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2021, e DPT-së.

<sup>77</sup>Shihni aneksin 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>78</sup>Vërtetim page nr. prot., JN datë 1.2017.

<sup>79</sup>Vërtetimi nr\*\*\*prot., datë 20.10.2016.

<sup>80</sup>Vërtetim nga Prokuroria e Gjykatës Korçë, Elbasan dhe Pogradec, aneks 4/12 dosja e ILDKPKI-së, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020 (vitet 2010 -2016) “Credins Bank” dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2020 (vitet 2005 - 2009), nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. \*\*\*prot., datë 25.11.2020, nga DTP-ja; shkresë nr. \*\*\*prot., datë 26.12.2020, nga ISSH-ja.

Vitet	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Të ardhura nga paga e z. J.K.	118 775	493 017	854 511	1 100 404	805 703	902 066	930 611	868 057
Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhura nga paga e z. J.K.	887 554	913 050	933 657	1 072 830	1 024 538	1 237 705	1 209 420	1 146 347

**13.6** Në konkluzion të hetimit administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje në shumën 91,663 lekë, midis vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting* me përgjigjen e institucioneve të administruara gjatë hetimit të Komisionit, mbi të ardhurat e bashkëshortit J. K. . Konstatohet se kjo mospërputhje vjen prej mosmarrjes në konsideratë në analizën e Komisionit të dietave nga shërbimet e punësimit, të cilat jepen me qëllim mbulimin e një shpenzimi specifik, të përcaktuar dhe jo të lidhur me shpenzimet personale të bashkëshortit.

**15. Të ardhurat: në vlerën 65,331 lekë nga leja e lindjes së djalit E. K.; në vlerën 616,869 lekë nga leja e lindjes së djalit E. K. dhe në vlerën 102,740 lekë nga KEMPI i djalit E. K.**

**15.1** Subjekti, lidhur me këto të ardhura i bashkëlidh deklaratës *Vetting*<sup>81</sup>: vërtetimin nga DRSSH-ja Korçë për të ardhurat e subjektit Ariola Kristo nga leja e lindjes në periudhën maj - qershor 2004; vërtetimin nga DRSSH-ja Korçë për të ardhurat e subjektit Ariola Kristo nga leja e lindjes në periudhën qershor 2011 - maj 2012; statementin nga ABI Bank për kreditimet e llogarisë së djalit E. K. .

**15.2** Nga Komisioni u përfshinë në analizën financiare vlerat e mësipërme për lejet e lindjeve, të konfirmuara nga dokumentacioni<sup>82</sup> i përcjellë, ndërsa në lidhje me vlerën e KEMPI-t të djalit në vlerën 102,740 lekë në vitin 2016, rezultoi vetëm vlera e transferuar në llogarinë në “ABI Bank”, e cila ka shënimin PAK (pagesë për persona me aftësi të kufizuara).

**Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me deklarimin e detyrimeve të pashlyera në deklaratën *Vetting***

**16. Kredi me vlerë 1,000,000 lekë, në “Credins Bank”, me nr. kredie \*\*\*, datë 19.11.2015, me afat 3-vjeçar.** Kjo kredi ka filluar të shlyhet në datën 19.12.2015 dhe vazhdon shlyerja edhe sot. Norma e interesit ka qenë 10% me bazë vjetore për vitin e parë dhe interesi i mëvonshëm përshkruhet hollësisht në nenin 5.2 të kontratës. Kësti mujor ka qenë 32,267,17 lekë. Vlera e mbetur pa shlyer deri në plotësimin e deklaratës *Vetting* është 646,855 lekë. Subjekti i bashkëlidh deklaratimeve dokumentacionin lidhur me marrjen e kësaj kredie. Referuar kthim përgjigjes nga “Credins Bank”<sup>83</sup> konfirmohet marrja e kredisë në datën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe vlera e mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2016, në vlerën 646,855 lekë.

## **17. GJETJE TË TJERA**

**16.1** Subjekti i bashkëlidh deklaratës së pasurisë *Vetting*<sup>84</sup> kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 5.12.2014, me kredidhënës “Union Bank”, Tiranë, kredimarrës shtetasit N.Ç. dhe Ariola Kristo. Shuma e kredisë 44.000 euro me afat 20-vjeçar dhe kësti mujor 240 euro.

**16.1.1** E pyetur nga Komisioni mbi këtë kredi, në të cilën ka deklaruar se faktikisht përfituese është motra N. Ç., po ashtu përgjegjëse për shlyerjen e saj është po ajo ndërkohë që në bazë të kontratës së kredisë bankare rezultojnë bashkëkredimarrësve, si dhe për dokumentacion dhe aftësinë paguese të motrës për këtë kredi, subjekti shpjegon se: “*Jam në rolin e*

<sup>81</sup>Shihni aneksin 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>82</sup>Vërtetim nga DRSSH-ja Korçë aneks 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2020, nga “Union Bank” dhe vërtetim nga DRSSH-ja Korçë dhe aneks 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>83</sup>Shkresë nr\*\*\* prot., datë 17.12.2020, nga “Credins Bank”.

<sup>84</sup>Shihni Aneksin nr. 4/19 në dosjen e ILDKPKI-së.



*bashkëkredimarrësës së kredisë për arsye se banka përkatëse (‘Union Bank’), me qëllim dhënien e kredisë, kërkonte ekzistencën e dy personave si kredimarrës”.*

**16.1.2** Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin ligjor të përfitimit të kësaj kredie dhe disbursimin e saj në favor të motrës së subjektit të rivlerësimit, shtetases N. Ç.<sup>85</sup>. Nga sa më sipër, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit lidhur me kredinë e lëvruar.

**17** Gjatë hetimit të Komisionit, me pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerja e një automjeti tip ‘Audi’ me targa \*\*\*. Këtë automjet e kemi blerë në datën 11.10.2017 (është blerë në emër të bashkëshortit tim J. K.) me vlerë 14,621 euro dhe është zhdoganuar në datën 16.10.2017, në vlerën 520,000 lekë. Paguesa në të dy veprimet është bërë cash. Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga kursimet cash (750,000 lekë nga të ardhurat në vite, shitja e automjetit të vjetër me targa \*\*\*, në vlerën 500,000 lekë; marrja e një kredie në ‘Credins Bank’ me kontratën me nr. \*\*\*, datë 9.10.2017, në vlerën 1, 000,000 lekë, si dhe kursime nga të ardhurat në vitin 2017).*

**17.1** Në DIPP-në e vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerja e një automjeti të ri, që ka targa \*\*\*, blerë në Gjermani. Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga kursimet cash, shitja e automjetit të vjetër dhe marrja e një kredie në ‘Credins Bank’. Çmimi i blerjes: 14,621 euro. Vlera e zhdoganimit: 520,000 lekë”.*

**17.2** Nga korrespondenca e Komisionit me institucione publike, DPSHTRR-ja<sup>86</sup> përcjell dokumentacionin për automjetin me targa \*\*\* me nr. shasie \*\*\* tip ‘Audi A6 \*\*\*’ vit prodhimi 2014, në të cilën sipas faturës së shitjes nr. 2017-1664, datë 5.10.2017, shtetasi J.K. e blen në vlerën 17,400 euro nga shitësi \*\*\*, Gjermani. Në fletën e zhdoganimit të datës 16.10.2017, vlera e deklaruar e automjetit është 17,400 euro dhe TVSH-ja e llogaritur në vlerën 519,207 lekë. Bashkëlidhur rezulton mandatpagesa për zhdoganimin e automjetit të kryer nga shtetasi J. K. në “Tirana Bank”, me vlerë 522,300 lekë, datë 16.10.2017.

**17.3** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga komunikimi me “Credins Bank”<sup>87</sup> rezulton se shtetasi J. K. ka marrë kredi në këtë bankë në datën 9.10.2017, në vlerën 1,000,000 lekë. Nga shuma prej 980,000 lekësh, e hedhur në llogarinë e bashkëshortit, është tërhequr cash vlera 300,000 lekë para blerjes (datë 9.10.2017) dhe një pjesë 650,000 lekë, në datën 16.10.2017 (datën e hyrjes së automjetit në territorin shqiptar).

**17.4** Nga të dhënat e administruara rezulton se pjesërisht tërheqja e realizuar në datën 16.10.2017, nga “Credins Bank” është përdorur për pagesën e doganës për automjetin në vlerën 522,300 lekë.

**17.5** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi në DIPP-në e vitit 2017: *“Të ardhura nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, veprim i kryer me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 26.7.2017, pranë noterës F. L. . Vlera: 500,000 lekë”.*

---

<sup>85</sup>Kontratë sipërmarrjeje për prentim apartamenti datë 17.11.2014 e lidhur midis shtetases N.Ç. e “H\*\*\*” sh.p.k. Tiranë; kontratë shitjeje datë 20.3.2015, e lidhur midis shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Tiranë si shitëse dhe N. C. si blerëse; mandatpagesë datë 12.12.2014, në “Union Bank”, ku vërtetohet pagesa e një shume të hollash (pjesë e të cilës ka qenë edhe shuma e marrë kredi me kontratën e kredisë datë 5.12.2014 lidhur me “Union Bank”) për blerjen e shtëpisë së banimit të motrës time N.Ç., duke u kaluar shuma e mësipërme për llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Tiranë; kontratë hipotekimi datë 28.4.2015 e lidhur midis shtetases N. C. e “Union Bank”. Certifikatë pronësie e ZVRPP-së Tiranë; certifikatë personale e motrës sime N.Ç., ku me adresë në gjendjen civile ajo figuron me adresën e apartamentit të mësipërm të banimit në Tiranë e një vërtetim banimi datë 26.8.2015, të lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë. Lëvizjet e llogarisë në “Union Bank” që u përkasin viteve 2014-2015, 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020 (pra nga moment i fillimit të shlyerjes së kësteve të kredisë dhe deri aktualisht), nga ku rezulton se shlyerjet e kësteve të kredisë së mësipërme janë bërë nga motra ime N. Ç.. Vërtetim për bazën e vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë datë 12.11.2020 e një vërtetimi nga shoqëria “V\*\*\*” sh.p.k. Tiranë, me anën e të cilave vërtetohen periudhat e punësimit dhe paga e përfituar nga motra ime N. Ç. . Me to vërtetohet aftësia paguese e motrës time për pagimin e kësteve të kredisë<sup>85</sup>.

<sup>86</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 25.11.2020.

<sup>87</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

**17.6** Me shkresën e DPSHTRR-së, përcjell në Komision me kontratën e shitjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 26.7.2017, me palë blerëse P. P. dhe vlerë shitje 500,000 lekë.

**17.7** Duke konsideruar sa më sipër, Komisioni hartoi analizën financiare të krijimit të pasurisë si më poshtë paraqitur, duke përfshirë si burim: (a) të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit; (b) kredinë bankare në “Credins Bank”; dhe (c) të ardhurat nga shitja e automjetit me targa \*\*\*.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2017 - 5.10.2017 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura nga paga e znj. Ariola Kristo	1 060 319
Të ardhura nga paga e z. J. K.	1 056 030
Të ardhura nga interesat bankare	7 200
Shtesë likuiditetesh në bankë	113 366
Shpenzime jetike për 4 persona	707 760
Shpenzime udhëtimi	8 974
<b>Rezultati financiar</b>	<b>1 293 449</b>

**17.8** Nga sa më sipër, në konkluzion të hetimit administrativ, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë vlerën 1,293,449 lekë deri në datën e blerjes së automjetit nga të ardhurat e vitit 2017.

**17.9** Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni hartoi tabelën vijuese.

<b>Burimet e krijimit</b>	<b>Vlera</b>	<b>Vlera e automjetit me targa *** (vlerat në lekë)</b>
Kredia në “Credins Bank”	950 000	522,300 lekë zhdoganimi + 17,400 euro ~ 2,323,944 lekë vlera e blerjes
Të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***	500 000	
Kursimet e vitit 2017 nga paga e subjektit dhe bashkëshortit	1 293 449	
Kursimet <i>cash</i> (deklarimi në DIPP-në e vitit 2017)	750 000	
<b>Rezultati</b>	<b>3 493 449</b>	<b>2 846 244</b>

**17.10** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për sa më sipër dhe lidhur me automjetin me targa \*\*\*, tip “Audi”, blerë nga bashkëshorti me kontratë shitblerjeje të datës 11.10.2017, në parashtrime, subjekti ka deklaruar: “Në lidhje me këtë mjet janë konstatuar mospërputhje dhe pasaktësi në deklarimin e blerjes së automjetit në DIPP-në e vitit 2017, në vlerën 14,621 euro dhe kontratën e shitjes së tij në vlerën 17,400 euro. Në lidhje me sa më sipër, sqaroj se nuk ka pasaktësi, pasi automjeti sikurse rezulton edhe nga kontrata e shitblerjes është blerë në Gjermani, pra në një vend të Bashkimit Europian. Për të gjitha sendet e blera në një vend të Bashkimit Europian, të cilat më pas dalin jashtë territorit të këtyre vendeve, pra në një vend jo të Bashkimit Europian, merret tax free, pra TVSH, e cila i kthehet blerësit të sendit. Nga fatura e shitjes së mjetit me nr. 2017-1664, datë 5.10.2017, të cilën po e vë në dispozicion, rezulton se vlera e shitjes është 14,621,85 euro, TVSH është 2,778,15 euro dhe vlera e përgjithshme e shitjes është 17,400 euro. Pra, 17,400 euro është vlera e përgjithshme e shitjes, por jo vlera që ne kemi shpenzuar realisht për blerjen e këtij automjeti. Me hyrjen e mjetit në Shqipëri, pra në një vend jo të Bashkimit Europian, pas vendosjes së vulës përkatëse në autoritetet doganore, bashkëshortit tim i ka lindur e drejta që t’i paguhej, pra t’i kthehej vlera e TVSH-së në masën 2,778,15 euro. Pra, vlera realisht e shpenzuar për të blerë

këtë mjet është 14,621.85 euro. Sa më sipër është arsyeja që në DIPP-në e vitit 2017, kjo vlerë është deklaruar 14,621 euro, pra jo sipas vlerës në kontratën e shitblerjes. Bashkëngjitur fatura e shitjes, ku rezulton numri i shasisë së mjetit 'Audi A6', \*\*\*, pra në përputhje me numrin e shasisë së këtij mjeti. Për të marre shumën e mësipërme të eurove, pra TVSH (tax free) në Gjermani, bashkëshorti im ka proceduar duke i dërguar dokumentacionin e mjetit të vulosur në doganë një të njohurit të tij në Gjermani, shtetasit P. J., dokumente të dërguara atij me e-mail e më pas prej tij është marrë kjo vlerë e TVSH-së në autoritetet përkatëse gjermane, e cila i është dorëzuar më pas bashkëshortit tim si blerësi i mjetit. Bashkëngjitur e-mail”.

**17.11** Gjatë seancës dëgjimore vëzhguesi ndërkombëtar, në konkluzion të transaksioneve mbi automjetet e deklaruara nga subjekti gjatë hetimit, ka referuar dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit: “Ju dhe bashkëshorti keni përdorur kaq shumë automjete dhe duket sikur jeni koncesionar automjetesh, ne jse ky është thjesht mendimi im personal, nuk ka lidhje. Por të paktën tri herë rresht (jo vetëm një herë) ju blini një automjet me çmim më të lirë dhe e shisni me një çmim shumë më të lartë, më pas pasi e përdorni disa vite ... Rasti i parë BMW që e keni blerë në vlerën 200,000 lekë në vitin 2005 dhe e shisni dyfish në vlerën 4,000,000 lekë në vitin 2006. Pastaj është një automjet tjetër tip ‘Mercedes-Benz’, që e keni blerë në vlerën 400,000 lekë në vitin 2013 dhe e keni shitur në vlerën 500,000 lekë në vitin 2017, pra 4 vjet më vonë, dhe një tjetër tip ‘Mercedes-Benz’, që e keni blerë në vitin 2006, në vlerën 400,000 lekë dhe e keni shitur në vitin 2008, në vlerën 700,000 lekë; pra mund të ndodhi një herë por jo tri herë rresht më duket e çuditshme, kjo nuk më duket e saktë. Kur shoh këto gjëra mendoj kush është fiktiv çmimi i blerjes apo çmimi i shitjes”.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pyetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, shpjegoi se: “Lidhur me automjetet mendoj që nuk qëndron ashtu, që janë shitur më shumë se sa janë blerë sepse në vlerën e blerjes u relatua vetëm çmimi i blerjes, por jo dhe çmimi i zhdoganimit që është paguar për zhdoganimin e mjetit dhe mendoj që duke i mbledhur të dyja del një vlerë e përafërt me vlerën e shitjes të mjetit, mendoj që personi që e ble mjetin pastaj e blen me doganën e paguar, aty duhen konsideruar të dyja vlerat, si vlera e paguar për të blerë mjetin ashtu edhe vlera për zhdoganimin e tij sepse jam e detyruar të paguaj edhe vlerën e zhdoganimit të personi tjetër që e ka blerë prej meje e ka blerë me gjithë vlerën e zhdoganimit dhe kjo është arsyeja që duke mbledhur të dyja vlerat, pra si blerjen e mjetit ashtu edhe zhdoganimin vetë vlera totale e mjetit”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**17.12** Trupa gjyquese në analizë të dokumentacionit gjatë hetimit dhe analizës financiare të kryer trupa gjyquese çmoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë pasurinë e mësipërme të burimet e krijimit të deklaruara prej tij por konstatohet se ka pasaktësi në deklarinimin e vlerës së blerjes së automjetit në DIPP të vitit 2017 me vlerën 14,621 euro dhe dokumentacionit të përcjellë në komision, kontrata e shitjes me vlerë 17,400 euro.

**18.** Gjatë hetimit të Komisionit,<sup>88</sup> subjekti përcjell certifikatë të gjendjes familjare të vitit 2010 nga ku rezulton së në përbërjen familjare është së bashku me motrën dhe prindërit e bashkëshortit.

**18.1** Subjekti në Deklaratat Periodike të Interesave Private nga viti 2003 deri në 2010 ka deklaruar përbërjen familjare me bashkëshortin dhe djalin dhe jo sipas përbërjes familjare në certifikatën familjare depozituar nga vetë ajo.

**18.2** Referuar sa më sipër në analizë të dhënave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve mbi përbërjen familjare ndër vite të subjektit të rivlerësimit trupa çmoi se subjekti ka mospërputhje të deklarimeve për përbërjen familjare të deklaruara në Deklaratat Periodike të Interesave Private të viteve 2003-2010 me dokumentacionin e përcjellë në komision (certifikatat familjare).

<sup>88</sup>Përgjigjja nr. 1, pyetësor standard.

## Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

### Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare, është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën *Vetting*, në pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në:

- *Të ardhurat e ligjshme* sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, dërguar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortit, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës (trajtuar më lart specifikisht secila prej tyre).
- *Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë, sa vijon:*
  - a) Shpenzimet e jetesës për vitet 2003 – 2016 u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së<sup>89</sup>.
  - b) Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe deklaratimet e subjektit<sup>90</sup>. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019 të Kolegjit. Gjithashtu, Komisioni ka konsideruar në analizën e tij shpenzimet e qëndrimit brenda ditës në K.(K.) Greqi, përveç shpenzimeve të udhëtimit edhe shpenzime qëndrimi prej 5 euro për të rritur, 2.5 euro për fëmijë mbi 2 vjeç dhe 1.5 euro për fëmijë 0-2 vjeç.

Subjekti ka shpjeguar në pyetësorin standard se: *“... si unë, ashtu edhe bashkëshorti dhe fëmijët e mi kemi pasur udhëtime jashtë shtetit. Për shkak të afërsisë kufitare me shtetin e Greqisë, udhëtimet kanë qenë të shpeshta, sidomos ato vajtje-ardhje brenda disa orëve. Për shkak të cilësisë së ilaçeve, ushqimeve, veshjeve, shërbimeve mjekësore, si dhe për shkak të afërsisë gjeografike (largësia e Korçës është vetëm 42 km nga K./K., Greqi) kemi udhëtuar shpesh herë. Bashkëngjitur, bazuar në të dhënat e të gjitha pasaportave të mia dhe të familjarëve të mi (bashkëshorti dhe dy fëmijët), janë të gjitha hyrje-daljet e cilësuar sipas viteve. Në lidhje me udhëtimet në Maqedoninë e Veriut bëj me dije se kalimi kufitar me këtë shtet për një periudhë është herë me dokument kufitar, që nuk e disponoj më dhe për një farë kohe është bërë me ID (kartë identiteti). Për këto arsye mund të ketë udhëtime të pacilësuar në tabelat bashkëngjitur, pasi për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar ato nuk më kujtohen”*.

Në shpjegimet e veta, të përcjella gjatë hetimit, subjekti deklaroi se shpenzimet e udhëtimit me destinacion K., për të dhe familjarët e saj kanë qenë vetëm për rrugën, me vlerë 8 euro për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016. Komisioni, në kryerjen e analizës financiare ka llogaritur shpenzimet e udhëtimit sipas metodologjisë së mësipërme duke shtuar shpenzime qëndrimi me vlerë 5 euro për të rritur, 2.5 euro për fëmijë mbi 2 vjeç dhe 1.5 euro për fëmijë 0-2 vjeç. Kolegji, gjithashtu, mban të njëjtin qëndrim edhe në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë

<sup>89</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

<sup>90</sup>Përgjigjet e pyetësorit standard.

22.5.2019, ku pavarësisht se është provuar mbulimi i shpenzimeve të qëndrimit, janë llogaritur shpenzime ditore qëndrimi si më sipërtrajtuar.

- Gjatë seancës dëgjimore, relatorja e çështjes iu drejtua subjektit të rivlerësimit dhe i bëri me dije lidhur me analizën financiare të dërguar subjektit me rezultatet e hetimit mbi shpenzimet që janë vënë sipas metodologjisë së Komisionit për udhëtimet e subjektit dhe të bashkëshortit të subjektit dhe referuar analizës financiare vihet re se shpenzimet për udhëtime janë të konsiderueshme duke relatuar nëse ishte dakord me vlerësimin që Komisioni ka bërë dhe nëse subjekti dispononte prova të tjera lidhur me këtë vlerësim të shpenzimeve financiare që Komisioni ka bërë.
- Subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni mbi shpenzimet e udhëtimit, përgjigjet se: *“Prova të tjera përveç atyre që kam bashkëngjitur gjatë procesit të rivlerësimit me pyetësozin, fillimisht, me pyetësozin standard flas nuk kam prova të tjera për të paraqitur. Në udhëtimet që i kemi bërë jashtë shtetit kanë qenë udhëtime të shumta, të cilat kryesisht kanë qenë udhëtime 1-ditore, në K., i cili është shumë afër qytetit të Korçës dhe duke u nisur nga fakti se qoftë mjekimeve, ilaçeve, qoftë gjërat e tjera janë më mirë në Greqi sesa në Shqipëri, ne kemi vlerësuar që të shkonim shpesh herë aty dhe shumica e udhëtimeve kanë qenë udhëtime ditore ku ne kemi shkuar brenda ditës, kemi realizuar qëllimin për të cilin kemi vajtur, për shembull një vizitë te mjeku, një blerje e diçkaje, blerjen e ushqimit dhe pastaj jemi kthyer përsëri. Për ato udhëtime ku unë kam pasur dokumente provuese i kam bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësozit standard që kanë qenë kryesisht dy udhëtimet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një te motra ime dhe një te kumbara e fëmijëve të mi, të tjera dokumente nuk kam”.*

Pas dërgimit të prapësimeve të rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova të reja dhe nuk përcolli kundërshtime me metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit, trupi gjykues çmoi të mbajë të njëjtin qëndrim për këtë çështje në analizën financiare, ashtu si dërguar me rezultatet e hetimit.

c) Shpenzimet e mobilimit<sup>91</sup> u bazuan në deklaratimet e subjektit për shpenzimet e apartamentit.

Detyrimet ndaj huamarrësve S.K. dhe Th.L. u bazuan në deklaratimet e subjektit, të kryera në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën *Vetting*, si edhe në dokumentacionin<sup>92</sup> e depozituar.

Shpenzimet për blerje automjetesh<sup>93</sup> u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, në pyetësozët, si dhe në dokumentacionin përkatës.

Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore.

***Gjendja e likuiditeteve<sup>94</sup> në bankë***, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare

Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit lidhur me vlerën negative si rezultat i analizës financiare, shpjegoi se: *“Gjatë studimit të tabelës së analizës financiare vë re se në vitin 2003 është llogaritur si shtesë likuiditete në bankë shuma prej 1,337, 982 lekësh. Në fakt e vërteta është se bashkëshorti im këtë vit, pra, në vitin 2003 ka shtuar likuiditetin në bankë me 670,000 lekë, ashtu siç rezulton e provuar edhe përgjatë raportit tuaj.*

<sup>91</sup>Pyetësozi standard dhe deklarata *Vetting*.

<sup>92</sup>Provat bashkëlidhur përgjigjes së pyetësozit standard dhe bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

<sup>93</sup>Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 25.11.2020, nga DPSHTRR-ja.

<sup>94</sup>Shkresat nr. \*\*\*prot., datë 10.12.2020, nga BKT-ja; nr. \*\*\*prot., datë 1.12.2020, nga “Tirana Bank”; nr.\*\*\*prot., datë 19.11.2020, nga “Raiffeisen Bank”, nr. \*\*\*prot., datë 27.11.2020, nga “ProCredit Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2020, nga “ABI Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

*Është gjendja ekzistuese në llogari (që nga viti 2002) së bashku me shtimin prej 670,000 lekësh (të bërë në vitin 2003) ajo që jep shumën 1,337,982 lekë, pra nuk është kjo shumë e shtuar si likuiditet në vitin 2003, por vetëm 670,000 lekë. Për këtë arsye rezultati financiar në fundvitin 2003 nuk është -453,006 lekë, por 214,876 lekë.*

*Vlera prej 2,144,930 lekësh e ardhur si pasojë e kursimeve të bashkëshortit dhe prindërve të tij, është përdorur për ndërtimin e shtëpisë, ashtu siç rezulton e provuar edhe përgjatë raportit tuaj. Për këtë arsye ajo duhet të llogaritet në vitin 2007 dhe jo në vitin 2005, pavarësisht se është tërhequr në atë vit. Në qoftë se ajo do të llogaritet gjatë kohës së ndërtimit të shtëpisë rezultati financiar në fundvitin 2007 nuk është -3,001,474 lekë, por -856,544 lekë”.*

Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruar u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën “*Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacionin justifikues ligjor, të cilat janë përcjellë pas kalimit të barrës së provës, si dhe kryesisht me shpenzimet mbi hyrjet-daljet në shtetin shqiptar të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për të cilat pas kalimit të barrës së provës me rezultatet përfundimtare subjekti nuk parashtrroi shpjegime.

Në konkludim të sa më sipër, bazuar në arsyetimin dhe qëndrimet e mbajtura nga trupi gjykues, rezultati i analizës financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016 është me vlerë negative prej 6,846,602 lekësh.

Në përfundim, pas kalimit të barrës së provës dhe zhvillimit të seancës dëgjimore dhe mospërfshirjes si burim të ligjshëm të huas së z. S.K. dhe trajtimit të pasaktësive të mësipërme në analizën financiare të viteve 2003 – 2016, çështje të cilat janë trajtuar gjerësisht sa më lart, rezultati i analizës financiare rezulton në vlerën negative 4,519,101 lekë.

## Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>737 982</b>	<b>1 581 041</b>	<b>-14 930</b>	<b>353 677</b>	<b>7 051 981</b>	<b>2 517 425</b>	<b>209 666</b>	<b>-251 607</b>	<b>644 670</b>	<b>175 012</b>	<b>-123 274</b>	<b>27 805</b>	<b>1 011 887</b>	<b>0</b>
Truall + banesë, ndërtesa është tre kate me bodrum, sipërfaqja totale 159 m2 nga e cila 100 m2 ndërtesë.			1 900 000		7 058 824	2 941 176								
Automjet i llojit veturë, marka V*** me targa K***. Është zhdoganuar nga ne në vlerën 216.551 lekë në dt.8.7.2010.								266 551						
Automjeti marka M*** B** me targa A**, blerë në dt. 9.10.2013 në vlerën 400.000 lekë. (Në kohën e blerjes automjeti kishte targën P**).										400 000				
Automjet marka B** me targa K**. Blerë në dt. 23.5.2002 në vlerën 150.000 lekë. Është zhdoganuar në vlerën 161.850 lekë datë 24.5.2002. Makina është shitur në datën 11.10.2005 në vlerën 150.000 lekë.			-150 000											
Automjet marka B** me targa K**. Blerë në dt.7.2.2005 në vlerën 200.000 lekë. Është zhdoganuar rreth 180.000 lekë. Makina është shitur në datën 5.4.2006 në vlerën 400.000 lekë.			380 000	-400 000										
Automjet marka M*** B** me targa K**. Blerë në dt. 20.3.2006 në vlerën 500.000 lekë. Është zhdoganuar në vlerën 205.970 lekë datë 19.3.2006. Makina është shitur në datën 7.7.2010 në vlerën 700.000 lekë.				705 970				-700 000						
Automjet targa A** dt. 26.07.2017 vlera 14,621 euro dhe zhdoganimi 520,000 lekë														
Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë	737 982	1 581 041	-2 144 930	47 707	-6 843	-423 751	209 666	181 842	644 670	175 012	-523 274	27 805	1 011 887	
Gjendje e kursimeve (cash) sipas deklarimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	300 000	300 000	0	0	500 000	500 000
Total likuiditete	737 982	2 319 023	174 093	221 800	214 957	-208 794	871	182 714	827 383	1 002 395	479 121	506 926	1 518 813	1 551 630
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3 424 171</b>	<b>2 268 765</b>	<b>-847 165</b>	<b>-588 874</b>	<b>-507 098</b>	<b>-383 893</b>	<b>-3 923</b>	<b>-484 073</b>	<b>5 064</b>	<b>-972 669</b>
Hua nga xhaxhai i subjektit S** K**o														
Hua nga T*** L**									2 500 000	-300 000	-300 000		-500 000	-600 000
Kredia I pranë A** B** sha					3 424 171	-191 672	-781 728	-510 521	-772 191	-83 893	-93 428	-638 453	-67 275	-69 417
Kredia II pranë A** B** sha						2 460 437	-65 437	-78 353	-2 234 907					
Kredia I pranë C*** b** sha											389 504	-249 233		
Kredia II pranë C** b** sha												403 613	-403 613	
Kredia III pranë C** b** sha													975 952	-303 252
Kredia IV pranë C** b** sha														
<b>PASURI NETO</b>	<b>737 982</b>	<b>1 581 041</b>	<b>-14 930</b>	<b>353 677</b>	<b>3 627 809</b>	<b>248 660</b>	<b>1 056 831</b>	<b>337 267</b>	<b>1 151 768</b>	<b>558 905</b>	<b>-119 350</b>	<b>511 878</b>	<b>1 006 823</b>	<b>972 669</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1 522 023</b>	<b>1 895 262</b>	<b>1 694 923</b>	<b>1 692 749</b>	<b>1 751 041</b>	<b>4 118 747</b>	<b>1 638 671</b>	<b>1 815 710</b>	<b>2 037 718</b>	<b>1 748 574</b>	<b>1 901 425</b>	<b>2 518 305</b>	<b>2 339 268</b>	<b>2 428 185</b>
Të ardhura nga paga e A** K**	599 530	622 650	792 091	790 683	820 430	787 040	604 147	902 660	430 172	490 450	858 291	1 253 941	1 117 110	1 169 407
Të ardhura nga paga e J** K**	854 511	1 100 404	805 703	902 066	930 611	868 057	887 554	913 050	933 657	1 072 830	1 024 538	1 237 705	1 209 420	1 146 347
Honorare nga puna si pedagog në Universitetin K**, K**							146 970		242 325					
Të ardhura nga leja e lindjes së djalit E** K**		65 331												
Të ardhura nga leja e lindjes së djalit E** K**									431 564	185 294				
Të ardhura nga KEMP i djalit E** K**														102 740
Të ardhura nga interesat bankare	67 982	106 877	97 129								18 596	26 659	12 738	9 691
Dhurimi i prindërve të bashkëshortit per banesen						2 463 650								
<b>SHPENZIME</b>	<b>637 047</b>	<b>442 111</b>	<b>729 428</b>	<b>934 076</b>	<b>1 124 706</b>	<b>3 408 822</b>	<b>1 057 545</b>	<b>1 056 193</b>	<b>1 381 191</b>	<b>1 056 977</b>	<b>1 928 952</b>	<b>1 984 276</b>	<b>1 430 938</b>	<b>1 775 814</b>
Interesa për kreditë bankare pranë C** b** sha											40 211	67 475	48 991	76 051
Interesa për kreditë bankare pranë A** b*** sha							175 639	170 697	144 378	98 722	83 042	78 445	49 050	44 224
Shpenzime prishje të ndërtesës së vjetër														
Shpenzime qiraje	30 000	120 000	120 000	120 000	120 000	120 000								
Shpenzime për vendosjen e grilave											500 000			
Shpenzime për lindjen e djalit E** K**									183 000					
Shpenzime mobilimi						2 500 000								
Shpenzime per veshje blere me karte krediti, deklaruar ne DIPP									62 800					
Shpenzime jetike	187 728	234 660	328 671	328 671	369 266	409 860	409 860	409 860	466 785	564 096	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi	419 319	87 451	280 757	485 405	635 440	378 962	472 045	475 635	524 228	394 160	741 602	958 365	435 793	715 171
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>146 994</b>	<b>-127 890</b>	<b>980 426</b>	<b>404 996</b>	<b>-3 001 474</b>	<b>461 265</b>	<b>-475 704</b>	<b>422 250</b>	<b>-495 241</b>	<b>132 691</b>	<b>91 824</b>	<b>22 151</b>	<b>-98 494</b>	<b>-320 298</b>

## KONKLUZION PËR KRITERIN E VLERËSIMIT TË PASURISË

Komisioni shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti për pyetësorët e dërguar, si dhe provat e parashtrimet në përgjigje të barrës së provës.

Në përfundim konstatohet se subjekti/personi i lidhur me të:

- i. Kanë bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e ndërtimit dhe investimit për objektin banesë me 3 kate, me bodrum, për të cilin në DIPP-të e vitit 2008 deklarojnë vlerën 7,000,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarojnë vlerën 14,900,000 lekë.
- ii. Subjekti ka bërë mosdeklarim të ndërtimit të objektit banesë me 3 kate + bodrum në deklaratën e interesave private periodike të viteve 2006 dhe 2007.
- iii. Subjekti ka mospërputhje të deklaratës *Vetting* me deklaramet gjatë procesit të rivlerësimit për periudhën e kryerjes së veprimeve juridike të shitjes së apartamentit, ku në deklaratën *Vetting* duket se deklaroi si vit shitjeje të apartamentit vitin 2008 dhe gjatë procesit të rivlerësimit depoziton kontratë shitjeje, nga ku rezulton se apartamenti është shitur në vitin 2012.
- iv. Subjekti ka mospërputhje të qëndrimeve lidhur me shumën 20,000 euro të dhënë nga prindërit, përkatësisht në deklaratën *Vetting* deklaroi “si dhuratë” dhe gjatë procesit të rivlerësimit deklaroi se është “kontribut”.
- v. Subjekti ka pasaktësi të deklarimeve të vlerës së shitur të apartamentit:
  - a) në deklaratën *Vetting* deklaroi vlerën e të ardhurave të shitjes 20,000 euro;
  - b) gjatë procesit të rivlerësimit deklaroi 21,967 euro;
  - c) vlera sipas kontratës së shitjes është 3,200,000 lekë.
- vi. Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 depozitat nga bashkëshorti në shumën 1,454,295 lekë në “Tirana Bank” dhe depozitën në vlerën 743,281 lekë “ProCredit Bank”.
- vii. Subjekti nuk ka burime të ligjshme për të bërë investimin dhe/ose shpenzimet e deklaruar, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 5,675,124 lekë. Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks 1, pjesë e vendimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se:

- i. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit



të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo:

- a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;
- b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në Deklaratën për Kontrollin e figurës;
- c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar

**Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo.**

Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni kreu hetimin administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

3.21.1.1 Me shkresën nr. \*\*\*, datë 13.11.2020, Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme nëse subjekti Ariola Kristo ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2021, ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e ardhur prej saj dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga ku rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. \*\*\*, datë 4.5.2021, informon se ndaj subjektit Ariola Kristo janë regjistruar 3 materiale kallëzuese: (a) kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 24.1.2019, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën në datën 5.2.2019 është vendosur mosfillimi i hetimeve; (b) kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 3.2.2020, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën në datën 17.2.2020 është vendosur mosfillimi i hetimeve; si dhe (c) kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2017, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\* të vitit 2017, ndaj subjektit të rivlerësimit.

3.21.1.2 Komisioni iu drejtuar edhe Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka informuar se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. \*\*\*, datë 29.1.2021, për të cilin Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në arsyetimin e saj për mosfillimin e procedimit penal, ka arsyetuar në interpretim të ligjit material dhe procedural të tij në çështjen konkrete, si dhe në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të çështjes që i përkasin juridiksionit të gjykatave dhe jo prokurorisë. Rregullat dhe procedurat e ankimit të vendimeve parashikohen specifikisht në Kodin e Procedurës Penale. Për më tepër, askush, duke përfshirë këtu edhe Prokurorinë e Posaçme, nuk mund të gjykojë mbi bazueshmërinë në ligj të vendimeve të një gjyqtari. Në konkluzion të sa më sipër, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur mosfillimin e procedimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi nuk konstatohen veprime në kundërshtim me ligjin të kryera nga subjekti i rivlerësimit që të veprojnë në kundërshtim me ligjin në mospërbushje të rregullt të detyrës që t’i kenë sjellë asaj apo të tjerëve përfitime të cilitdo lloji, apo të kenë dëmtuar interesat e shtetit apo shtetasve dhe të përbëjnë elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”.

3.21.1.3 Trupi gjykues, në pajtueshmëri me vendimet e marra nga organi i akuzës, në konkluzion, pas shqyrtimit të akteve të procedimeve penale, vlerëson se bazueshmëria në prova dhe në ligj e një veprimtarie të prokurorit mund t'i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor. Nenit 290 dhe 291, në interpretim edhe të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, kanë përcaktuar se: “Vendimet u njoftohen menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit” dhe se: “Gjykata, kur e gjen të të drejtë ankimin e të dëmtuarit, vendos që hetimet të vazhdojnë”. Ndaj vendimeve të gjykatës ligjvënësi ka parashikuar ankim në gjykatën me të lartë dhe kur ka elementë të veprës penale ndaj gjyqtarit, si çdo subjekt i së drejtës të cilët kanë të detyrimin për të mos shkelur ligjin, mund të drejtohen në kallëzim penal.

Sa më sipër, çështjet e analizuar në vendim dhe konkluzionet e arritura do të merren parasysh në një vlerësim të përgjithshëm, në këndvështrim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues, në vlerësimin e rrethanave faktike si më sipër, ka parasysh se objekt i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni çmon të nevojshme të trajtojë konkluzionet e sipërpërmendura në gjykimin e çështjeve si më sipër, në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Nga hetimi i pavarur i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ariola Kristo, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Në zbatim të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2020, i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Ariola Kristo, nga ku rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

### **1. Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Bën cilësim të saktë të veprës penale dhe përgjithësisht është korrekte në zgjedhjen e llojit dhe masës së dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

## **2. Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekt i rivlerësimit Ariola Kristo, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Ajo ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe i janë caktuar për gjykim gjithsej 1283 çështje, ku ka përfunduar 1037 çështje, duke mbartur vitin e fundit 39 prej tyre. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 80,8 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Ariola Kristo ka përfunduar së gjykuari 938 çështje. Nga ky total, 223 janë çështje civile të përgjithshme, 2 çështje tregtare, 299 çështje administrative, 225 çështje civile të veçanta, 221 çështje penale themeli (krime + kundërvajtje), 56 janë penale të veçanta, 32 janë çështje penale në fazën e hetimit dhe 150 janë penale në fazën e ekzekutimit. Rrjedhimisht, ajo ka plotësuar dhe tejkaluar standardin sasior të paracaktuar nga germa “a”, e nenit 3, të Aneksit 1.

Shkaqet për tejkalimin e afatit standard të gjykimit në dosjen 2 lidhen me sjelljen e palëve gjatë procesit, por edhe me menaxhimin jo të mirë të çështjes nga gjyqtarja. Vetëm në një rast afati ligjor është shkelur dukshëm, në rastin e dosjes 1, vendim i u dorëzua pas 33 ditësh nga shpallja.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Ariola Kristo janë paraqitur gjithsej 3 ankesa në ish-Inspektoratin e KLD-së, ku dy prej tyre, që i përkasin vitit 2015, janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar dhe një tjetër që i përket vitit 2014, ku pretendohet zvarritje e gjykimit, pas verifikimit të saj nuk rezultuan shkelje. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit përgjithësisht është efeciente dhe efektive në çështjet që ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit Ariola Kristo, përgjithësisht ka shfaqur aftësitë e duhura për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara. Për t’u vlerësuar është fakti që të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjykimit.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Arjola Kristo ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2000 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku vazhdon edhe aktualisht.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Për vetë subjektin e rivlerësimit vetëm në dosjen nr. 2 ka pasur një kërkesë nga pala e paditur për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues dhe u vlerësua e pabazuar, pra u rrëzua. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Ariola Kristo komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Të theksuara në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

#### *c) Gatishmëria për t’u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 14 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Në formularin e vëtvlerësimit ka deklaruar se nuk ka kryer trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

**1.** Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosje penale të përzgjedhura me short, si edhe të dhëna nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 1283 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 1037 çështje. Ajo ka mbartur për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës gjithsej 39 çështje. Të dhënat statistikore të mësipërme janë shoqëruar me shkresën

nr. \*\*\*prot., datë 20.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ushtron detyrën gjyqtarja Ariola Kristo.

**1.2** Pas verifikimit të raportit, Komisioni konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional vetëm në dokumentin nr. \*\*\* të depozituar nga subjekti dhe dosjen nr. \*\*, të rezultuar nga përzgjedhja me short e dosjeve nga Komisioni.

**Dokumenti 2** – vendimi gjyqësor penal nr. \*\*, datë 20.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që i përket çështjes penale me nr. regj. them. \*\*, datë regj. 16.3.2016, çështje në ngarkim të disa të pandehurve për konsumim të veprës penale “vjedhje të bankave dhe arkave të kursimit”, të parashikuar nga neni 136/2 i Kodit Penal dhe veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Çështja është gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese. Referuar rrethanave të çështjes penale rezultoi se banka “\*\*\*\*” është një bankë e nivelit të dytë, e cila ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë dhe një ndër degët e saj është edhe ajo e ndodhur në qytetin e B. . Në këtë degë të bankës, gjatë periudhës nëntor 2005 – shkurt 2015 janë konstatuar një sërë veprimesh të parregullta të kryera nga të pandehurit. Duke marrë shkas nga ankesa e një klienti, banka është vënë në dijeni në lidhje me veprimtarinë e parregullt që zhvillohej në degën B., veprimtari ndaj së cilës banka “\*\*\*\*” ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në përfundim të hetimeve prokuroria ka paraqitur kërkesën në gjykatë ndaj procedimit të regjistruar në ngarkim të të pandehurve për të cilët, me vendimin nr. \*\*, datë 20.7.2016, në përfundim të gjykimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarimin fajtor dhe caktimin e masave të dënimit të individualizuar për ta.

**1.3** Komisioni, referuar sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) gjatë hetimit konstatoi se ndaj vendimit nr. \*\*, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. \*\*, datë 23.2.2017, ka vendosur: (a) “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, lidhur me disponimet për të pandehurin J. Gj. për veprën penale ‘shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në lidhje me kontratën bankare afatshkurtër nr. \*\*, datë 5.9.2012, nr. \*\*, kontratën bankare afatshkurtër nr.\*\*, datë 22.12.2011, nr. \*\*”; (b) “Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit J. Gj. për veprën penale të parashikuar nga neni 248 në lidhje me kontratën bankare afatmesme”; (c) “Lënien në fuqi të vendimit lidhur me disponimin për provat materiale”. Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë çështja penale është duke u gjykuar pranë kësaj gjykate.

**1.4** Gjykata e apelit, në vendimmarrjen e saj ka arsyetuar lidhur me ndryshimin e vendimit nr. \*\*, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Mbi hetimin gjyqësor të kryer nga subjekti i rivlerësimit, pasi ka marrë në shqyrtim provat e administruara gjatë gjykimit, arsyeton se për sa i përket disponimit të vendimit që lidhet me deklarimin fajtor të të pandehurit J. Gj., për veprën penale “shpërdorim detyre”, që ka të bëjë me përpilimin prej tij të kontratës së kredisë bankare afatmesme nr. \*\*, datë 21.11.2011, me nr. \*\*, Gjykata e apelit ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë një vlerësim të gabuar të përmbajtjes së akteve të hetimit paraprak (fashikullit të prokurorit), të cilat, në kushtet e zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, kanë marrë vlerën e provës, duke arritur në konkluzionet e gabuara lidhur me fajësinë e të pandehurit për këtë vepër<sup>95</sup>.

<sup>95</sup>Ka rezultuar e provuar gjatë gjykimit që i pandehuri J. Gj., në cilësinë e noterit, ka përpiluar kontratën e mësipërme, sipas përmbajtjes së të cilës banka “\*\*\*\*” ka lidhur kontratën e kredisë bankare afatmesme me nr. \*\*, datë 21.11.2011, nr.\*\*, e cila, sipas aktekspertimit ka rezultuar me nënshkrime të falsifikuara. Gjykata e shkallës së parë, në përfundim të gjykimit, duke u pajtuar me argumentet e paraqitura nga organi i akuzës, ka arritur në përfundimin që i pandehuri ka konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (në lidhje me kontratën e tretë të sipërcituar).

Gjykata e apelit ka konstatuar që referimi i gjykatës së shkallës së parë në kontratën e paraqitur në formën e fotokopjes në funksion të argumentimit të fajësisë së të pandehurit, është jo vetëm i gabuar, pasi mbështetet në një akt që nuk plotëson kushtet formale për t'u konsideruar provë, por në të kundërt, ekzistenca e këtij akti hedh dritë mbi faktin që mbi të mund të jenë kryer ndërhyrje dhe manipulime nga ana e të pandehurit, me detyrë drejtor banke, me qëllim për të realizuar qëllimin e tij final, disbursimin e kredisë në emër të kredimarrësit (fiktiv) në vazhden e veprimeve të tij të kundërligjshme, me qëllim përfitimin për vete të pasurisë së bankës. Mosparaqitja nga ana e bankës e kopjes origjinale të kontratës së kredisë, mbi bazën e të cilës është bërë disbursimi i kredisë, si dhe fakti që përmbajtja e kontratës së përdorur për këtë qëllim është e ndryshme nga ajo e kontratës së sekuestruar te noteri, krijon bindjen se mbi kontratën tjetër janë bërë ndërhyrje. Disbursimi i kredisë së përfituar më pas në mënyrë të kundërligjshme nuk është bërë në bazë të kontratës origjinale të sekuestruar pranë zyrës së noterit dhe të paraqitur si provë nga prokuroria, por në bazë të kopjes tjetër, e cila tashmë paraqitet vetëm si fotokopje dhe në të cilën janë kryer ndërhyrje, pa të cilat miratimi i kredisë do të rezultonte i pamundur.

**1.5** Lidhur me konstatimet sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës.

**1.6** Sa më sipër, subjekti shpjegoi si vijon: *“Në lidhje me çmuarjen që u kam bërë provave në lidhje me deklarinimin fajtor të të pandehurit J. Gj., për sa i përket kontratës bankare afatmesme nr. \*\*\*, datë 21.11.2011, nr\*\*\*, sqaroj se, sikurse e kam analizuar dhe e kam parashtruar dhe në vendim, kjo kontratë ka ekzistuar në dy forma të ndryshme, duke pasur ndryshime kopja e kontratës e gjetur tek noteri me kopjen e kontratës së gjetur në bankë<sup>96</sup>. Gjithsesi, të dy kopjet e mësipërme të kontratës, pra, si ajo e gjetur tek noteri, ashtu edhe ajo e gjetur në bankë, kanë qenë të hartuara nga noteri J. Gj., duke përmbajtur si emrin, mbiemrin e nënshkrimit e tij, ashtu edhe vulat e tij. Kopja e kontratës e gjetur tek noteri, e marrë si provë materiale dhe e sekuestruar më pas, ka qenë origjinale. Në lidhje me kopjen e gjetur në bankë, rezulton se ajo është paraqitur në prokurori nga banka ‘\*\*\* Albania’ bashkëngjitur kallëzimit të saj e më pas është sekuestruar me vendim të oficerit të policisë gjyqësore. Në lidhje me këtë procedim penal rezulton që ai të jetë iniciuar në bazë të kallëzimit të paraqitur në prokurori nga banka ‘\*\*\*’ mbi bazën e ankesës që kanë parashtruar disa klientë pranë saj. Banka ‘\*\*\*’, bashkëngjitur kallëzimit të paraqitur, ka depozituar në prokurori një numër të konsiderueshëm aktesh që lidheshin me kallëzimin e paraqitur prej saj, ku kanë qenë shumë mandate pagesash, disa kontrata kredie bankare etj. Midis tyre ka qenë edhe kontrata e kredisë bankare afatmesme nr. \*\*\*, datë 21.11.2011, nr. \*\*\*”. Në vijim të shpjegimeve të saj, subjekti i rivlerësimit raporton në mënyrë kronologjike shqyrtimin e çështjes penale, në të cilën analizon se: “[...] edhe sikur në kontratë të jenë bërë më pas ndërhyrje nga drejtori i bankës, është fakt i pakontestueshëm*

---

Gjykata e apelit, duke u pajtuar pjesërisht me arsyetimin e parashtruar më lart nga gjykata e shkallës së parë, vëren që kjo gjykatë, midis të tjerash, ka marrë në analizë dhe ka vlerësuar në funksion të argumentimit të fajësisë së të pandehurit, një kontratë kredie, e cila është gjetur vetëm në formën e fotokopjes pranë bankës “\*\*\*”, kontratë e cila në përmbajtje paraqitet e ndryshme nga kopja e kontratës së kredisë së sekuestruar pranë noterit dhe që është e vetmja që është paraqitur si provë nga Prokuroria. Në përmbajtje të kontratës së sekuestruar pranë noterit dhe fotokopjes së gjetur pranë bankës (kopja origjinale apo e njehsuar e kontratës së kredisë të administruar pranë bankës nuk ekziston ose të paktën nuk është marrë si provë), ka ndryshime thelbësore.

<sup>96</sup>“Në vendim kam parashtruar se ku kanë konsistuar ndryshimet midis tyre, ku kopja e noterit si në faqen e parë të saj, ashtu dhe në faqen e fundit ku janë pasqyruar emrat e palëve dhe nënshkrimet e tyre, ka pasur vetëm palën kredidhënëse, pra bankën ‘\*\*\*’ e huamarrësen F. K., ndërsa kopja e kontratës e gjetur në bankë, krahas tyre ka pasur edhe dorëzanësin P. E., e po kështu, në pikën (c) të kontratës ku bëhet fjalë për mjetet e sigurimit të dhëna për garantimin e shlyerjes së kësaj kredie, rezulton se në kopjen e kontratës së gjetur tek noteri është pasqyruar se si garanci për shlyerjen e kësaj kredie është vendosur depozita në shumën 64,932 euro, me nr. depozite \*\*\*, në emër të F. K., ndërkohë që në të njëjtën pikë të kontratës në kopjen e saj të gjetur në bankë është pasqyruar se si garanci për shlyerjen e kësaj kredie është vendosur depozita në shumën 64,932 euro, me nr. depozite \*\*\*, në emër të P.E. . Pra, e njëjta depozitë e vendosur garanci në të dy kopjet e së njëjtës kontratë është pasqyruar një herë si depozitë në emër të F.K., e njëherë si depozitë në emër të P. E. ”.

që noteri J.Gj. ka përpiluar kontratën e ka nënshkruar në të, ndërkohë që palët nuk janë paraqitur para tij. Kjo, pavarësisht ndërhyrjeve të tjera të mëvonshme që mund të jenë bërë nga drejtori i bankës në kontrate (fakt ky jo i provuar, por vetëm i supozuar). Në konkluzion të shpjegimeve subjekti deklaroi se ka vlerësuar, duke analizuar të gjitha provat e në bazë të bindjes time të brendshme, në mbështetje të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, se noteri ka kryer shkelje të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si noter. Pra, noteri ka përpiluar këtë kontratë (numrat rep. e kol. e data e kontratës janë të njëjta si në kopjen në bankë, ashtu edhe tek kopja tek noteri, të dyja kontratat kanë emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vulat e noterit) e kredimarrësja F.K. nuk është paraqitur tek noteri dhe se nga ky veprim i noterit ka ardhur pasojë, pra dëmtimi i interesave të bankës e realizimi i një përfitimi të padrejtë për drejtorin e saj E.Ç., pasi kredia është disbursuar pikërisht në bazë të një kontrate kredie të hartuar e të përpiluar nga noteri, pa u paraqitur pala kredimarrëse para tij. Deklarimi fajtor i të pandehurit J. Gj. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi kam vlerësuar në mbështetje të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të gjitha provat e paraqitura, pa pasur asnjë provë vlerë të paracaktuar, duke u krijuar nga tërësia e tyre bindja ime e brendshme e duke bërë arsyetimin përkatës në vendimin e dhënë prej meje”.

**1.7** Në seancë dëgjimore lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Për sa i përket çështjes penale të gjykuar nga ana ime lidhur me të pandehurin J. Gj. me detyrë noter, i cili është akuzuar për veprën penale ‘shpërdorim detyre’ dhe është dënua nga ana ime, është deklaruar fajtor për një kontratë të falsifikuar që ka hartuar, ndërkohë që gjykata e apelit e ka prishur vendimin dhe e ka pushuar çështjen, dua të theksoj se kam bërë çmuarjen e provave të cilat më kanë rezultuar nga tërësia e atij procesi penal. Për sa i përket kontratës së kredisë bankare me të cilën është disbursuar një shumë e konsiderueshme të hollash, e hartuar nga noteri J. Gj., është e vërtetë se në dosjen hetimore ka pasur dy kontrata me përmbajtje të ndryshme, pra, kopja e kontratës që ka qenë tek noteri ka qenë e ndryshme nga kopja e kontratës e cila është gjetur në bankë dhe ndryshimi ka konsistuar se kopja e kontratës që kishte noteri ishin pasqyruar vetëm palët kredimarrëse dhe kredidhënëse, kurse në kopjen e kontratës së gjetur në bankë ka qenë edhe dorëzanësi dhe po kështu ka qenë dhe një ndryshim tjetër sepse në pikën e kontratës ku janë përcaktuar mjetet e përmbushjes së detyrimit, si në kopjen e kontratës që ka pasur noteri se dorëzanës figuronte një tjetër shtetase, figuronte kredimarrësja në fakt, kurse në kopjen që ka pasur në bankë figuronte personi që ka pasur vërtetë llogarinë bankare për të cilën ishte vendosur kjo garanci. Kopja e kontratës që është gjetur te noteri, normalisht pa diskutim që ka qenë kopja origjinale, për sa i përket kopjes së kontratës që ka qenë në bankë, unë kam vlerësuar që edhe kjo kontratë ka qenë origjinale për arsye se ky proces penal është iniciuar me anë të kallëzimit që ka bërë banka “\*\*\*në B. . Bashkëngjitur kallëzimit banka kishte vënë në dispozicion një sërë dokumentesh, pjesë e së cilës ishte edhe kjo kontratë kredie, ato ishin të gjitha të njehsuara me vulën e bankës dhe në bazë të vendimit të prokurorit për t’i marrë, për t’i këqyrur dhe për t’i marrë si prova materiale ishte bërë këqyrja, marrja si prova materiale dhe sekuestrimi nga ana e policisë gjyqësore dhe për këtë arsye unë kam vlerësuar se edhe ajo provë ishte origjinale, ajo kontratë. Po sqaroj edhe një herë se të dyja kopjet e kontratës kanë qenë të hartuara nga i njëjti noter, pra nga i pandehuri J. Gj., të cilin unë e kam deklaruar fajtor, kam pasur numrat rep. dhe kol. të njëjta, kanë qenë të regjistruara edhe në regjistrat noterialë që ka disponuar noteri në zyrën e tij. Për sa i përket këtyre kontratave kanë rezultuar që kanë qenë tërësisht të falsifikuara, kanë rezultuar jo vetëm nga akti i ekspertimit grafik, por edhe nga deklaratimet e kredimarrëses e cila ka deklaruar se nuk ka shkuar asnjëherë në bankë dhe nuk e ka marrë këtë shumë lekësh dhe as ka bërë kërkesë për kredi, nga deklaratimet e vetë drejtorit të bankës i cili ishte gjithashtu i pandehur dhe i pandehuri kryesor në atë proces penal,

*i cili ka deklaruar se e kishte falsifikuar këtë shumë, e kishte falsifikuar këtë kontratë me qëllim për të siguruar të ardhura dhe nga deklarimet e dorëzansit i cili ka deklaruar se nuk kishte vënë dorëzani në këtë shumë të caktuar të hollash. Pra, ka rezultuar që këto kontrata kanë qenë tërësisht të falsifikuara. Gjykata e apelit ka arsyetuar në vendimin e saj, duke thënë se ka qenë kopja e kontratës e cila ka qenë në bankë e cila ka sjellë efektet për disbursimin e kredisë, e vërteta e shumës së kredisë që ka qenë mbi, ka qenë shumë e konsiderueshme pra, është marrë nga banka prej drejtorit të bankës, është përvetësuar prej tij, theksoj që të dyja këto kontrata kanë qenë të hartuara nga i njëjti noter, kanë pasur numrat e repertorit dhe të koleksionit të tij, noteri ka kryer shkelje detyre sepse ai ka hartuar një kontratë për marrje kredie, ndërkohë që nuk është paraqitur fare kredimarrësja pranë tij, nuk është paraqitur as pala tjetër d.m.th. banka pranë tij, në këtë mënyrë mendoj që noteri ka realizuar veprën penale 'shpërdorim detyre' pasi ka kryer veprime në kundërshtim me detyrën e tij si noter, duke hartuar një kontratë, një akt noterial, pa u paraqitur pala dhe nga kjo kontratë kanë ardhur pasoja, pasi shuma e kredisë ishte disbursuar nga banka për qëllime të caktuara të drejtorit të tij, pra, edhe sikur të jetë siç thotë, siç arsyeton gjykata e apelit, që në kopjen e kontratës që ka pasur në bankë mund të jenë bërë ndërhyrje, që edhe kjo është thjesht aludim sepse nuk është provuar gjatë procesit penal nëse ka pasur ndërhyrje ose jo, përsëri mendoj që kanë qenë veprimet e noterit ato që kanë sjellë pasojat, sepse edhe kontrata që ka qenë në bankë ka qenë një kontratë e hartuar nga noteri, ka pasur firmën e tij, vulën e tij, ka qenë e regjistruar me numrat rep. dhe kol. në regjistrat e tij noterialë dhe pikërisht ajo kontratë ka sjellë pasoja dhe këtu jam bazuar dhe këtë vlerësim u kam dhënë provave që kam vlerësuar deklarinimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit J. Gj.”.*

**1.8** Gjykimi i çështjes ka zgjatur 4 muaj e 4 ditë, në intervalin kohor 24.4.2015 – 8.1.2016. Gjykimi është zhvilluar brenda afatit 9-mujor të parashikuar nga germa “a” e nenit 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndare në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetues dhe në dispozitivin e gjykatës. Në konkluzion të sa më sipër, mbështetur në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, trupi gjykues çmon se veprimet procedurale të ndërmarra nga subjekti në gjykimin e çështjes penale nuk përmbajnë element ligjor vlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues çmon se argumentet e dhëna nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore nuk rezultojnë të bazuara në prova dhe në ligj. Për pasojë, ky trup gjykues do ta vlerësojë këtë konkluzion në tërësinë e tyre për këtë kriter.

**2. Dosja 2** – çështja civile nr. \*\*\*2013 regjistri themeltar, datë 25.4.2013 regjistrimi, që ju përket palëve: paditës R.D. kundër të paditurit Y.Q., me objekt “lirim dhe dorëzim pasurie e paluajtshme”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.2.2015.

**2.1** Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 24.4.2013 dhe me shortin elektronik të zhvilluar në datën 25.4.2013 i është caktuar një gjyqtareje tjetër, e cila e ka mbajtur çështjen për gjykim deri në datën 7.11.2013, ku për shkak të emërimit të saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u largua nga gjykimi i saj. Me shortin e ri elektronik datë 7.11.2013, u caktua për gjykimin e çështjes subjekti i rivlerësimit. Me vendimin e datës 12.11.2013 është caktuar seanca përgatitore në datën 3.12.2013.

Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit Y.Q. të lirojë e dorëzojë paditësit R.D. sipërfaqen prej 113 m<sup>2</sup> tokë,



*pjesë e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në P., Korçë, me kufizime. Detyrimin e të paditurit Y. Q. t'i lirojë e dorëzojë paditësit R. D. sipërfaqen prej 22 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në P., Korçë". Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.*

**2.2** Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 13.2.2015, pas 10 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin e parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 27 ditë, në intervalin kohor 7.11.2013 – 3.2.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga germa "e" e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

**2.3** Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se afati standard i gjykimit është shkelur kryesisht për shkak të sjelljes së palëve, por edhe prej menaxhimit jo të mirë të çështjes nga subjekti i rivlerësimit. Sjellja e palëve nuk ka qenë korrekte, ku ka pasur mungesa të shpeshta e të pajustificuara të avokatëve të të dy palëve, gjë që ka çuar në dështimin e disa seancave gjyqësore. Nga 20 seanca të zhvilluara, 13 prej tyre ishin jo produktive. Si mangësi të gjyqtarës në menaxhim, konstantë me mosmarrjen e masave apo tolerimin nga ana e saj të sjelljes jo korrekte të avokatëve, ku vetëm pas shumë seancash gjyqtarja i drejtohet Dhomës së Avokatisë Korçë për mungesa të pajustificuara të avokatit të të paditurit.

**2.4** Një mangësi tjetër tek subjekti i rivlerësimit konsiderohet disiplinimi jo i duhuri palëve në sjelljen e provave. Provat përcaktohen që në seancën përgatitore dhe vetëm një provë e re që nuk dihej në seancën përgatitore apo që zbulohet gjatë gjykimit nga debate mes palëve, mund të merret në seancë gjyqësore. Janë shtyrë disa seanca gjyqësore për të marrë prova apo për të sjellë palët prova, duke zbehur rëndësinë e seancës përgatitore apo duke bërë një seancë përgatitore të re formale, sa për të thënë. Pozitiv është fakti që të gjitha seancat janë zhvilluar në audio, në funksion të transparencës së gjykimit.

**2.5** Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet rreth rezultateve të hetimit, shpjegoi se: *"Ashtu sikurse është konstatuar edhe nga ana Juaj në raportin e rivlerësimit, sjellja e të dy palëve në gjykim nuk ka qenë korrekte, pasi të dy palët e avokatët e tyre kanë paraqitur shumë herë kërkesa për shtyrje. Në lidhje me këtë moment, sqaroj se kërkesat për shtyrje të paraqitura prej tyre e të pranuar nga ana ime kanë qenë gjithmonë për arsye objektive. Gjithashtu, gjatë gjykimit i jam drejtuar me shkresë edhe Dhomës së Avokatisë Korçë, për marrjen e masave ndaj avokatit të të paditurit, i cili ka shtyrë seancën për arsye të pajustificuara. Gjithsesi, e pranoj konstatimin Tuaj se duhet të kisha kërkuar më parë marrjen e masave ndaj avokatëve. Natyra e çështjes ka qenë komplekse, nisur edhe nga objekti i saj, pra, lirimi e dorëzimi i një pasurie të paluajtshme, ku për zgjidhjen e drejtë të çështjes nevojitej marrja e mendimit të specializuar të ekspertit e kryerja e aktit të ekspertimit prej tij, kërkonte kohën e nevojshme. Në lidhje me arsyen e zhvillimit të disa seancave përgatitore, duke toleruar paraqitjen e provave në disa seanca nga palët, sqaroj se kam pasur për qëllim që të kryhej një hetim i plotë e objektiv, me qëllim sqarimin e plotë të konfliktit midis palëve, zbulimin e natyrës së mosmarrëveshjes që kanë pasur në dhënien e një vendimi sa më të drejtë. Për këtë arsye, kam toleruar paraqitjen e provave prej palëve në disa seanca përgatitore, pra me qëllim paraqitjen e gjithë provave të nevojshme e hetimin e gjithanshëm të çështjes".*

**2.6** Pasi u analizuan shpjegimet e paraqitura nga subjekti, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimit tej afatit standard ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të mirë të punës nga subjekti, si dhe rezultoi të ketë shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afateve të gjykimit në shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk përbën shkak autonom për

shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

### **Vlerësimi i denoncimeve dhe vendimeve të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese**

Në Komisionin e pavarur të kualifikimit janë paraqitur nga publiku 7 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet dhe dokumentacionin përkatës, si dhe janë administruar disa fashikuj gjyqësorë dhe akte procedimi penal për të vlerësuar në aspektin profesional subjektin e rivlerësimit.

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë bërë këto denoncime: (a) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2018, i shtetasit M.D.; (b) denoncim nr.\*\*\*prot., datë 22.1.2018, i shtetasit I.Z. (H.); (c) denoncime nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2019, nr.\*\*\*prot., datë 18.3.2019, të shtetasit P. D.; (ç) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2019, i shtetasve T. H., I. R. dhe P.Sh.; (d) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2019 dhe denocimi nr. \*\*\* datë 22.01.2020 i shtetasit E.H.; (dh) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2019, i shtetasit K. J.; si dhe (e) denoncim nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2020, i shtetasit Xh.Q..

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara, nga verifikimi i të cilave kreu hetime shtesë dhe i kërkoi subjektit shpjegime për 2 prej tyre.

**1. Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020, të shtetasit E.H.,** i cili ngre pretendimin dhe akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion, për pranim, shkëmbim dhuratash favoresh dhe parash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, shkelje të etikës profesionale, si dhe për paaftësi profesionale në gjykim dhe shkelje të rënda ligjore. Nga rrethanat e denoncimit rezulton se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2012, për veprën penale “vrasje me dashje, prodhim dhe mbajtje e armëve luftarake dhe municioneve në ngarkim të shtetasit E. K.”. Në datën 27.10.2012, në fshatin V. Korçë është gjetur i vlarë shtetasi H. H., babai i denoncuesit. Lidhur me këtë ngjarje, në datën 30.10.2012 është bërë ndalimi i shtetasit E.K. si person i dyshuar për vrasjen e shtetasit H. H. . Me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.11.2012, subjekti i rivlerësimit ka vendosur vlerësimin si të ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” për të pandehurin E. K. .

**1.2** Për verifikimin dhe vërtetësinë e pretendimeve të ngritura në denoncim dhe për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, Komisioni ju drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë<sup>97</sup>, e cila ka vënë në dispozicion vendimin nr.\*\*\*, datë 5.2.2013, i cili ka marrë formë të prerë në datë 15.2.2013. Subjekti i rivlerësimit ka relatuar se gjatë hetimeve të mëtejshme të organit të akuzës, nga ana e të dyshuarit E. K. është ngritur pretendimi se ditën e ngjarjes kishte salduar marmitën e një furgoni të tij në një servis makinash në M., ku ka pasur të veshur të njëjtën bluzë, dhe nitriti e nitratet e gjetura në bluzën e tij mund të kenë mbetur nga saldimi me oksigjen.

**1.3** Për sa më sipër, prokuroria ka kryer aktekspertimin hetimor me nr. \*\*\*, datë 11.1.2013, nga ku ka rezultuar se në bluzën e marrë për ekspertim është evidentuar prania e nitriteve dhe nitrateve, të cilat janë të pranishme edhe tek mbeturinat e faktorëve plotësues. Duke u mbështetur në dy aktekspertimet kimike të kryera për nevoja të hetimit, të datave 30.10.2010 dhe 11.1.2013, prokuroria ka kërkuar në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” në “detyrim t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Subjekti i rivlerësimit, në arsyetim të vendimit, ka çmuar se *zbehja e dobësimi i provave në ngarkim të fajësisë së një të*

<sup>97</sup>Shkresë kthim përgjigje nr \*\*\* prot., datë 17.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

*dyshuari nuk është shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit. Në referencë të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale zbutja e nevojave të sigurimit ka të bëjë me rrethana të tilla që mund të diktojnë caktimin e një mase më të butë pavarësisht së rëndësia e faktit ka mbetur e njëjtë. Kurrësi zbutja e nevojave të sigurimit nuk mund të lidhet me zbehjen e provave e zbehjen e dyshimit në ngarkim të autorësisë. Në vijim të arsytimit të vendimit, subjekti i rivlerësimit relatton lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit personal në një masë më të lehtë ndaj të pandehurit E. K. e ka mbështetur në parashikimin e pikës 2<sup>98</sup>, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale. Zbatimi i nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale rregullon caktimin e masës së sigurimit personal dhe nuk mund të aplikohet në zëvendësimin e masës së sigurimit personal.*

Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenet 71/a dhe 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në çdo rast vlerësimi bëhet në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

**1.4** Në analizë të sa më sipër, gjatë hetimit rezultoi se arsytimi i subjektit të rivlerësimit në vendim e dhënë bie në kundërshtim me dispozitivin e tij, pasi subjekti relatton se nuk janë plotësuar kriteret e pikës 2 të nenit 260 dhe me pas referon në dispozitën pararendëse nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale, i cili aplikohet vetëm në caktimin e masës së sigurimit dhe jo zëvendësimin e saj.

**1.5** Lidhur me këtë konstatim, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksin D të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës dhe i kërkoi shpjegime se cilat ishin shkaqet ligjore në të cilat ishte bazuar në vendimmarrjen për zëvendësimin e masës së sigurimit personal për shtetasin E. K., në zbatim të kriterëve të pikës 2, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale.

**1.6** Subjekti, lidhur me këtë konstatim, me parashtrimet e rezultateve të hetimit, ka shpjeguar si vijon: “*Denoncimi i mësipërm bazohet në faktin se me vendimin nr\*\*\*, datë 5.2.2013, kam pranuar kërkesën e prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’ me masën e sigurimit ‘detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore’ ndaj të dyshuarit E.K. . Ashtu sikurse kam pasqyruar edhe në këtë vendim, kam vlerësuar se nuk është plotësuar asnjë nga dy kushtet e parashikuara në nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së sigurimit; se ndaj të dyshuarit E. K., pavarësisht rezultateve të akteve të ekspertimit kimik, vijonte të ekzistonte dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij e se zbehja e provave nuk është shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë, pasi masa e sigurimit caktohet kur ekzistojnë kushtet e përgjithshme e të veçanta të përcaktuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale, e në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale. Një nga kushtet e përgjithshme për të caktuar një masë sigurimi është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova (neni 228, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale) e kur ky dyshim ekziston, masa do të caktohet në përputhje me kriteret e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale e, në të kundërt, në rast se dyshimi nuk ekziston nuk do të caktohet asnjë mase sigurimi, pasi mungon një nga kushtet për të caktuar masë sigurimi (neni 228, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale). Në këtë vendim kam arsyetuar se shkak që kam pranuar kërkesën e prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ me ‘detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore’, ka qenë parashikimi i nenit 244/3 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Nga*

---

<sup>98</sup>Zbutja e nevojave të sigurimit; masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

ana ime është pasqyruar e është arsyetuar në vendim se nuk plotësohet asnjë nga kushtet e nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së sigurimit, por arsyeja e vendimmarrjes sime ka qenë parashikimi i nenit 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Po kështu, theksoj se një qëndrim i tillë nuk është mbajtur nga ana ime gjatë veprimtarisë sime si gjyqtare vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera kur ka pasur kërkesë nga ana e prokurorit për zëvendësim mase sigurimi, ç'ka tregon se kurrsesi nuk kam pasur ndonjë qellim për të favorizuar të dyshuarin E. K.. Po kështu, i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e madje edhe nga Gjykata e Apelit Korçë, ku kjo e fundit ka cenuar vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë e ka pranuar kërkesën e prokurorit për zëvendësim e masës së sigurimit, me arsyetimin se gjykata nuk mund të caktojë një masë më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, sipas nenit 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Edhe Gjykata e Apelit Korçë ka mbajtur këtë qëndrim në vendimet e dhëna prej saj”.

**1.7** Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit shpjegoi sërish rreth kësaj vendimmarrjeje dhe referoi gjatë disa vendime gjyqësore<sup>99</sup> të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Lartë, në të cilat ishte vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit me kërkesë të prokurorit, sipas pikës 3, të nenit 244, të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>99</sup>“Vendimin nr. \*\*\*prot., datë 14.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Edhe në këtë vendim kam pranuar kërkesën e prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit M. A., duke arsyetuar se ndonëse nuk ekziston asnjë nga kushtet e nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin mase sigurimi, gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori: vendim nr\*\*\* regj., datë 28.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (vendim i një gjyqtari tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë), ku gjykata në vendim ka pranuar kërkesën e prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit M.L. vetëm duke u bazuar në parashikimin e nenit 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, pra se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Edhe në atë vendim gjykata ka arsyetuar se nuk plotësohen kushtet e nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së sigurimit, por kjo dispozitë duhet të shikohet e lidhur me nenin 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale dhe, edhe kur nga prokurori kërkohet zëvendësimi i masës së sigurimit, duhet të zbatohet neni 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Edhe në atë vendim, gjykata është shprehur se kjo ka qenë praktika në lidhje me zëvendësimin e masave të sigurimit; vendimin nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit I.V., duke u bazuar edhe në parashikimin e nenit 244/3 të Kodit të Procedurës Penale, pra se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori (paragrafi i parafundit, f. 8 e vendimit); vendimin nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; vendimin nr. \*\*\*, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë e vendimin nr. \*\*\*, datë 8.5.2020, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Nga këto vendime, të cilat lidhen me kërkesën e të dyshuarit L.P. për zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj tij, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në vendimin e mësipërm ka rrezuar kërkesën e kërkuarit L. P. për zëvendësimin e masës së sigurimit. Në këtë rast, kërkesa për zëvendësim është parashtruar nga i dyshuari, por prokurori në atë gjykim ka dhënë dakordësinë e tij, duke u shprehur se është dakord me kërkesën e të dyshuarit për zëvendësim mase sigurimi. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.3.2019, duke u zëvendësuar masa e sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit L. P., me masën e sigurimit ‘garanci pasurore’, parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Korçë ka arsyetuar, krahas të tjerash (f. 14 e vendimit), se neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale duhet të zbatohet edhe në rastin kur kërkohet zëvendësimi i masës së sigurimit. Madje, Gjykata e Apelit shkon edhe më tej, duke arsyetuar se ky nen duhet të zbatohet jo vetëm kur kërkesa për zëvendësim mase sigurimi bëhet nga prokurori, por edhe kur kërkesa për zëvendësim mase sigurimi bëhet nga i dyshuari dhe prokurori shprehet se është dakord me kërkesën për zëvendësim mase. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se parimi i parashikuar nga neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale duhet të udhëheqë gjykatën në gjithë situatat e parashikuara nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale e se shkalla e nevojave të sigurimit e zbutja e tyre nuk mund të marrin vlerësim ndryshe nga gjykata nga ajo që është pretenduar nga prokurori. Nga vendimi nr. \*\*\*, datë 8.5.2020, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Korçë, rezulton se një nga shkaqet e rekursit të paraqitur nga prokurori ka qenë se neni 244/3 i Kodit të Procedurës Penale nuk duhet të zbatohet në rastin e zëvendësimit të masave të sigurimit e Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranim rekursi ka vlerësuar se nuk ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, pra dhe mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural”.

Më tej subjekti ka vijuar me shpjegimet: *“Pra, kam vlerësuar të nderuar se, ashtu sikurse në kërkesën për caktim mase sigurimi gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, edhe sikur të çmoj se nuk ekzistojnë kriteret për caktim mase sigurimi të parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale për të caktuar masën e sigurimit të kërkuar nga prokurori, edhe në rastin e kërkesës së prokurorit për zëvendësim mase sigurimi gjykata nuk mund të lërë zbatimin e masës së mëparshme të sigurimit, pra të një mase të ndryshme nga ajo e kërkuar nga prokurori, me arsyetimin se nuk plotësohen kushtet e nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së sigurimit”.*

**1.8** Gjatë seancës dëgjimore lidhur me vendimin e zëvendësimit të masës, subjektit iu drejtuan pyetjet nga trupi gjykues, si vijon:

**Së pari**, e pyetur nga trupi gjykues lidhur me faktin nëse ka jurisprudencë të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë mbi vendime për zëvendësimin e masës dhe a ka ndonjë vendim dhe qëndrim në kohë lidhur me këtë çështje, si dhe mbi mendimin e subjektit nëse gjyqtari kur gjykon një çështje duhet, le të themi, në thonjëza, me sy mbyllur të pranojë kërkesën që një prokuror bën lidhur me masën e sigurimit, aq më tepër me zëvendësimin e masës së sigurimit, pra, a mundemi ne që një prokuror bën një kërkesë i cili/e cila është e paarsyetuar dhe e pabazuar të më detyrojë mua si gjykatë që të pranoj të paarsyetuar ekzistencën, pranimin ose jo të kësaj kërkesë? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se: *“Për sa i përket jurisprudencës së Gjykatës së Lartë në vendimin që ju kam sjellë, të Gjykatës së Apelit, pra gjykata e apelit aty kishte ndryshuar shkallën e parë, jo vendimin tim, vendimin e një kolegut tim, që gjykata e apelit kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë me arsyetimin se gjykata nuk mund të vendosë më lart se prokurori, një nga shkaqet e rekursit, që ka dhënë prokurorja e apelit ka qenë dhe kjo, pra sepse gjykata e apelit thotë në mënyrë të gabuar thotë në këtë rast, gjykata s’ mund të vendosë më lart se prokurori. Gjykata e Lartë aty ka vendosur mospranimin rekursi, pra që në interpretim i bie që nuk kanë gjetur shkelje procedurale ose shkelje ligjore”.*

**Së dyti**, e pyetur nëse ky vendim ka qenë rast zëvendësim mase, subjekti është përgjigjur se: *“Rasti ka qenë zëvendësim, rasti që unë kam bashkëngjitur, që ka qenë vendimi i koleges time, ka qenë rasti për zëvendësim dhe në rekurs prokurori i apelit ka ngritur pikërisht këtë, duke thënë që gjykata e apelit gabon meqenëse thotë që neni 244/3 duhet zbatuar edhe në këtë rast, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin rekursi, mendoj se nëse Gjykata e Lartë do të ketë çmuar se ky ishte një zbatim i gabuar i ligjit, do të kishte shkelje thelbësore ligjore ose procedurale e do ta çonte çështjen për shqyrtim”.*

**Së treti**, e pyetur nga Komisioni lidhur me dispozitën ligjore për caktimin e masës e cila nuk e shtrin kriteret tek zëvendësimi i masës, si dhe nëse pavarësisht faktit se nuk ka çmuar asnjë gjë si gjykatë, subjekti është përgjigjur se: *“Neni 244 thotë vetëm kaq, që gjykata nuk mund të caktojë një masë më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori dhe unë mendoj që kërkesa e prokurorit, kërkim ish-in të dyja rastet, këtu kërkoi të caktohej një masë, këtu kërkohet të zëvendësohet një masë dhe ndaj theksova dhe atë që në kërkim mase dhe aty në kërkim mase ne kemi disa kriteret që duhen zbatuar qoftë nga gjykata, qoftë nga prokurori. Mund të vijë prokurori për një vrasje dhe kërkon detyrim paraqitjeje, unë si gjykatë në këtë rast nuk mund të vendos dot ‘arrest në burg’, ndonëse mendoj që kërkesa e prokurorit është haptazi e pabazuar dhe them që është i gabuar qëndrimi i prokurorit, por unë kam këtë nen të cilin nuk mund ta zbatoj, nuk mund ta lejoj, nuk më lejon të veproj ndryshe dhe mendoj që në të dyja rastet kemi një kërkim, kërkesë prokurori aty, kërkesë prokurori aty, kushte që duhen plotësuar në rastet e nenit të caktimit të masës, neni 249, kushte që duhen plotësuar në raste të zëvendësimit të masës, neni 260”.* Në vijim të përgjigjes sa më sipër, subjektit i drejtohet pyetja se këto dy dispozita janë dy krerë të ndryshme të kodit faktikisht, janë dy çështje të ndryshme,

ndaj së cilës është përgjigjur se: “Kjo ka qenë mënyra e ndjekur dhe në raste të tjera, për këtë arsye kam sjellë edhe vendime të tjera të gjykatës tonë dhe gjykatës së apelit”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “detyrim për paraqitje”, dhënia e një mase më të lehtë për të pandehurin E. K., ndërkohë që nuk plotësoheshin kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me një tjetër më të butë, sipas pikës 2, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale tregon se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e dhënë për masën e sigurisë, ka favorizuar të pandehurin, duke qenë se nga provat dhe shqyrtimi i kësaj çështjeje, duke krahasuar provat e administruara para caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” me ato pas këtij momenti, rezultojnë se fakti penal ka qenë i njëjtë si para edhe pas caktimit të masës së sigurimit. Ky vendim i dhënë nga subjekti, i parë në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, informacionin e verifikuar nga organet ligjzbatuese, si dhe bindjen e brendshme të trupit gjykues, ka elemente që të bindin se në rastin konkret ka pasur një favorizim të të pandehurit në dhënien e masës së sigurisë, favorizim i cili ndikon në perceptimin e publikut/komunitetit ku jeton i pandehuri në lidhje me organet e drejtësisë. Gjithsesi, vlen të theksohet se ky vlerësim në këtë proces administrativ, në asnjë rast nuk vë në dyshim vendimin e marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me arsyetimin se nuk provohet se fakti penal ekziston.

**2. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2019, të shtetasit K.J.,** i cili pretendoi se nga ana e subjektit të rivlerësimit në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 12.11.2019, gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare e komanduar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë ka shkelje të etikës profesionale dhe ka kryer vlerësim të gabuar të kuptimit të aktit administrativ, duke arsyetuar se akti nr. \*\*\*, datë 21.11.2015, i Komisionit të Ristrukturimit pranë Këshillit të Qarkut Korçë nuk është akt administrativ. Gjithashtu, ka pretenduar se procesi gjyqësor për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit nr.\*\*\*, datë 21.11.2015, vlerësohet gjë e gjykuar. Në konkluzion të vlerësimit të kësaj çështjeje nga Komisioni, në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe provave që subjekti i rivlerësimit paraqiti, nuk u vërtetuan pretendimet e denoncuesit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar dhe administruar të gjitha provat, si dhe bazuar në deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, konstatoi se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjes së gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, rrethanat të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E (fjalja e fundit, faqja 60-64), të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në përgjigje të barrës së provës, konkludon se:

- a) subjekti ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, referuar në pikën 2 të nenit 4, germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ariola Kristo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 8.9.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Alma FASKAJ**  
**Relatore**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*